# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE PËR PROJEKTIN "SHËRBIMET MJEDISORE" NË MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT DHE AGJENCINË PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

**TIRANË, dhjetor 2024**

| **PËRMBAJTJE** | | |
|---|---|---|
| | | |
| **Nr.** | | |
| **I.** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | |
| **1** | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit. | |
| **2** | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | |
| **3** | Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit | |
| **II.** | **HYRJA** | |
| **1** | Objektivat dhe Qëllimi i auditimit. | |
| **2** | Identifikimi çështjes | |
| **3** | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | |
| **4** | Përgjegjësitë e audituesve | |
| **5** | Kriteret e vlerësimit | |
| **6** | Standardet e auditimit | |
| **7** | Metodat e auditimit | |
| **8** | Dokumentimi i auditimit | |
| **III.** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** | |
| **1** | 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin | |
| **2** | 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit | |
| 2.1 | *Mbi planifikimin, studimin dhe projektimin e projekt idesë mbi zhvillimin e projektit* | |
| 2.2 | *Mbi marrëveshjet e financimit të projektit (përfshirë ndryshimet, amendimet e kontratës)* | |
| 2.3 | *Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar, raportimet përkatëse.* | |
| 2.4 | *Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës* | |
| 2.5 | *Mbi zbatimin e kontratave për punime civile* | |
| 2.6 | *Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.* | |
| 2.7 | *Çështje të tjera që mund të dalin gjatë procesit të auditimit* | |
| **IV.** | **REKOMANDIME** | |
| **1** | Masa Organizative | |
| **2** | Masa shpërblim dëmi | |
| **3** | Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet të Fondeve Publike | |
| **V.** | **ANEKSE** | |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH"*, në zbatim të programit të auditimit me nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, i ndryshuar me nr. 346/2 Prot., datë 29.05.2024 si dhe Autorizimit nr.346/3 Prot., datë 19.06.2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua auditimi mbi përputhshmërinë në për projektin "Shërbimet Mjedisore" pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural.

Ky auditim u krye në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural për projektin "Shërbimet Mjedisore" i financuar me Hua dhe grande në total me vlerën 22.8 milion USD (të konvertuara në kursin e ditës), të miratuara me:

Ligjin nr. 151/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore" për fondin IBRD 84010 AL në vlerën 7.3 Milion Euro;

Ligjin nr. 152/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore" për fondin GEF TF17364 në vlerën 2.88 Milion USD;

Ligj nr. 64/2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve grant, të siguruara nga agjencia suedeze për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar (sida), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF072239, për projektin e Shërbimeve Mjedisore me Shqipërinë, në vlerën 7.96 Milion USD.

Vendimi nr. 369, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin Shërbimet Mjedisore",

Vendimi nr. 370, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si agjenci zbatuese e fondit për mjedisin global për projektin e Shërbimeve Mjedisore",

Vendimi nr. 10, datë 14.01.2015, "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve Grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF072239, për projektin Shërbimet Mjedisore me Shqipërinë.

Sipas marrëveshjeve të mësipërme Qeveria Shqiptare do të mbulojë të gjitha shpenzimet në lidhje me TVSH-në.

## I.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

Projekti i Shërbimeve Mjedisore (PSHM) ka nisur të zbatohet në 29.01.2015 nga Ministria e Mjedisit, me objektiv bazë mbështetjen e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës, dhe nëpërmjet tyre rritjen e përfitimeve monetare dhe jo-monetare për komunitetet në zona të caktuara të projektit, që shtrihen kryesisht në zona të larta malore që preken nga erozioni, si dhe do të përfundonte me datë 30 Shtator 2019, por qe iu nënshtrua dy ristrukturimeve, atë të datës 30

Shtator 2019 dhe 15 Gusht 2020 që përfshinte një zgjatje deri më 31 Maj 2021 të projektit. Sipas Raportit Final të hartuar nga Banka Botërore kanë lindur si kërkesë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dokumentacion që nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, për të analizuar shkaqet dhe arsyet mbi ristrukturimin e tyre.
Gjithashtu nga ristrukturimi i projektit janë rritur dhe kostot operacionale, duke bërë të mundur alokimin e kostove të planifikuara për zhvillimin e komponentëve të projektit për kostot operacionale të burimeve njerëzore si dhe të shtyrjeve të afateve të realizimit të kontratave të tjera të konsulencës.
- Gjatë viteve 2020 dhe 2021 janë disbursuar 11.86 Milion USD fonde, të cilat përbëjnë 57% të të gjithë fondeve të vënë në dispozicion për 4 vite (2015-2019).
- Në lidhje me kontratën e punësimit midis Ministrisë së Mjedisit dhe znj. B. B. si specialiste prokurimesh për projektin dhe si person përgjegjës për realizimin e tyre, nuk jepen shpjegimet përkatëse në lidhje me ndryshimet e kushteve të kontratës, kryesisht nga kalimi me kohë të plotë në punësim me kohë të pjesshme. Përpos këtij ndryshimi vlera e pagesave ka ndryshuar, pasi në këtë rast pagesat kanë qenë 180 euro/ditë pune, pagesa të cilat për disa ditë pune do të mbulojnë pagesën e një muaji të plotë sipas kontratës me kohë të plotë. Gjithashtu në amendimet e kontratave datat e cituara nuk janë në përputhje me kontratën kryesore dhe me amendimet e tjera. Kalimi i kontratës me kohë të pjesshme bie ndesh dhe me përcaktimet ligjore në fillim të projektit pasi rëndësia e pjesëmarrjes në Grupin e Menaxhimit të Projektit është e lartë.
- Procedurat e prokurimit janë planifikuar në Shkurt të vitit 2015 (në fillim të nisjes së realizimit të projektit) për 18 muaj e parë, në të cilën janë të detajuara duke përfshirë Referencën, objektin, kostot e përllogaritura, burimi i financimit, prioriteti, data e zhvillimit, kohëzgjatja e zbatimit.
Planet vjetore të prokurimeve dhe planet e punës nuk i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit. Zhvillimi i procedurave të prokurimit nuk është kryer sipas planit të parë 18 mujor, duke mos respektuar hierarkinë e përzgjedhjes së tyre sipas prioritarizimit, sipas datës së planifikuar dhe sipas kostos së përllogaritur, si dhe për ndryshimet e pësuara më pas nuk ka asnjë dokumentacion në lidhje me arsyetimet përkatëse, duke u bërë dhe faktor kryesor në zgjatjen e realizimit të projektit.
- Përzgjedhja e aplikantëve pranë AZHBR, në përmbushje të komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural", nga analizimi i dokumentacionit sjellë nga aplikantët, vihet re që në këtë komponent është vepruar si e ndarë nga projekti "Shërbimet Mjedisore", pasi nuk ka një korrelacion midis zonave që kërkojnë ndërhyrje të caktuara nga komponentët e tjerë si dhe nuk ka një orientim për aplikantët mbi mbulimin e këtyre zonave të caktuara ashtu siç shprehet dhe në Projektin "Shërbimet Mjedisore" *(Investimet do të zbatohen nëpërmjet granteve konkurruese të cilat, nëpërmjet procesit të aplikimit dhe këshillimeve të ekstensionit, do të mbështesin kapacitetet e përmirësuara financiare dhe të planifikimit të biznesit. Në të njëjtën kohë zbatimi i PMPKK-ve dhe PMMK-ve do të ndihmojë trajtimin e çështjeve të rezistencës ndaj klimës nëpërmjet rritjes së aftësisë absorbuese të peizazhit, duke reduktuar erozionin dhe menaxhimit më të mirë të burimeve ujit, pyjeve dhe kullotave. Nëpërmjet pakësimit të erozionit dhe degradimit të tokës, produktiviteti i tokës do të përmirësohet dhe jetëgjatësia e infrastrukturës së ujit në drejtim të rrjedhës do të rritet dhe kostot e mirëmbajtjes së vazhdueshme do të reduktohen. Do të ngrihet kapaciteti institucional për të mbështetur komunat lokale, shoqatat e përdoruesve, AZHBR dhe për të ndërmarrë monitorim dhe raportim.)*
Në korrespondencën me Drejtoritë pyjore të zonave respektive dhe strukturave përkatëse në MM, nuk jepen të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të zonave në të cilën do kryhet ndërhyrja, duke caktuar dhe impaktin që ka ajo zonë, por fokusohet vetëm në miratimin që shoqata mbulon atë zonë.

- Gjatë analizimit të dosjeve të aplikantëve pranë AZHBR vihet re përzgjedhja e aplikantëve të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, krijimi i shoqatave është në një kohë të afërt me aplikimin për thirrjen e parë ose të dytë të projektit.
- Në dokumentacionin e sjellë nga aplikantët pranë AZHBR, në projektin e dërguar, nuk jepen informacione të detajuara në lidhje me vlerën e projektit dhe se si është arritur në atë vlerë. Gjithashtu nuk tregohet roli që do kenë anëtarët e shoqatës, angazhimi i tyre dhe se si do mbulohet pjesa prej 15% e financimit të projektit nga shoqatat dhe 40% për individët, pjesë të cilën nuk e mbulon granti. (nga vjen burimi i financimit të 15% apo 40% të vlerës së projektit, si përkthehet në zë apo natyrë). Në dokumentacionin e dërguar nga aplikantët pjesëmarrës dhe fitues, nuk jepen detaje se si do arrihet finalizimi i projektit. Sa do të jetë fuqia punëtore e angazhuar për kryerjen e projektit, cila do të jetë infrastruktura e nevojshme, pagesat për kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Kjo pjesë gjithashtu nuk dokumentohet as në momentin e kërkesës për financim, në të cilën nuk ka asnjë dokumentacion mbështetës (faturë shoqëruese, listë pagesa), por vetëm fatura për blerjen e fidanëve ose mjeteve bujqësore të cilat nuk përbëjnë as 10% të financimit të kërkuar. Edhe në rastet kur është deklaruar lista e anëtarëve të angazhuar, nuk janë shoqëruar me listë pagesa, si dhe nuk është kryer asnjë verifikim nga AZHBR dhe MM, që këto persona të deklaruar si anëtarë të shoqatës për përfitimin e këtij granti janë angazhuar për realizimin e tij, gjë që e bën të vështirë verifikimin e personave që janë angazhuar në këtë projekt në qoftë se janë apo jo anëtarë.
- Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-SS-14.2 me objekt "Ind. Consultant for Interim F&P Database", me kosto të përllogaritur në vlerën 70,000 Euro, nuk është planifikuar në planin 18 mujor të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. G. F.. Kostoja e planifikuar është tejkaluar duke shkuar në shumën 104,904 Euro. Kontrata është lidhur me datë 12 Maj 2018. z. G. F. rezulton njëkohësisht edhe Administrator i kompanisë A. S. - A. B. me NIPT L........N, kompani e cila gjithashtu është angazhuar në realizimin e procedurave të tjera të prokurimit me Ref. ESP-CS-QCBS-4.1 dhe Ref. ESP-CS-QCBS-4.2 me objekt "Supervision of registration of communal forest", me kosto të përllogaritur në shumën 823,000 Euro. Objekti midis procedurave të prokurimit është i ngjashëm si dhe datat e zhvillimit të tyre janë të njëjta. Pagesat do të kryhen sipas kushteve të kontratës ku u konstatua që nuk janë bërë sipas termave të referencës dhe kushteve të kontratës. Gjithashtu për kontratën e mësipërme janë kryer dhe amendime të kontratave pa dhënë shpjegimet përkatëse. Sipas Kushteve të kontratës së parë, konsulenti z. G. F. duhej të ishte i pranishëm në Shqipëri të paktën gjysmën e periudhës së kontraktuar, e cila nga dokumentacioni i shqyrtuar nuk u arrit të vërtetohej nga grupi i auditimit.
- Në dosjet e audituara për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve, u analizua dokumentacioni i dërguar nga aplikantët fitues si dhe u verifikuan parcelat ku do të implementohej projekti në bazë të koordinatave të dhëna në projekt. Verifikimi u krye nga imazhe satelitore të marra nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ASIG, ku në bazë të kërkimit nga koordinatat e dhëna, rezultuan këto parcela të papyllëzuara, si më poshtë:
E. M. – Sh. P. K. "A."
Xh. D. – Sh. B. N. Xh.
B. T. – Sh. P. P. K. K.
E. V. – Sh. P. P. K. S.
L. M. – Sh. Sh. P. K. U. K. Gj.
Xh. H. – Sh. P. P. K. H.
Gjithashtu në fund të projekteve të pyllëzimit nuk është marrë asnjë hap mbi regjistrimin e këtyre zonave pyjore (sipas projektit), si një ndër qëllimet kryesore të zhvillimit të projektit "Shërbimet Mjedisore".

- Gjatë analizimit të realizimit të objektivave, disa nga nënkomponentët kanë pësuar ndryshime gjatë realizimit të projektit si në numër, përqindje dhe në kosto. Shumë objektiva janë jo të matshëm dhe shumë gjithëpërfshirës duke e bërë të vështirë verifikimin e realizimit të tyre.
Në analizën studimore fillestare mbi projekt idenë për implementimin e shërbimit projektet mjedisore, përfshihen shumë statistika në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor të Republikës të Shqipërisë, si dhe mbi gjendjen e popullatës që banon pranë këtyre zonave. Në analizë tregohet gjendja jo e mirë e këtij sistemi. Grupi i auditimit nuk arriti të marrë përgjigje në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor dhe të popullatës që banon pranë këtyre zonave, pas implementimit të projektit shërbimet mjedisore, nëse është përmirësuar dhe nëse ky projekt me kosto totale 20.8 Milion USD ka qene efektiv në përmirësimin e këtyre problemeve të listuara në analizën fillestare të hartuar nga Banka Botërore. (Analiza, statistika, kampione etj...)
Pjesa më e madhe e financimit të projektit 22.8 Milion USD, është shpenzuar për shërbime konsulence dhe për shpenzime operative.
**-** Në lidhje me arritjen e nënkomponentit mbi % e dërgimit të sedimenteve të llogaritura në rezervuare në zonat pilot të mbuluara nga PES (Pagesat e shërbimeve të ujëmbledhësit) e cila është 0%, për realizimin e këtij nënkomponenti janë lidhur 3 kontrata me Ref. ESP-CS-CQ-21.1 me kosto totale 15,000 Euro, ESP-CS-CQ-26 me kosto totale 230,000 Euro, ESP-CS-CQ-27 me kosto totale 60,000 Euro dhe ESP-CS-CQBS-22 me kosto totale 213,000 Euro. Pra në total janë shpenzuar 518,000 Euro për një nënkomponent i cili nuk u realizua.
**-** Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-12 me objekt "International consultant AlFIS planning, design and quality assurance" më kosto të përllogaritur në vlerën 200,000 Euro, në planifikimin e 18 mujorit të parë të vitit 2015 përfaqësohej nga procedura me Ref. ESP-CS-IC-10 me të njëjtin objekt por me kosto të ndryshme prej 120,000 Euro. Për rritjen e kostove nuk jepen shpjegime të mëtejshme. Shërbimi ishte i planifikuar të përfundonte në vitin 2016 por që është realizuar vite me vonë. Për realizimin e Kontratës është angazhuar konsulenti C. A.. Kontrata është lidhur me datë 20 Prill 2020 dhe si datë përfundimi ishte data 20 Gusht 2020, por që ka pasur amendime kontratash pa dhënë arsyet përkatëse dhe ka përfunduar me përfundimin e projektit. Në termat e referencës të kontratës nr. 557 Prot., datë 26.01.2016 midis Ministrisë së Mjedisit, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. A. B. dhe Konsultentit z. C. A. (në kontratat e lidhura nuk jepen të dhëna mbi palët ID, NIPT etj...) është përfshirë pagesa ne vlerën 520 Euro/ditë. Konsulentit sipas termave të referencës i kërkohet të hartojë raportet të ndarë në mua si më poshtë të cilat nuk i janë vënë në dispozicion dokumentacioni i mësipërm. Gjithashtu cilësohet në termat e referencës që Raportet duhet të jenë në dy gjuhë Anglisht dhe Shqip. Nga auditimi i llogarive bankare në lidhje me pagesat e kryera përkundrejt z. C. A., grupi i auditimit konstaton që pagesa e faturave nuk është në proporcion me dërgimin e raporteve sipas termave të referencës apo sipas Pikës 3. Payment të kontratës në të cilën klienti do të paguhet në rate për man/month sipas Anex B.
**-** Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-TS-ICB-7 me objekt "AlFIS Software development and implementation and associated hardware", me kosto të përllogaritura në vlerën 520,000 Euro. Në planin fillestar të procedurave të prokurimit është parashikuar me të njëjtin objekt me Ref. ESP-TS-ICB-6 por me kosto të ndryshme prej 240,000 Euro. Nuk jepen shpjegimet mbi fryrjen e kostove për të njëjtën procedurë prokurimi me të njëjtin objekt. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori JV: A. & F.. Në lidhje me Sistemin Shqiptar të Informacionit Pyjor (ALFIS), i cili ka kaluar në pronësi të AKSHI-it, që nga përfundimi i projektit Shërbimet Mjedisore 30.09.2021, nuk është populluar si dhe për sistemin në fjalë nuk është kryer mirëmbajtje duke e bërë të paaksesueshëm dhe jo në funksion për palët e interesuara si publiku,

institucionet etj...
- Nga analizimi i dosjeve të përzgjedhura nga grupi i auditimit, u konstatua përzgjedhja e një shoqate fituese të Grantit, ku Kryetari i shoqatës rezultonte debitorë pranë AZHBR, në kundërshtim me Kriterin 3.2 “Koherenca dhe Përshtatshmëria” dhe 3.11 “Lista e Debitorëve” (në rast se aplikanti ekziston në këtë listë të debitorit, kërkesa deklarohet e papranueshme për financim) MOG 2016.
Sh. B. N. Xh. me përfaqësues ligjor z. Xh. D., me adresë Njësia Administrative Lis- Bashkia Mat, Fshati Gjalish, Mallunxë. Nr. Nipt i shoqatës K.......G, data e themelimit 10/05/2000 dhe me datë regjistrimit 14.10.2004.
Total i shumës së aprovuar përmes kontributit publik është 4,957,800 lekë, nga të cilat 4,214,130 lekë përfaqësojnë 85% të kontributit nga Projekti i Bankës Botërore, ndërsa 743,670 lekë përfaqësojnë 15% të bashkëfinancimit nga kontributi privat i përfituesit të grantit.
Me datë 18.01.2018 me shkresën nr. 169 Prot., Drejtori i DAP kërkon informacion në lidhje me debitorët pranë drejtorisë së Financës, ku z. Xh. D. rezulton debitor ndaj AZHBR-së me një shumë prej 2,943,370 lekë.
Bazuar në manual, aplikimi i mësipërm duhej të deklarohej i papranueshëm për financim, por AZHBR ka vijuar me përzgjedhjen për financim të kësaj shoqate dhe ka lejuar që të kryhet ndryshimi i Kryetarit të Shoqatës dhe që të vijojë me financimin e kësaj shoqate.
- AZHBR për zbatimin e Komponentit “Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural” duhet të kryente dhe raportim, analizë risku dhe monitorim pas përfundimit të granteve të shpërndara për projektet fituese nga individët dhe shoqata.
Përfituesit e projektit në kontratat e nënshkruara me AZHBR ne nenin 8 dhe në MOG pika 3.19 e kanë të përcaktuar që përfituesit janë të detyruar për të menaxhuar investimet për 3 vjet pas marrjes së pagesave.
Gjithashtu pika 3.9 e MOG parashikon që pas vitit të tretë të përfundimit të investimit për të dy thirrjet e këtij projektit, duke filluar nga momenti i kërkesës për pagesë, një numër i investimeve (të paktën 10%) duhet të monitorohej nga AZHBR me një ekip kontrollorësh të përbërë nga specialistë të dyja institucioneve (MM dhe AZHBR) në mënyrë që të verifikohet gjendja e investimit. Përzgjedhja e investimeve objekt monitorimi, do të bëhet bazuar në procedurën e analizës së riskut. Gjetjet e këtij monitorimi do ti raportohen AZHBR dhe MM me shkresë zyrtare nga zyrtari i raportimeve në AZHBR.
Për sa më sipër grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë plan pune, analizë risku, auditim apo raport monitorimi të zhvilluara për subjektet fituese, veprime të cilat janë shkak pasoje e gjetjeve të mësipërme.
Mos realizmi i planeve të punës, analizës së riskut , auditimeve dhe raporteve të monitorimit ka sjellë shkelje të MOG dhe nenit 8 të kontratave që AZHBR ka lidhur me përfituesit e granteve. Gjithashtu mos raportimit pranë Ministrisë së Mjedisit nga Zyrtari Raportues pranë AZHBR është në shkelje me pikën 3.9 të MOG dhe çon në mos realizmin me sukses të komponentit “Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural” që i është besuar kësaj Agjencie nga Ministria e Mjedisit për projektin Shërbimet Mjedisore.

**Disa nga rekomandimet:**

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë në shqyrtim rastin e mësipërm duke nxjerrë në pah të gjitha përgjegjësit, rolin dhe angazhimet e znj. B. B., si dhe në të ardhmen të marrë në konsideratë që të mos kryejë praktika apo ndryshime të kushteve të kontratës në mënyrë të njëanshme.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë shkaqet e devijimit nga plani fillestar 18 mujor i procedurave të prokurimit duke nxjerrë në pah dhe problematikat e lindura gjatë këtyre devijimeve

dhe si ka ndikuar në arritjen e objektivave të tij, duke bërë që në të ardhmen të mos përsëriten fenomene të tilla.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë me kujdes situatat e krijuara në lidhje me vonesat mbi zbatimin e kontratave, se si kanë ndikuar ato në arritjen e objektivave të projektit, si dhe në të ardhmen të parashikohen dhe penalitete në lidhje me mos realizimin në kohë të tyre.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me hartimin, mbajtjen dhe inventarizimin e dokumentacionit, korrespondencave dhe kryesisht me dokumentacionin e projekteve të një rëndësie të lartë, t'i kryejë konform dispozitave ligjore, duke bërë të mundur transparencën dhe qasjen me to sipas kërkesave të ndryshme.
- Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të kenë si qëllim primar arritjen e objektivave të caktuara në projekte të ndryshme, duke i parë komponentët përbërës të projektit si një e tërë dhe jo të ndara nga njëra tjetra, duke bërë të mundur një alokim të fondeve sa më efektiv.
- Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të analizojnë me kujdes situatën e mësipërme, duke ngritur një grup pune për verifikimin në terren të realizimit të projekteve, për të parë nëse përzgjedhja e aplikantëve pa eksperienca të mëparshme ka rezultuar efektiv në realizimin e projekteve të fituara sipas kushteve të caktuara, si dhe në të ardhmen në përzgjedhjen e aplikantëve të bazohen në kriteret e pranueshmërisë të caktuara në manuale, rregullore, ligje etj...
- Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të analizojnë me kujdes situatën e mësipërme, të ngrejë një grup pune për verifikimin mbi vërtetësinë e dokumentacionit të sjellë nga aplikantët si dhe të anëtarëve të angazhuar, duke nxjerrë në pah rolin që kanë pasur secili nga këto persona, si është bërë alokimi i fondeve të marra nga shoqata tek anëtarët si dhe në të ardhmen të ndërpresë çdo lloj praktike të dhënies së fondeve pa dokumentacionin e duhur shoqërues dhe justifikues.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë situatën e mësipërme, duke ngritur një grup ekspertësh për të kryer verifikimin, nëse regjistrimi i pyjeve është kryer i plotë dhe pa gabime pasi nuk është kryer në përputhje me projektin "Shërbimet Mjedisore", ku në planin fillestar të prokurimeve është planifikuar që regjistrimi i pyjeve do kryhej duke marrë imazhe satelitore në kohe reale, gjë e cila është devijuar duke përdorur burime të tjera informacioni. Gjithashtu të analizohet situata në lidhje me angazhimet e znj. B. K. dhe cili ka qenë roli dhe kontributi i saj njëkohësisht si e punësuar pranë shoqërisë A. dhe si IT Expert for NFI/NEA.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë me kujdes situatën e mësipërme, për të nxjerrë në pah rolin, angazhimet dhe kontributin e z. G. F. paralelisht në realizimin e dy kontratave, arsyet mbi amendimet e kontratës si dhe vërtetësitë mbi plotësimin e kushteve të kontratës për praninë fizike pranë Republikës së Shqipërisë.

## I.3 Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Ky auditim u krye në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural për projektin "Shërbimet Mjedisore" i financuar me Hua dhe grande në total me vlerën 22.8 milion USD, të miratuara me:
Ligji nr. 151/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore",
Ligji nr. 152/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore",

Vendimi nr. 370, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si agjenci zbatuese e fondit për mjedisin global për projektin e Shërbimeve Mjedisore",

Vendimi nr. 369, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin Shërbimet Mjedisore",

Vendimi nr. 10, datë 14.01.2015, "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve Grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF072239, për projektin Shërbimet Mjedisore me Shqipërinë.

Projekti i Shërbimeve Mjedisore (PSHM) që nisi zbatimin në 29.01.2015 nga Ministria e Mjedisit, kishte si objektiv bazë mbështetjen e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës, dhe nëpërmjet tyre rritjen e përfitimeve monetare dhe jo-monetare për komunitetet në zona të caktuara të projektit, që shtrihen kryesisht në zona të larta malore që preken nga erozioni.  Sipas Raportit të Bankës Botërore Projekti erdhi për shkak të interesit të madh të qeverisë për bashkëpunim të vazhdueshëm në adresimin e sfidave mjedisore dhe rurale të jetesës në zonat e prirura nga erozioni dhe për të ndërtuar kapacitete për  të aksesuar financime të ardhshme të BE-së. Ky financim është në përputhje me Strategjinë e Asistencës Rajonale për Bashkëpunim Zhvillimor (2014-2020).

Gjatë analizimit të realizimit të objektivave, disa nga nënkomponentët kanë pësuar ndryshime gjatë realizimit të projektit si në numër, përqindje dhe në kosto. Shumë objektiva janë jo të matshëm dhe shumë gjithëpërfshirës duke e bërë të vështirë verifikimin e realizimit të tyre.

Në analizën studimore fillestare mbi projekt idenë për implementimin e shërbimit projektet mjedisore, përfshihen shumë statistika në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor të Republikës të Shqipërisë, si dhe mbi gjendjen e popullatës që banon pranë këtyre zonave. Në analizë tregohet gjendja jo e mirë e këtij sistemi. Grupi i auditimit nuk arriti të marrë përgjigje në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor dhe të popullatës që banon pranë këtyre zonave, pas implementimit të projektit shërbimet mjedisore, nëse është përmirësuar dhe nëse ky projekt me kosto totale 20.8 Milion USD ka qene efektiv në përmirësimin e këtyre problemeve të listuara në analizën fillestare të hartuar nga Banka Botërore. (Analiza, statistika, kampione etj...)

Pjesa më e madhe e financimit të projektit 22.8 Milion USD, është shpenzuar për shërbime konsulence dhe për shpenzime operative.

Në lidhje me arritjen e nënkomponentit mbi % e dërgimit të sedimenteve të llogaritura në rezervuare në zonat pilot të mbuluara nga PES (Pagesat e shërbimeve të ujëmbledhësit) e cila është 0%, për realizimin e këtij nënkomponenti janë lidhur 3 kontrata me Ref. ESP-CS-CQ-21.1 me kosto totale 15,000 Euro, ESP-CS-CQ-26 me kosto totale 230,000 Euro, ESP-CS-CQ-27 me kosto totale 60,000 Euro dhe ESP-CS-CQBS-22 me kosto totale 213,000 Euro. Pra në total janë shpenzuar 518,000 Euro për një nënkomponent i cili nuk u realizua. AZHBR për zbatimin e Komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" duhet të kryente dhe raportim, analizë risku dhe monitorim pas përfundimit të granteve të shpërndara për projektet fituese nga individët dhe shoqata.

Përfituesit e projektit në kontratat e nënshkruara me AZHBR ne nenin 8 dhe në MOG pika 3.19 e kanë të përcaktuar që përfituesit janë të detyruar për të menaxhuar investimet për 3 vjet pas marrjes së pagesave.

Gjithashtu pika 3.9 e MOG parashikon që pas vitit të tretë të përfundimit të investimit për të dy thirrjet e këtij projektit, duke filluar nga momenti i kërkesës për pagesë, një numër i investimeve

(të paktën 10%) duhet të monitorohej nga AZHBR me një ekip kontrollorësh të përbërë nga specialistë të dyja institucioneve (MM dhe AZHBR) në mënyrë që të verifikohet gjendja e investimit. Përzgjedhja e investimeve objekt monitorimi, do të bëhet bazuar në procedurën e analizës së riskut. Gjetjet e këtij monitorimi do ti raportohen AZHBR dhe MM me shkresë zyrtare nga zyrtari i raportimeve në AZHBR.
Për sa më sipër grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë plan pune, analizë risku, auditim apo raport monitorimi të zhvilluara për subjektet fituese, veprime të cilat janë shkak pasoje e gjetjeve të mësipërme.
Mos realizmi i planeve të punës, analizës së riskut , auditimeve dhe raporteve të monitorimit ka sjellë shkelje të MOG dhe nenit 8 të kontratave që AZHBR ka lidhur me përfituesit e granteve. Gjithashtu mos raportimit pranë Ministrisë së Mjedisit nga Zyrtari Raportues pranë AZHBR është në shkelje me pikën 3.9 të MOG dhe çon në mos realizmin me sukses të komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" që i është besuar kësaj Agjencie nga Ministria e Mjedisit për projektin Shërbimet Mjedisore. AZHBR për zbatimin e Komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" duhet të kryente dhe raportim, analizë risku dhe monitorim pas përfundimit të granteve të shpërndara për projektet fituese nga individët dhe shoqata.
Gjithashtu Grupit të auditimit nga zyra e Protokoll Arkivës ju vu në dispozicion dokumentacioni pa një shkresë inventarizimi, pa një numër rendor protokolli dhe datë, dokumente të shpërndara në dosje të ndryshme

# II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH"*, në zbatim të programit të auditimit me nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, i ndryshuar me nr. 346/2 Prot., datë 29.05.2024 si dhe Autorizimit nr.346/3 Prot., datë 19.06.2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua auditimi mbi përputhshmërinë për projektin "Shërbimet Mjedisore" pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural, me grupin e auditimit me përbërje:

- E. K. (përgjegjës grupi)
- I. S.
- E. S.
- K. H.
- I. U. , auditues.

## 1. Objektivat dhe qëllimi

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e konkluzionit nëse projekti "Shërbimet Mjedisore" në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.
Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.
Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

## 2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar mbi auditimin e përputhshmërisë të projektit "Shërbimet Mjedisore", në kontekstin e vlerësimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me administrimin e fondeve, hierarkinë dhe transparencën e vendimmarrjeve të organeve drejtuese.

## 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficencë.

## 4. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH-së janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

## 5. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t;
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:
Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
Ligji nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar;
Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat";
Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;
Vendimi nr. 370, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si agjenci zbatuese e fondit për mjedisin global për projektin e Shërbimeve Mjedisore" në shumën 2,880,000 USD;
Vendimi nr. 369, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin Shërbimet Mjedisore" në shumën 7,300,000 Euro;
Vendimi nr. 10, datë 14.01.2015, "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve Grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e

Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF072239, për projektin Shërbimet Mjedisore me Shqipërinë
Ligji nr. 151/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore", në shumën 7,300,000 Euro;
Ligji nr. 152/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore".

## 6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";
  si dhe në praktikat më të mira të fushës.

## 7. Metodat e auditimit

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

## 8. Dokumentimi i auditimit

Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

# III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

## 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektet nën auditim

Projekti i Shërbimeve Mjedisore (PSHM) që nisi zbatimin në 29.01.2015 nga Ministria e Mjedisit, kishte si objektiv bazë mbështetjen e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës, dhe nëpërmjet tyre rritjen e përfitimeve monetare dhe jo-monetare për komunitetet në zona të caktuara të projektit, që shtrihen kryesisht në zona të larta malore që preken nga erozioni. Sipas Raportit të Bankës Botërore Projekti erdhi për shkak të interesit të madh të qeverisë për bashkëpunim të vazhdueshëm në adresimin e sfidave mjedisore dhe rurale të jetesës në zonat e prirura nga erozioni dhe për të ndërtuar kapacitete për të aksesuar financime të ardhshme të BE-së. Ky financim është në përputhje me Strategjinë e Asistencës Rajonale për Bashkëpunim Zhvillimor (2014-2020).

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore") ka vepruar si administrator i shumës së dhënë. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka përgjegjësinë e përgjithshme për Projektin. Drejtori i Integrimi dhe Koordinimit të Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT).
Gjithashtu auditimi i shtri dhe në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural, si përgjegjëse mbi zhvillimin dhe realizimin e një nga komponentëve të projektit.

## 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### 2.1 Mbi planifikimin, studimin dhe projektimin e projekt idesë mbi zhvillimin e projektit

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, *"Mbi planifikimin, studimin dhe projektimin e projekt idesë mbi zhvillimin e projektit.)"*, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Projekti i Shërbimeve Mjedisore (PSHM) që nisi zbatimin në 29.01.2015 nga Ministria e Mjedisit, kishte si objektiv bazë mbështetjen e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës, dhe nëpërmjet tyre rritjen e përfitimeve monetare dhe jo-monetare për komunitetet në zona të caktuara të projektit, që shtrihen kryesisht në zona të larta malore që preken nga erozioni. Sipas Raportit të Bankës Botërore Projekti erdhi për shkak të interesit të madh të qeverisë për bashkëpunim të vazhdueshëm në adresimin e sfidave mjedisore dhe rurale të jetesës në zonat e prirura nga erozioni dhe për të ndërtuar kapacitete për të aksesuar financime të ardhshme të BE-së. Ky financim është në përputhje me Strategjinë e Asistencës Rajonale për Bashkëpunim Zhvillimor (2014-2020).

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore") ka vepruar si administrator i shumës së dhënë. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka përgjegjësinë e përgjithshme për

Projektin. Drejtori i Integrimi dhe Koordinimit të Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT).

Objektivi i Zhvillimit të Projektit (OZHP) ishte të mbështesë praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe të rrisë përfitimet monetare dhe jo-monetare të komuniteteve në zonat e synuara të Projektit, të cilat janë kryesisht në zonat rurale të prirura për erozion.
Ky OZHP do të arrihej nëpërmjet mbështetjes së mjeteve alternative të jetesës dhe ofrimit të shërbimeve mjedisore dhe nëpërmjet përdorimit të qëndrueshëm të produkteve të drurit dhe kullotës në afatgjatë. Projekti do të fokusohej veçanërisht në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare, ekonomike dhe institucionale të përdorimit të tokës dhe menaxhimit të burimeve natyrore dhe do të ndihmonte në ngritjen e kapaciteteve të fermerëve të Shqipërisë, organizatave komunitare dhe institucioneve qeveritare për të përdorur në mënyrë efikase fondet e BE-së.

**Analizimi i kontekstit të vendit ku do të kryhet projekti nga Banka Botërore**

*Shqipëria mbajti një rritje të lartë ekonomike në dekadën para krizës financiare të 2008-ës, duke mundësuar arritjen e statusit të të ardhurave mesatare dhe uljen e varfërisë.*
*Megjithatë, që nga viti 2011 me përkeqësimin e mjedisit të jashtëm, normat e varfërisë treguan një rritje nga 12.4 përqind në 14.3 përqind.*[1] *Rritja në Shqipëri parashikohej të mbetet modeste, mesatarisht vetëm 2 përqind midis 2014 dhe 2016. Rritja e deficiteve fiskale, rritja e borxhit publik dhe rritja e ngadaltë në sektorët kryesorë të ekonomisë pritej të kufizonte shpenzimet në sektorin e burimeve natyrore. Në këtë kontekst, mbështetja ndërkombëtare e zhvillimit u konsiderua thelbësore për ruajtjen e ritmit të reformave strukturore. Në vlerësim, Qeveria e Shqipërisë (QSH) identifikoi bujqësinë, zhvillimin rural dhe turizmin ndër prioritetet e saj kryesore për 2013-2017, me potencialin e mbajtjes së pyjeve për të mbështetur rritjen ekonomike, punësimin rural dhe ruajtjen e mjedisit. Si komponentë të ndërlidhur në përdorimin e tokës rurale, bujqësia dhe pylltaria ishin kritike për fshatarët që menaxhonin sisteme të ndryshme agro-pylltarie dhe silvo-pastoral. Shqipëria ishte gjithashtu ndër vendet më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike në Evropë dhe Azinë Qendrore për shkak të topografisë së saj të pjerrët, zonave bregdetare të ulëta të populluara dhe mbështetjes në ujë për energji dhe bujqësi. Ngjarjet ekstreme të motit më të shpeshta dhe të rënda (përmbytjet dhe thatësirat) dhe pritej rritje e rrezikut nga zjarri në zonat pyjore dhe kullosore. Këto rreziqe të ndryshimeve klimatike për sektorët e pyjeve dhe bujqësisë në Shqipëri ishin (dhe vazhdojnë të jenë) potencialisht serioze pasi shumica e popullsisë rurale varet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga pyjet dhe bujqësia.*
*Edhe pse Shqipëria ka një përqindje të lartë të mbulesës pyjore, shumica e pyjeve dhe kullotave ishin* ***në gjendje e keqe****. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2.9 milionë hektarë (ha), 52 përqind (1.50 milionë ha) vlerësohet të jetë pyll, 17 përqind (0.48 milionë ha) kullotë dhe 3 përqind (87,000 ha) tokë bujqësore. Mbulesa pyjore u klasifikua si pyje 30 për qind e lartë, 42 përqind cungishte dhe 28 përqind shkurre. Vëllimi i lëndës drusore ishte i përqendruar në pyjet e larta (80 përqind), e ndjekur nga cungishtet (19 përqind) dhe shkurret (0.2 përqind). Erozioni i tokës është identifikuar si një problem madhor për Shqipërinë. Kohët e fundit, tokat shumë të degraduara janë subjekt i erozionit të vazhdueshëm. Çdo vit në nivel kombëtar,* ***20-901 ton/ha tokë ose 2.5-3 mm*** *e shtresës së tokës gërryhet dhe shkarkohet në det ose mbush rezervuarët (përfshirë rezervuarët e hidrocentraleve) duke reduktuar kapacitetin e tyre në mënyrë të ndjeshme. Degradimi dhe mbi*

[1] Studimi i erozionit dhe zvogëlimit të sedimentimit të tokës, TRINITY Enviro 2010

*shfrytëzimi i zonave të gjelbëruara në mënyrë natyrore (pyje dhe kullota) është shkaku kryesor i këtyre fenomeneve dramatike.* ***Rehabilitimi i mbulesës bimore për të ndaluar erozionin është i rëndësisë thelbësore.***

*Sektori i pyjeve kishte pësuar reforma thelbësore që rezultuan në ndryshime në role, mandate dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit, njësive të qeverisjes vendore (NJQV), përdoruesve tradicionalë dhe sektorit privat. Nga vlerësimet e bëra, rreth 60 përqind ose rreth 780 000 ha pyje dhe kullota në pronësi shtetërore ishin transferuar në pronësi komunale, megjithëse tokat e transferuara tek NJQV-të prireshin të degradoheshin nën menaxhimin komunitar, rritja vjetore e përmirësimit të pyjeve cungishte mund të arrijë dyfishin e mesatares kombëtare - 3 m3 /ha krahasuar me 1.4 m3 /ha.*

***Sfidat mbetën me regjistrimin e tokave pyjore dhe kullosore të transferuara dhe planifikimin menaxheriale****. Vetëm një pjesë e vogël e tokave të transferuara në pronësi të NJQV-së u regjistrua në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (tani Agjencia Shtetërore e Kadastrës) Një nga objektivat kryesore të strategjisë së sektorit pyjor të Shqipërisë ishte mbështetja e procesit të transferimit të tokave pyjore dhe kullosore shtetërore tek NJQV-të. Shumica e planeve të menaxhimit për njësitë pyjore kishin skaduar. Udhëzimet e planifikimit nuk ishin në përputhje me strukturat e reja dhe as nuk po shfrytëzonin më së miri përparimet teknologjike. Një ligj i ri për burimet pyjore dhe kullosore ishte në zhvillim e sipër për të pasqyruar ndryshimet në strukturën e pronës dhe përgjegjësitë e menaxhimit.*

*Kontributet e grave në pylltari, bujqësi dhe kontributet e tyre financiare për familjet nuk njiheshin plotësisht. Përdoruesit tradicionalë, fermerët, i menaxhonin këto toka të transferuara përmes të drejtave zakonore kryesisht për të plotësuar nevojat bazë për dru zjarri dhe foragjere.* ***Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave (SHPPK) në përgjithësi i përjashtuan gratë nga postet drejtuese****. Gratë rurale kishin të drejta të kufizuara për pronat e paluajtshme që mund të përdoreshin për të marrë kredi.* ***Grave u mungonte qasja në planifikimin e biznesit dhe njohuritë për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të komunitetit, familjes dhe vetes****.*

*Sfida ekzistonte edhe në organizimin  institucional të sektorin pyjor. Analizat treguan se kishte struktura të përziera paralele në nivel qendror dhe rrethi.* ***Në nivel kombëtar, Ministria e Mjedisit (MM) kishte role të dyfishta si në krijimin ashtu edhe në zbatimin e politikave. Në nivel kombëtar funksionet e kontrollit ishin të ndara, por në nivelet e rretheve kishte konfuzion rreth përgjegjësive të menaxhimit të pyjeve shtetërore dhe komunale***

*Financimi i pamjaftueshëm për të trajtuar degradimin e tokës ishte një problem kyç në këtë sektor. Pyjet e transferuara në përgjithësi* ***ishin shumë të degraduara*** *dhe* ***përdoruesve u mungonin mjetet për të gjeneruar*** *të ardhura për të mbështetur menaxhimin për dekadën e ardhshme. Pyjet e larta ,nën pronësinë shtetërore, u shfrytëzuan tepër dhe në mënyrë të parregullt. Një rishikim i vitit 2013 tregoi se nën-sektorët e mjedisit, pylltarisë dhe ujit pësuan reduktime të qëndrueshme buxhetore. Gjithashtu, departamentet teknike të MM-së kishin mungesë të personelit, me kompetenca në mospërputhuje me sfidat teknike. Nga viti 2007 deri në vitin 2012 vetëm pesë për qind e shpenzimeve publike mjedisore i janë kushtuar pylltarisë, kryesisht për shpenzime korrente.* ***Për më tepër, të ardhurat maksimale të krijuara ishin vetëm 33 për qind e këtyre shpenzimeve.***

*Deri në vitin 2013 donatorët kishin siguruar të gjitha investimet publike në pylltari. Strategjia Ndër sektorialë Mjedisore e vitit 2007, pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, identifikoi nevojën për më shumë investime për t'u adresuar; degradimi i tokës; ndarja e drejtë e përfitimeve nga pyjet komunale; pjesëmarrja e barabartë gjinore në vendimet për pyjet; dhe ngritja e kapaciteteve të NJQV-ve dhe shoqatave për të financuar përmirësimin e pyjeve dhe gjenerimin e të ardhurave.*

*Nga viti 1995 deri në vitin 2013, Qeveria e Shqipërisë, Banka Botërore, Fondi Global i Mjedisit (GEF) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) financoi një sërë operacionesh. Këto projekte përfshinin Projektin e Pylltarisë Shqiptare (PPSH), Projektin e Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN), Projektin e Menaxhimit të Përmirësuar të Burimeve Natyrore (PMPBN) dhe një Projekt të Asistuar të Rigjenerimit Natyror për të sekuestruar karbonin. Është ofruar mbështetje për përmirësimin e pylltarisë shtetërore dhe komunale planifikimin dhe menaxhimin, sekuestrimin e karbonit, si dhe zhvillimin institucional të sektorit pyjor.*

*Arsyetimi për përfshirjen e Bankës: Ky projekt (Projekti i Shërbimeve Mjedisore – ESP) synonte të maksimizonte ofrimin e shërbimeve mjedisore duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të komuniteteve të varura nga burimet mjedisore lokale për jetesën e tyre. Projekti synonte gjithashtu të ndërtonte kapacitete për të aksesuar pararendësit në fondet e BE-së, p.sh. Natura 2000, IPARD. ESP u ndërtua mbi mësimet e nxjerra dhe praktikat e mira nga projektet e mëparshme në vend dhe të tjera në operimin e Bankës, si dhe një partneritet të fortë me Qeverinë Suedeze e cila bashkëfinancoi përgatitjen dhe zbatimin.*

***Analizimi i kontekstit socio-ekonomik***

*Varfëria si një rezultat i mundësive të kufizuara për punësim dhe niveli i ulët i të ardhurave, veçanërisht në zonat malore rurale, është një nga sfidat kryesore për tu trajtuar nga çdo projekt i mundshëm zhvillimi rural në zonat e synuara të studimit. Fermerët në zonat e synuara të Projektit të angazhuar në bujqësi të vogël* **nuk kanë akses në tregje për produktet e tyre***, veçanërisht në zonat malore.* ***Pa tregje, fermerët nuk mund të shtojnë të ardhurat e tyre dhe standardet e jetesës.*** *Gjithashtu, problemet e tyre ndërlikohen nga:*

*-një mungesë e informacionit mbi tregjet*

***-mungesa e përputhjes me higjienën ushqimore dhe standardet e sigurisë (veçanërisht qumështi dhe produktet e tjera të bulmetit, shpendët dhe produktet e tjera blegtorale, etj.)***

*-kapacitete të ulëta në përpunimin dhe marketimin (paketim dhe etiketim të cilat i bëjnë produktet e tyre jo-konkurruese).*

***-Prodhimi dhe produktiviteti i fermave pengohen gjithashtu nga njohuritë e kufizuara teknike, pajisje të vjetra, çmime të larta dhe cilësi e diskutueshme e inputeve, tregjet e largëta, mungesa e shërbimeve financiare, popullatës fermerë në plakje të përbërë kryesisht nga gra dhe burra të vjetër,*** *meqenëse të rinjtë gjithnjë kanë tendencë të migrojnë dhe imigrojnë në kërkim të një jete më të mirë dhe mundësi më të mira punësimi.*

*Ka probleme që lidhen me regjistrimin dhe pronësinë e tokës. Toka bujqësore është privatizuar tashmë, por regjistrimi i tokës mbetet i papërfunduar. Toka pyjore mbetet ende pronësi shtetërore. Strategjia e qeverisë për të transferuar tokën pyjore dhe kullosore në qeveritë vendore po përparon mjaft ngadalë. Tregu i tokës është i pazhvilluar. Ka vetëm pak transaksione, si në qiradhënie ashtu dhe tregun e shitjes, e gjitha nga familja në familje dhe shumica informale. Për të shmangur kostot e larta të transaksionit, njerëzit kryesisht bëjnë transaksione informale të tokës.*

***Një tjetër problem që lidhet me regjistrimin e pronësisë se tokës është që regjistrimi behet vetëm nga burri apo kryefamiljari në rastin e familjeve të mëdha fermerë, i cili e regjistron pronën në emër të vet. Edhe pse ligji lejon ndarjen e barabarte të pronave midis burrit dhe gruas, në shumicën e rasteve toka trashëgohet vetëm në linjën mashkullore të familjes dhe titujt e pronësisë janë vetëm në emër të tyre (meshkujve).*** *Ekonomia rurale në Shqipëri karakterizohet nga role të qarta gjinore. Puna bujqësore e grave kryesisht kufizohet në produktet e kopshtit, rritja e pulave dhe gjedhit. Por rëndësia e tyre për mirëqenien e familjes përfshirë rritjen e fëmijëve dhe kujdesi për të moshuarit është shumë i madh dhe gratë në zonat rurale punojnë më shumë orë në*

*ditë krahasuar me çdo grup tjetër.* ***Puna e grave nuk shpërblehet dhe gratë janë të varura financiarisht nga burrat.*** *Gratë rurale janë përgjithësisht jo të punësuara por të identifikuara si të vetë-punësuara dhe për këtë arsye ato nuk mund të përfitojnë nga skemat e sigurimeve sociale dhe shëndetësore.*

*Gratë rurale janë të varura gjithashtu nga aksesi në burimet pyjore për jetesën e tyre dhe ky Projekt do të trajtojë* ***mungesën e përfshirjes së grave në vendim-marrjen e SHPPK (****Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave)* ***dhe të përfshijë çështjet gjinore në shërbimet mjedisore*** *dhe të lehtësojë bërjen e grave përfituese të skemës së granteve në mënyrë të barabartë me burrat.*

***Eksperienca ekzistuese***

*Në Shqipëri, procesi i hartimit të legjislacionit dhe politikave kombëtare mjedisore bazohet në kërkesat e përcaktuara nga përafrimi me Legjislacionin e BE dhe politikat mjedisore të BE. Një numër nismash janë ndërmarrë në fushën e politikë-bërjes mjedisore strategjike. Strategjia Kombëtare e Mjedisit (SKM) e vitit 2006 përcakton objektiva për zgjidhjen e problemeve mjedisore ekzistuese. Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM) 2007 ofron udhëzim të përgjithshëm mbi zgjidhjen e problemeve që dalin nga sektorët që kanë një ndikim mbi mjedisin. Pyjet dhe kullotat janë diskutuar në SNM. Shqipëria ka marrë mbështetje nga organizatat ndërkombëtare dhe vendet donatore për aktivitetet e saj legjislative dhe planifikuese. Megjithatë, monitorimi i progresit, vlerësimi i të dhënave dhe treguesve dhe vlerësimi i efikasitetit të politikave duhet të forcohen (UNECE, Albania 2$^{nd}$ EPR).*

*Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN) ka mbështetur reformën e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve.  Projekti ka mbështetur zhvillimin e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale në 281 komuna. Projekti punoi për rehabilitimin e burimeve dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave në shumicën e tokave komunale të zonave të larta të Shqipërisë që presin përkeqësim të burimeve natyrore dhe erozion. Ai ka mbështetur përgatitjen e planeve të menaxhimit dhe zbatoi një seri investimesh të vogla dhe masa për ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar qeverisjen e burimeve të pyjeve dhe kullotave. Gjithashtu ,në periudhën e projekt idesë për Shërbimet Mjedisore, Shqipëria ka qenë duke zbatuar një projekt "Mekanizimi i Zhvillimit të Pastër" (MZHP) për sekuestrimin e karbonit i cili ka qenë një pjesë integrale e PZHBN. Objektivi i Projektit MZHP për Rigjenerimin Natyror të Asistuar në Shqipëri është të gjenerojë Reduktime të Certifikuara të Shkarkimeve të përkohshme (RCSHp) nëpërmjet rigjenerimit natyror të asistuar dhe ripyllëzime të tokave shumë të degraduara, të cilët gjithashtu do të sjellin burime të përmirësuara të jetesës dhe të ardhura në zonat e varfra rurale, degradim toke të pakësuar, cilësi të përmirësuar uji dhe ruajtje të biodiversitetit.*

Projekti i propozuar do të trajtonte çështjet e lidhura me:

- zbatimin e aktiviteteve kritike në vendndodhje kritike për të reduktuar degradimin e tokës në afat të shkurtër
- sigurimi i ndarjes së barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi i pyjeve komunale
- përfshirjen e burrave dhe grave në vendim-marrjen për pyjet e cila reflekton prioritetet gjinore dhe përmirëson praktikat e ruajtjes se tokës,
- kapacitetet e ulëta të njësive të pushtetit vendor dhe shoqatave të përdoruesve veçanërisht në kuptimin/përllogaritjen e të ardhurave të mundshme afat-mesme për shfrytëzimin e pyllit dhe burimet e mundshme të financimit në afat të mesëm (5 deri 10 vjet)
- reformat politike dhe programet në kuptimin që duhet të ketë një strategji koherente për të zbatuar politikat rurale/mjedisore/pyjore të shoqëruar me mundësi realiste financimi në afat të gjatë.

Projekti i propozuar ESP kishte si qëllim kontributin në arritjen e Qëllimeve të Strategjisë të Partneritetit për Vendin (SPV), 2010 – 2014, veçanërisht në (iii) Reduktimi i vulnerabilitetit të Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimaterike duke përmirësuar ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin efikas të burimeve të saj ujore dhe duke forcuar përgatitjen ndaj katastrofave. Reduktimi i degradimit të tokës të shkaktuar nga njerëzit ul transportimin e sedimentit në lumenj dhe diga, duke kontribuar në këtë mënyrë në ruajtjen e burimeve ujore dhe qëndrueshmërinë e menaxhimit të burimeve ujore. Ndalimi i degradimit duke përmirësuar mbulesën bimore, pemë, shkurre, gëmusha dhe bar, gjithashtu e përmirëson biodiversitetin.

Projekti i propozuar kontribuon gjithashtu në (i) Përshpejtimin e rimëkëmbjes në rritjen ekonomike të Shqipërisë nëpërmjet konkurrueshmërisë së përmirësuar duke përforcuar menaxhimin makroekonomik dhe të shpenzimeve publike, duke përmirësuar rregulloret e biznesit dhe duke reduktuar kostot e zbatimit të ligjit, duke mbështetur bankat vendore dhe kompanitë vendase konkurruese, dhe duke përmirësuar shërbime kyç të infrastrukturës dhe qëndrueshmërinë e tyre financiare duke përmirësuar qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të sektorit të pyjeve dhe kullotave.

**Objektivi kryesor i projektit** ishte përmirësimi i praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të tokës, i ndjekur nga pakësimi i degradimit të tokës dhe shtimi i të ardhurave të komunitetit të synuar. Projekti i Shërbimeve Mjedisore (ESP) synon të ruajë dhe zbatojë Planet ekzistuese të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunale (PMPKK) dhe Planet e Menaxhimit të Mikrobaseneve Komunale (PMMK) të mbështetura në kuadër të Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN) tashmë të mbyllur, dhe shtrirja e procesit në komunat pa plane.

**Përfituesit e Projektit**

Projekti do të jepte përfitime ose drejtpërdrejt ose tërthor fermerëve dhe shoqatave dhe grupeve të veprimit që i përfaqësojnë **në 2980 fshatra, në 310 komuna rurale**.

Popullata urbane dhe gjysmë-urbane më shumë se një milionë që jeton poshtë rrjedhës do të përfitojë tërthorazi nga një menaxhim më i **qëndrueshëm i baseneve ujëmbledhës**, i cili do të kontribuojë për disponueshmërinë e burimeve ujore për përdorimin e tyre.

Një numër paraprak prej 900 vetë staf në qeveri dhe njësitë e pushtetit vendor, përfshirë stafin e pylltarisë, mjedisit, ekstensionit dhe agjencisë së pagesave do të përfitojnë nga aktivitetet e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve.

Fusha e veprimit të projektit të propozuar është kombëtare në kuptimin që ofron mundësi të barabarta për përdoruesit e pyjeve dhe kullotave në secilën prej komunave dhe SHPPK-të ku është përgatitur një plan menaxhimi për pyjet dhe kullotat ose një plan menaxhimi i mikrobasenit, për të marrë pjesë duke aplikuar për grante për zbatim, dhe për përdoruesit e pyjeve dhe kullotave në ato komuna të cilat e kanë këtë plan të përgatisin një plan menaxhimi.

**Treguesit e Rezultateve të Nivelit të OZHP**

Treguesit për matjen e ndikimit të bërë nga projekti janë:

i) Zonat e tokës ku janë miratuar praktika të qëndrueshme të menaxhimit të tokës si rezultat i projektit;
ii) Njerëzit në pyjet e synuara dhe komunitetet ngjitur me përfitime monetare ose jo monetarë të rritura nga pylli, kullotat dhe tokat bujqësore të ndara sipas gjinisë
iii) Zvogëlimi i degradimit të tokës dhe rrjedhjes së sedimenteve sipas llojit të tokës.

**Strategjia e Projektit**
Strategjia e përzgjedhur e projektit është e dyfishtë:
1) Përfituesit e drejtpërdrejtë – fermerët, gra dhe burra, dhe përdoruesit e burimeve të tokës do të marrin përgjegjësinë për menaxhimin e tokave të tyre dhe do kërkojnë në mënyrë aktive shërbime financiare, zgjerimi dhe biznesi për të vazhduar menaxhimin e qëndrueshëm të tokës së tyre.
2) Qeveria qendrore dhe vendore do të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm, të përshtatshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës në të cilin strukturat institucionale dhe administrative mbeten pavarësisht nga politikat.
Projekti do të parapërgatitë përfituesit që ata të jenë në gjendje të konkurrojnë në të ardhmen për shërbime, si p.sh. financimet.

**Komponentët e Projektit**
Struktura e Komponentëve të Projektit

**Pjesa 1:** Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit. (Kosto 7.8 milionë euro, nga të cilat 4.5 milionë euro IBRD, 0.3 milionë euro GEF dhe 3.0 milionë euro Sida)

Ky komponent synonte të ndërtonte një mjedis të qëndrueshëm institucional që lehtëson menaxhimin e qëndrueshëm të zonave malore, në këtë mënyrë përmirëson ofrimin e shërbimeve mjedisore. Për të menaxhuar pyjet, kullotat dhe mikro basenet ujore në mënyrë të qëndrueshme, është e nevojshme të dihet shtrirja dhe gjendja e burimeve në tërësi në mënyrë që të ketë një strukturë të saktë, në të cilin të përmirësohen burimet dhe të përcaktohen prioritetet. Komponenti do të forcojë më tej institucionet kombëtare të sektorit pyjor duke regjistruar pronësinë e tokës dhe duke mbështetur zbatimin e reformës institucionale dhe agjendës së zhvillimit në Ministrinë e Mjedisit, Drejtorinë e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Drejtoritë Rajonale të Pyjeve, Zyrat Pyjore të Rrethit dhe ofrimi i ndihmës për analiza të mëtejshme të mangësive ligjore të rregulloreve dhe udhëzimeve. Nënkomponentët janë si mëposhtë:

a. Forcimi i kapaciteteve të Huamarrësit për menaxhimin e pyjeve dhe të kullotave, duke përfshirë;
- përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve për të zbuluar ndryshimet dhe për të dhënë informacion sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volume i pyjeve për periudhën e ndërhyrjes për të cilën do të bihet dakord;
- zhvillimin e një Inventari Kombëtar të Pyjeve të shtrirë në dhjetë vjet, nëpërmjet të cilit parcelat e kampionuara për mbulim nga pyjet dhe volum pyjor ekzaminohen çdo vit për dhjetë vjet rresht;
- mbështetjen e planifikimit të menaxhimit të pyjeve në pyjet prodhuese të menaxhuara nga shteti, duke përjashtuar zonat e mbrojtura;
- krijimin e Sistemit shqiptar të Informimit për Pyjet;
- forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Pyjor për të realizuar detyrimet e saj, duke përfshirë edhe monitorimin e pavarur të pyjeve ;
- regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që i janë transferuar komunave nga qeveria qëndrore.

b. Realizimi i aktiviteteve për të fuqizuar përfituesit, duke përfshirë Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV), Shoqatat Komunale të Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave (SHKPPK) dhe fermerët për të përdorur praktika menaxhimi të qëndrueshëm të tokës dhe të kullotave, duke përfshirë:

- zbatimin e Planit Gjinor të Veprimit për të nxitur barazinë gjinore në menaxhimin e burimeve natyrore;
- mbështetjen e Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) për të kontribuar për strategjinë e zhvillimit;
- trajnimin e NjQV-ve dhe SHKPPK-ve për përdorim të qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe tokave bujqësore;
- nxitjen e gjenerimit të të ardhurave rurale nëpërmjet analizave të zinxhirit të vlerave, përgatitjes së planeve përpunuese dhe tregtimit të produkteve pyjore afatshkurtra dhe afatmesme.

**Pjesa 2.** Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës (Kosto 6.8 milionë euro, nga të cilat 2.7 milionë euro IBRD, 1.1 milionë euro GEF, 3 milionë euro Sida)

Ky komponent synonte rritjen e ofrimit të shërbimeve mjedisore për përfituesit dhe shoqërinë në tërësi, duke rritur mundësinë për përfitime dhe jetesën e pronarëve/përdoruesit/menaxherët e tokës nëpërmjet përmirësimit të pyjeve, kullotave dhe menaxhimi i mikro-baseneve. Gjithashtu, do të mbështesë përpjekjet e qeverisë për të absorbuar fondet IPARD kur ato bëhen të disponueshme, të ndihmojnë në zbutjen e varfërisë në zonat rurale dhe të përmirësojnë menaxhimin e përdorimit të tokës nëpërmjet planifikimit të integruar dhe një skeme konkurruese grantesh. Nënkomponentët janë si mëposhtë:

a. Realizimi i aktiviteteve për të përgatitur dhe zbatuar Planet Komunale Për Mikrobasenet (PKM) për përmirësimin e menaxhimit të tokës, duke përfshirë;

- hartimin e udhëzimeve për përgatitjen e PKM-ve për nxitjen e përdorimit të integruar të burimeve natyrore;
- përgatitjen e PKM-ve për komunat e reja;
- përditësimin e Planeve ekzistuese Komunale të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave (PKMPK), të cilat do të transferohen në KPM gjatë kohëzgjatjes së Projektit.

b. Dhënia e granteve për përfituesit që i plotësojnë kriteret për realizimin e Nënprojekteve.

c. Forcimi i kapaciteteve të stafit të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Pyjeve, Zyrës së Pyjeve në Rreth, AZHBR-së dhe i organeve të tjera të përfshira në shërbime bujqësore pyjore, si dhe i aplikueseve të cilët do të përmbushin përgjegjësitë e tyre bazuar në këtë Projekt.

**Pjesa 3.** Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore (Kosto 1.2 milionë euro, nga të cilat 0.8 milionë euro GEF, 0.4 milionë euro Sida)

Ky komponent do të ndihmonte në vendosjen e mekanizmave financues për të reduktuar degradimin e tokës dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë:

- përgatitjen e studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe krijimin e sistemeve të monitorimit, raportimit dhe verifikimit për të përcaktuar masën e karbonit të sekuestruar nëpërmjet aktiviteteve të Projektit;
- zhvillimin e mekanizmave për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit për t’u siguruar se ata që përfitojnë nga shërbimet mjedisore I paguajnë prodhuesit e këtyre shërbimeve dhe zhvillimin e një modeli për lidhjen e praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit;
- pilotimin e mekanizmit për Pagimin e Shërbimeve të Ujëmbledhësit në zonat e përzgjedhura.

**Pjesa 4.** Mbështetja për Zbatimin e Projektit (Kosto 1 milion euro, nga të cilat 0.1 milionë euro IBRD, 0.9 milionë euro Sida)

Objektivi i këtij komponenti ishte të mbështesë MM për të kryer zbatimin normal të projektit dhe koordinimin e përgjithshëm sipas marrëveshjes së ratifikuar.
a. nëpërmjet realizmit të aktiviteteve për zbatimin e Projektit, duke përfshirë furnizimin me pajisje zyre, ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e garancive mjedisore.
b. ofrimit dhe instalimit të sistemit të informacionit për monitorimin e Projektit për promovimin e gjurmimit efektiv të aktiviteteve të projektit dhe realizimin e sondazheve , auditeve mjedisore, monitorimit dhe vlerësimit.

**Përgjegjësit për arritjen e objektivave**
MM do të jetë Agjencia Zbatuese kryesore për projektin, e mbështetur nga Drejtoria Rajonale e Pyjeve (DRP), Zyra Pyjore e Rrethit (ZPRR), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e Inventarit Kombëtar të Pyjeve, planifikimin shtetëror të menaxhimit të pyjeve dhe Sistemin Shqiptar i Informacionit të Pyjeve (AlFIS); ZRPP do të jetë përgjegjëse për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave komunale (ZRPP) dhe AZHBR për administrimin e skemave konkurruese të granteve.
MM do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm, koordinimin dhe monitorimin e rezultateve të Projektit. Për këtë qëllim, MM do të krijojë një Ekip të Menaxhimit të Projektit (PMT) i përbërë nga: Drejtori i Projektit, Koordinatori i Projektit, Koordinatorët e Komponentit, Specialistët e Prokurimit, Menaxhimit Financiar, Monitorimit dhe Vlerësimit (M&E), Specialistët Teknik, Specialisti i Masave Mbrojtëse. Drejtori i emëruar i Projektit është Drejtor i Integrimit Evropian dhe Projekteve; Koordinatorët e komponentit, Monitoruesit dhe vlerësuesit dhe specialistët për çështjet gjinore emërohen Nëpunës civilë.

Më tej, për të siguruar koordinimin në nivel teknik, do të krijohet një Komitet Teknik që do të përfshijë Drejtorin e Projektit, koordinatorët e komponentëve, koordinatorët e aktiviteteve dhe staf teknik shtesë sipas nevojës.

Një Komitet Drejtues i Projektit (KDP) do të krijohet dhe do të mbahet gjatë gjithë jetës së Projektit për të siguruar koordinimin institucional dhe për të siguruar mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit. KDP do të kryesohet nga Ministria e Mjedisit dhe do të përfshijë Drejtorin e Projektit, përfaqësues të MM-ja, AKM-ja, ZRPP-ja, AZHBR-ja, Autoriteti Menaxhues MBZHRAU-së, Ministria e Financave (MF), Departamenti për Programimin e Zhvillimit, Financimin dhe Ndihmën së Huaj, Këshilli i Ministrave, një kryetar komune dhe Federata Kombëtare e SHPPK-ve.

**Monitorimi dhe Vlerësimi i Rezultateve**
MM-ja është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e programit të Monitorimit dhe Vlerësimit. Një anëtar i stafit nga çdo agjenci caktohet për të raportuar në MM mbi aktivitetet e projektit, të zbatuara nga agjencia e tyre. Asistencë teknike do të ofrohet nga Projekti për hartimin e Sistemit të Monitorimit të Informacionit dhe trajnimin e stafit të agjencive zbatuese. Monitorimi i rezultateve bazohet në Strukturën e Rezultateve dhe objektivat e synuara të performancës vjetore, të cilat do të përdoren për të gjurmuar progresin në aktivitetet e zbatimit.

**Për sa më sipër nga grupi i auditimit u konstatua:**

- Gjatë analizimit të realizimit të objektivave, disa nga nënkomponentët kanë pësuar ndryshime gjatë realizimit të projektit si në numër, përqindje dhe në kosto.
- Që gjatë analizimit të realizimit të objektivave të projektit, hasi vështirësi në verifikimin e tyre, pasi shumë objektiva janë jo të matshëm dhe shumë gjithëpërfshirës.
- Në lidhje me arritjen e nënkomponentit mbi % e dërgimit të sedimenteve të llogaritura në rezervuare në zonat pilot të mbuluara nga PES (Pagesat e shërbimeve të ujëmbledhësit) e cila është 0%, për realizimin e këtij nënkomponenti janë lidhur 3 kontrata me Ref. ESP-CS-CQ-21.1 me kosto totale 15,000 Euro, ESP-CS-CQ-26 me kosto totale 230,000 Euro, ESP-CS-CQ-27 me kosto totale 60,000 Euro dhe ESP-CS-CQBS-22 me kosto totale 213,000 Euro. Pra në total janë shpenzuar 518,000 Euro për një nënkomponent i cili nuk u realizua.
- Në lidhje me Sistemin Shqiptar të Informacionit Pyjor (ALFIS), i cili ka kaluar në pronësi të AKSHI-it, që nga përfundimi i projektit Shërbimet Mjedisore 30.09.2021, nuk është popullua si dhe për sistemin në fjalë nuk është kryer mirëmbajtje duke e bërë të pa aksesueshëm dhe jo në funksion për palët e interesuara si publiku, institucionet etj...
- Në analizën studimore fillestare mbi projekt idenë për implementimin e shërbimit projektet mjedisore, përfshihen shumë statistika në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor të Republikës të Shqipërisë, si dhe mbi gjendjen e popullatës që banon pranë këtyre zonave. Në analizë tregohet gjendja jo e mirë e këtij sistemi. Grupi i auditimit nuk arriti të marrë përgjigje në lidhje me gjendjen e sistemit pyjor dhe të popullatës që banon pranë këtyre zonave, pas implementimit të projektit shërbimet mjedisore, nëse është përmirësuar dhe nëse ky projekt me kosto totale 20.8 Milion USD ka qene efektiv në përmirësimin e këtyre problemeve të listuara në analizën fillestare të hartuar nga Banka Botërore. (Analiza, statistika, kampione etj...)
- Pjesa më e madhe e financimit të projektit 20.8 Milion USD, është shpenzuar për shërbime konsulence dhe për shpenzime operative.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, z. A. B., z. A. K., Ekipi i Menaxhimit të Projektit z. E. I. , znj. B. B., Komiteti Drejtues i Projektit, Drejtuesit e Projektit dhe Komiteti Teknik i Projektit, në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin Shërbimet Mjedisore.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar në institucion me nr. 346/9, datë 01.11.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:*

**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur)**:.......... Ndryshimet në përbërjen e nën-komponentëve të projektit gjatë zbatimit të tij, justifikohen me reformën institucionale dhe nevojave për t'u përshtatur me ambientin e ri institucional për mirëqeverisjen e pyjeve dhe kullotave. Gjatë zbatimit të projektit ka pasur disa faktorë të jashtëm që kanë ndikuar në aktivitetet e projektuara të projektit dhe kanë detyruar ndryshimet e nevojshme në qasjen, aktivitetet dhe kornizën e rezultateve. Ndër këta faktorë, zhvillimet kryesore institucionale janë:

• Ligji 5/2016 për moratoriumin e lëndës drusore. Qëllimi i ligjit të miratuar nga parlamenti shqiptar ishte të ndalonte prerjen e lëndës drusore në tokat pyjore publike dhe private me qëllim lehtësimin e kontrollit ndaj aktiviteteve të paligjshme dhe ndalimin e degradimit të mëtejshëm të tokave pyjore që ndodhi në shumë zona pyjore në Shqipëri. Moratoriumi ndalon prerjen e lëndës drusore për përpunim industrial, duke ndikuar kështu në një nga aktivitetet e projektit lidhur me analizën e zinxhirit të vlerës së përpunimit të lëndës drusore.

• Transferimi i funksionit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave nga pushteti qendror tek organet e qeverisjes vendore. Më 31 korrik 2014, Kuvendi miratoi ligjin 115/2014 "Për ndarjen territoriale dhe administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", duke ulur numrin e njësive të qeverisjes vendore (NJQV) nga 384 në 61 bashki. Funksioni i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave u transferua nga niveli qendror në atë lokal. Një zhvillim i

tillë ndikoi në zbatimin e projektit, pasi tashmë fokusi zhvendosej edhe me shume ne njësitë e qeverisjes vendore, me të gjitha sfidat për ngritjen e strukturave të reja në nivel vendor, çështjet rregullatore që do të specifikoheshin, mungesa e burimeve njerëzore, transferimi i pyjeve dhe kullotave dhe shumë të tjera.
• Miratimi i VKM 360/2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar për kufijtë administrativo-territorial të njësive të qeverisjes vendore". Këshilli i Ministrave të Qeverisë Shqiptare ka miratuar hartën e përditësuar të kufijve administrativo-territorial për njësitë e qeverisjes vendore. Kjo preku kryesisht ndarjen e territoreve pyjore dhe kullosore për një sërë bashkish, të cilat nga ana e tyre refuzuan të miratonin listën e përditësuar të pronave pyjore dhe kullosore, objekt i procesit të regjistrimit.
• Miratimi i ligjit 57/2020 "Për pyjet", i cili diktoi dhe ristrukturimin e ISHMP-së. Ristrukturimi i ISHMP-se dhe transferimi i rolit të inspektimit në tokat pyjore tek Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit ndikoi në zbatimin e skemës konkurruese të granteve IPARD-like, ku ISHMP ishte pjesë e skemës si organi që verifikon standardet e punimeve ne pyje e kullota. Projekti duhej të ndryshonte qasjen dhe të rifokusonte burimet e tyre në Agjencinë Kombëtare te Pyjeve, gjatë periudhës përmbyllëse te zbatimit.
• Faktorë të tjerë të jashtëm ndikuan në zbatimin e projektit. Një tjetër faktor i jashtëm që ndikoi në zbatimin e projektit, por jo i lidhur me zhvillimet institucionale ishte situata e COVID 19. Ashtu si të gjithë sektorët e tjerë, zbatimi i projekteve në të gjithë vendin u ndikua në një farë mënyre nga kjo pandemi. Trajnimet ballë për ballë/aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve u shtynë për shkak të kufizimeve dhe sfidave të COVID-19 të konsulentëve ndërkombëtarë që udhëtojnë drejt Shqipërisë. Infeksionet e stafit nëpër institucione, mbyllja e disa zyrave vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ndikoi ne pezullimin e punës ne lidhje me verifikimin e produktit te regjistrimit nga ekspertet e këtyre zyrave. për një periudhë relativisht të gjatë.
• Rezultatet dhe outputet e projektit. Projekti pati një ndikim pozitiv në sigurimin e punësimit për komunitetet rurale dhe rrjedhimisht të ardhurat për banorët e zonës të punësuar në aktivitetet e projektit. Shumica e të punësuarve ishin meshkuj, për shkak të sfidave fizike dhe kushteve të punës në pyje. Në përgjithësi, ka një pjesëmarrje të madhe të grave në sektorin e pylltarisë, duke shkuar deri në 50% në përfaqësimin e anëtarëve të bordit të SHPPK/pjesëmarrjen e SHPPK. Të gjithë përfituesit pohuan se ky komponent ka rritur mirëqenien e banorëve, nëpërmjet punësimit të tyre sezonal, ndërsa përfitimet jomonetare lidhen me zbutjen dhe frenimin e erozionit, rehabilitimin dhe pyllëzimin e tokave të degraduara, përmirësimin e pyjeve dhe kullotave dhe rritjen e nivelit te biodiversitetit.
Sipërfaqja e tokës ku janë aplikuar praktikat e menaxhimit të qëndrueshëm nëpërmjet projektit janë 11,153 hektarë nga 9,000 hektarë të planifikuar. Në më shumë se 11000 ha tokë pyjore/kullosore janë realizuar ndërhyrje direkte për të përmirësuar gjendjen mjedisore dhe këto ndërhyrje kryesisht me skemën e granteve konkurruese IPARD-like dhe aktivitetet LEADER. Me investimet e kryera të projektit përllogaritet rreth 800 000 $tCO_2e$ të cilat do të depozitohen deri në vitin 2037, nga sipërfaqet e përmirësuara nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve të projektit. Banoret që jetojnë pranë këtyre zonave do të kenë më shumë mundësi mbrojtjeje nga risqet e katastrofave natyrore siç janë përmbytjet, valët e te nxehtit, thatësira, etj. Gjithashtu, regjistrimi apo hartimi i planeve të menaxhimit do sjellin më shumë të ardhura për bashkitë duke formalizuar procedurat e transaksioneve ekonomike dhe përmirësimin e shërbimeve në komunitet.
• Përfituesit e Projektit. Mbi 3800 fermerë, SHPPK, grupe veprimi dhe individë që përfshijnë 686 fshatra në vend përfituan direkt ose indirekt nga fondet e grantit dhe aktivitete të tjera të Projektit duke përmendur këtu aktivitetet e Planit të Veprimit Gjinor. Popullsia rurale dhe urbane ka përfituar indirekt përmes përmirësimit të disponueshmërisë dhe cilësisë së ujit dhe parandalimit të përmbytjeve raportuar dhe në kërkimin cilësor nga pjesa më e madhe e përfituesve. Rreth 2400 persona të stafit në qeverinë qendrore dhe NJQV-ve, përfshirë specialistë të pylltarisë, mjedisit, social dhe gender, agjentë ekstensioni dhe zyrtarë të tjerë përfituan nga trajnimet dhe aktivitetet e rritjes të kapaciteteve. Një Plan i Veprimit Gjinor (PVGJ) është formuluar dhe zbatuar me qëllim përfaqësimin gjinor në të gjithë komponentët e PSHM-së dhe është zbatuar në dy faza gjatë viteve 2015-2017 dhe 2019-2020.
**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet e dërguara nga ana e MTM në lidhje me Projektin Shërbime Mjedisore. Në lidhje me ndryshimin e komponentëve dhe nënkomponetëve të ndikuara nga faktorë të jashtëm duhet të mbahet dokumentacioni i nevojshëm i cili justifikon këto ndryshime, dokumentacion i cili nuk u gjend në arkivën dhe dokumentacionet dërguar grupit të të auditimit. Në lidhje me rezultatet dhe outputet flitet për statistika dhe pohime të cilat nuk janë të bazuara në fakte dhe dokumentacion konkret, të cilat janë të përfshira në termin e përdorur "indirekt". Gjithashtu në fjalinë "Projekti pati një ndikim pozitiv në sigurimin e punësimit për komunitetet rurale dhe rrjedhimisht të ardhurat për banorët e zonës të punësuar në aktivitetet e projektit", nuk vërtetohet se si u arrit të punësohen këto banorë, pasi e vetmja gjë që lidhet është komponenti në lidhje me grantet pranë AZHBR, ku në dokumentacionin e shoqatave (për të cilët kryesisht kryetarët e shoqatave, banorë të qyteteve dhe jo të zonave rurale), nuk ekziston asnjë dokumentacion në lidhje me personat e angazhuar për zbatimin e këtyre komponentëve. Në lidhje me fjalinë "më shumë se 11000 ha tokë pyjore/kullosore janë realizuar ndërhyrje direkte për

të përmirësuar gjendjen mjedisore dhe këto ndërhyrje kryesisht me skemën e granteve konkurruese IPARD-like dhe aktivitetet LEADER", si mund të arrini në një konkluzion të tillë kur nuk keni kryer asnjë monitorim në terren në lidhje me realizimin e këtij komponenti.
Pas analizimit me kujdes të argumentet të sjella nga personat përgjegjës, të cilat janë të pabazuara në dokumente faktike nuk ndryshojnë gjetjet e konkluduara nga grupi i auditimit.

**Për sa më sipër observacionet nuk merren në konsideratë.**

## 2.2 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit (përfshirë ndryshimet, amendimet e kontratës) dhe
## 2.3 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar, raportimet përkatëse.

Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të Programit të Auditimit nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, *"Mbi marrëveshjet e financimit të projektit (përfshirë ndryshimet, amendimet e kontratës) dhe Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar, raportimet përkatëse"*, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Legjislacioni mbi miratimin e marrëveshjeve financiare:

Vendimi nr. 370, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si agjenci zbatuese e fondit për mjedisin global për projektin e Shërbimeve Mjedisore" në shumën 2,880,000 USD.
Vendimi nr. 369, datë 11.06.2014, "Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin Shërbimet Mjedisore" në shumën 7,300,000 Euro.
Vendimi nr. 10, datë 14.01.2015, "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve Grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën fondin suedez të besimit, për fondin e besimit nr. TF072239, për projektin Shërbimet Mjedisore me Shqipërinë.
Ligji nr. 151/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore", në shumën 7,300,000 Euro.
Ligji nr. 152/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore", në shumën 2,880,000 USD.

Projekti hyri në fuqi më 29 janar 2015 dhe do të përfundonte me 30 Shtator 2019.
Projekti është financuar nga burimet e mëposhtme:

IBRD 84010 AL
Bazuar në marrëveshjen financiare të datës 25 Korrik midis Qeverisë Shqiptare dhe IBRD-së, për kredinë e 7.3 milion Eurove.
Alokimi i shumës do të shpërndahet si më poshtë:

| Kategoria | Shuma e Huas (Euro) | Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat) |
|---|---|---|
| Mallra dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1(a), 2(c) dhe pjesës 4 (a) të Projektit | 4,679,850 | 100% |
| Nënprodukte sipas pjesës 2(b) të Projektit | 2,601,900 | 100% |
| Tarifat fillestare | 18,250 | Shuma që do të paguhet në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme. |
| **SHUMA TOTALE** | **7,300,000** | |

GEF TF 17364 (P128412)
Bazuar në marrëveshjen financiare të Grantit, të datës 25 Korrik 2014, midis Qeverisë Shqiptare dhe GEF, për Grantin në shumën 2,880,000 USD.
Alokimi i shumës do të shpërndahet si më poshtë:

| Kategoria | Shuma e Grantit të alokuar (në dollarë amerikanë) | Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat) |
|---|---|---|
| Shërbime jo konsulentë, trajnime, shërbime konsulentë dhe kosto operative sipas pjesës 1(a), 2(a) dhe pjesës 3 të Projektit | 2,880,000 | 100% |
| **SHUMA TOTALE** | **2,880,000** | |

SIDA TF 018238
Bazuar në marrëveshjen financiare të Grantit të datës 25 Korrik 2015 midis Qeverisë Shqiptare dhe SIDA, për grantin në shumën 7,960,000 USD.
Alokimi i shumës do të shpërndahet si më poshtë:

| Kategoria | Shuma e pjesës së Grantit (USD) | Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat) |
|---|---|---|
| Mallra, punimet dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1/2/a//c dhe pjesës 4 të Projektit | 6,142,470 | 100% |
| Nënprodukte sipas pjesës 2/b të Projektit | 1,817,530 | 100% |
| **SHUMA TOTALE** | **7,960,000** | |

Përgjatë 2016, Granti i SIDA është zvogëluar si pasoje e kursit të këmbimit dhe marrëveshja fillestare e granit është amenduar në 21.12.2016, me anë të Vendimit nr. 905, datë 21.12.2016 "Për miratimin në parim të ndryshimit nr.1 të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim që vepron si administratore e fondeve Grant, të sigluara nga agjencia Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën fondin Suedez të Besimit për fondin e besimit nr. TF072239, Për projektin e Shërbimeve Mjedisore me Shqipërinë.

| Kategoria | Shuma e pjesës së Grantit (Euro) | Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat) |
|---|---|---|
| Mallra, punimet dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1/2/a//c dhe pjesës 4 të Projektit | 5,640,000 | 100% |

| | | |
|---|---|---|
| Nënprodukte sipas pjesës 2/b të Projektit | 1,670,000 | 100% |
| **SHUMA TOTALE** | **7,310,000** | |

Kontributi i Qeverisë Shqiptare është financimi i TVSH së shpenzimeve të projektit.

**Ndarja e financimit dhe realizimit sipas komponentëve të projektit Shërbimet Mjedisore**
Komponentët

**Komponenti 1**: Forcimi i Kapacitetit Institucional për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit *(vlerësuar: 9.8 milionë USD; 9.21 milionë USD aktuale)*.
a) Forcimi i Kapacitetit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave duke përfshirë:
(i) një NFI për zbulimin e ndryshimeve;
(ii) zhvillimi i një NFI dhjetëvjeçare të përhershme;
(iii) planifikimi i menaxhimit të pyjeve në menaxhimin e shtetit pyjet e prodhimit;
(iv) krijimi i Sistemit të Informacionit Pyjor Shqiptar (AlFIS);
(v) mbështetje për Drejtoritë Rajonale Pyjore të sapokrijuara (RFD); dhe
(vi) regjistrimin e tokave pyjore dhe kullosore transferohen nga shteti në NJQV. b)
b) Fuqizimi i Përfituesve duke përfshirë mbështetjen për:
(i) përpjekjet dhe integrimin e synuar gjinor;
(ii) krijimi i Grupeve Lokale të Veprimit LEADER9 (GLV) dhe strategjive zhvillimore në përputhje me BE-n kërkesat dhe grantet pilot;
(iii) forcimi i kapaciteteve të NJQV-ve dhe NJQV-ve; dhe
(iv) zinxhiri i vlerës analizat dhe planet e përpunimit dhe marketingut të produkteve pyjore.

**Komponenti 2**: Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve të ngjashme me IPARD-in për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës *(vlerësuar: 10.44 milionë USD; aktuale: 10.00 milionë USD)*.
a) Përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave (FPMP) duke përfshirë udhëzimet e planifikimit;
b) Sigurimi i granteve pyjore të ngjashme me IPARD-in nëpërmjet një mekanizmi konkurrues të përafruar me kërkesat e BE-së IPARD:
(i) për individët/ përfituesit privatë; dhe
(ii) për grupet/shoqatat (FPUA, OJQ).
c) Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë së Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë (AZHBR, Agjencia e Pagesave), organeve teknike (MM, inspektorët shtetërorë) dhe aplikantëve për administrimin, zbatimin dhe menaxhimin e granteve.

**Komponenti 3:** Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore (PES) *(vlerësuar: 1,36 USD totale milion; totali aktual 0.62 milion USD)*.
a) Zhvillimi i projekteve të karbonit duke përfshirë studime/vlerësime për pjesëmarrje në tregjet e karbonit.
b) Zhvillimi i mekanizmit të pagesave për shërbimet e pellgut ujëmbledhës duke përfshirë një plan të përshtatshëm pagese dhe marrëveshje për të ndihmuar fermerët në kalimin në praktikat e pranueshme të SLM.
c) Pilotimi i pagesave për shërbimet e pellgut ujëmbledhës në zonat përreth rezervuarëve të Bovillës dhe Ulzës.

**Komponenti 4:** Mbështetja e Zbatimit të Projektit *(gjithsej i vlerësuar 1.24 milion USD; totali aktual 1.03 milion USD)*. Ky komponent mbështeti një ekip të menaxhimit të projektit (PMT) brenda MM për të menaxhuar dhe koordinuar zbatimin e projektit. AZHBR gjithashtu mori mbështetje për të menaxhuar IPARD si grantet pyjore

**Projekti iu nënshtrua dy Ristrukturimeve**
**Ristrukturimi i parë** *(30 shtator 2019)* përfshinte:

(i) rishikimet e treguesit dhe objektivave të PDO dhe prezantimin e treguesve të rinj të ndërmjetëm;
(ii) rialokimin e të ardhurave nga kredia; dhe
(iii) zgjatja e datës së mbylljes nga 30 shtatori 2019 deri më 30 shtator 2020 për të siguruar kohë të mjaftueshme për përfundimin e aktiviteteve sipas Financimit Shtesë (AF).

Ristrukturimi i parë vjen si kërkesë e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit për shtyrjen e afatit të parë për përfundimin e projektit Shërbimet Mjedisore.

**Ndryshimet e pësuara sipas komponentëve dhe marrëveshjeve financiare:**
Marrëveshja e huasë TF018238

| **Kategoria** | **Shuma e grantit (Euro)** | **Shuma e ndryshuar e grantit** |
|---|---|---|
| Mallra, punimet dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1/2/a//c dhe pjesës 4 të Projektit | 5,640,000 | 5,002,440 |
| Nënprodukte sipas pjesës 2/b të Projektit | 1,670,000 | 2,307,560 |
| **SHUMA TOTALE** | **7,310,000** | **7,310,000** |

Marrëveshja e grantit IBRD 8401

| **Kategoria** | **Shuma e Huas (Euro)** | **Shuma e ndryshuar e Grantit (EURO)** |
|---|---|---|
| Mallra dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1(a), 2(c) dhe pjesës 4 (a) të Projektit | 4,679,850 | 5,239,473 |
| Nënprodukte sipas pjesës 2(b) të Projektit | 2,601,900 | 2,042,277 |
| Tarifat fillestare | 18,250 | 18,250 |
| **SHUMA TOTALE** | **7,300,000** | 7,300,000 |

**Ristrukturimi i dytë** *(15 gusht 2020)* përfshinte:

(i) një zgjatje tetë-mujore të datës fillestare të mbylljes së 30 shtatorit 2020 deri më 31 maj 2021 për të siguruar përfundimin e aktiviteteve të projektit;
(ii) ndryshimet në objektivat në Kornizën e Rezultateve (RF); dhe
(iii) rritje prej 0.56 milion USD sipas Grantit të Qeverisë Suedeze. 11,12

Granti i AF prej 2.00 milion USD nga Qeveria Suedeze u miratua nga Banka më 28 maj 2019 (por hyri në fuqi më 15 tetor 2020) për:

(i) për të rritur planifikimin e menaxhimit të pyjeve sipas Komponentit 2; dhe
(ii) (ii) të mbështesë grante shtesë pyjore të ngjashme me IPARD-in sipas Komponentit 2.

Ndryshimet kryesore në RF sipas ristrukturimit të parë dhe të dytë janë dhënë në Tabelën 1 më poshtë.

| | Treguesit e PDO sipas Objektivave/Rezultateve | Bërthamë | Synimi (PAD) | Objektivi (1Ristrukturimi 2019) | Objektivi (2 Ristrukturimi 2020 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Për të mbështetur praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të tokës në zonat e synuara të projektit** | | | | | |
| | Sipërfaqja e tokës ku mgt tokë e qëndrueshme. praktikat janë adoptuar si rezultat i projektit (Ha, Korporata) | x | 7500 | 7500 | 9000 |
| **Për të mbështetur praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të tokës në zonat e synuara të projektit** | | | | | |
| | Njerëzit në pyll dhe komunitetin ngjitur me përfitim monetar/jomonetar nga pylli (Numër, me porosi) | x | 2000 | 2000 | 3000 |
| | Njerëzit në pyll dhe komunitetet ngjitur me përfitime nga pylli-femra (Numër, Custom Thyej) | x | 1000 | 1000 | 1000 |
| | Njerëzit në pyll dhe në komunitetet fqinje me përfitim nga pakica etnike pyjore/indigjene (Numri, Përbërja e personalizuar) | x | 10 | 10 | 10 |
| | Njerëzit në komunat e synuara me përfitime të shtuara monetare ose jomonetare nga tokat bujqësore | | 1000 | I rënë | N/A |
| | Femrat në komunat e synuara me përfitime të shtuara monetare dhe jomonetare nga tokat bujqësore | | 500 | I rënë | N/A |
| | Treguesit e rezultateve të ndërmjetme sipas komponentëve | | | | |
| **Komponenti 1. Forcimi i kapaciteteve institucionale për të përmirësuar shërbimet mjedisore nga menaxhimi i integruar i peizazhit** | | | | | |
| | Zona pyjore dhe kullosore të regjistruara (Ha, Me porosi) | | jo ne PAD | 870,000 | 1,100,000 |
| | specialistë dhe përdorues të menaxhimit të tokës të trajnuar (Numër, me porosi) | | 20000 | 2000 | 2000 |
| | femra specialiste të menaxhimit të tokës dhe përdorues të trajnuar (Numri, Zbërthimi i personalizuar) | | 8000 | 800 | 800 |
| | Anëtarë të Shoqatave të Përdoruesve të Kullotave të Pyjeve të trajnuar (Numri, Zbërthimi i personalizuar) | | 2000 | 2000 | 2000 |
| | Anëtare femra të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave' Shoqatat e trajnuara (Numri, Custom Thyej) | | jo ne PAD | 800 | 800 |
| | fermerë individualë të trajnuar (Numër, Custom Thyej) | | 1000 | 1000 | 300 |
| | fermerë femra të trajnuara (Numër, Me porosi Thyej) | | jo ne PAD | 500 | 165 |
| | stafi i ministrisë i trajnuar (Numri, Dogana Thyej) | | 700 | 700 | 700 |
| | Përfitues pjesëmarrës në projekt aktivitetet e konsultimit gjatë zbatimit (Numër, me porosi) | | jo ne PAD | 2000 | 350 |
| | Përfituese femra që marrin pjesë në projekt aktivitetet e konsultimit gjatë zbatimit (Numri, Zbërthimi i personalizuar) | | jo ne PAD | 500 | 100 |
| **Komponenti 2. Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve IPARD si për përmirësimin e menaxhimit të tokës** | | | | | |
| | % e aplikimeve për grante plotësojnë kërkesat (Përqindje, me porosi) | | 60 | 60 | 60 |
| | % e buxhetit të grantit të disbursuar (përqindje, Me porosi | | 100 | 100 | 100 |
| | % e buxhetit të granteve të shpërndara për femra aplikantët (Përqindja, Përbërja e personalizuar) | | 15 | 15 | 15 |
| | % e buxhetit të granteve të disbursuara për fermerët (Përqindje, ndarje e personalizuar) | | 50 | 50 | 10 |
| | % e granteve të disbursuara për Pyjet dhe Kullotat Shoqatat e përdoruesve (përqindje, me porosi Thyej) | | 50 | 50 | 82 |
| | Zona e kullotave e futur në plane menaxhimi (Hektar (Ha), Me porosi) | | 70000 | 90000 | 90000 |
| | Sipërfaqja pyjore e futur në plane menaxhuese (Hektar (Ha), Korporata) | | 114000 | 180000 | 180000 |
| | % e shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave duke raportuar se planet e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave përfaqësonin pikëpamjet e komunitetit (përqindje, zakon) | | jo ne PAD | 80 | 80 |
| **Komponenti 3. Pagesat për Shërbimet Mjedisore** | | | | | |
| | Përqindja e shpërndarjes së vlerësuar të sedimentit në rezervuarë në zonat pilot të mbuluara nga PES (Përqindje, me porosi) | | jo ne PAD | 10 | 10 |
| | Numri i kontratave për shërbime mjedisore ofrohet si pjesë e pilotimit të Pagesës për Shërbimet Mjedisore (PES). | | 10 | ka rënë | N/A |

| | Shuma origjinale (US$) | Shuma e rishikuar (US$) | Disbursimi aktual (US$ |
|---|---|---|---|
| **P130492 IBRD-84010** | 10,000,000 | 10,000,000 | 8,339,045 |
| **P130492 TF-18238** | 7,960,000 | 7,870,000 | 7,686,889 |
| **P130492 TF-B2002** | 2 000 000 | 2 000 000 | 1,973,146 |
| **P128412 TF-17364** | 2 880 000 | 2 880 00 | 2,863,726 |
| | **22,840,000** | **22,750,000** | **20,862,806** |

| KOSTOJA E PROJEKTIT SIPAS KOMPONENTIT | | | |
|---|---|---|---|
| Komponentët | Shuma në miratim Projekt (US$M) | Aktuale në Mbyllja (US$M) | Përqindja e miratimit (Përqindja) |
| Komponenti 1. Forcimi i kapaciteteve institucionale për përmirësimin e shërbimeve mjedisore nga menaxhimi i integruar i peizazhit | 9.80 | 9.21 | 93.9 |
| Komponenti 2. Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës. | 10.44 | 10.00 | 95.7 |
| Komponenti 3. Prezantimi i Pagesave për shërbimet mjedisore | 1.36 | 0.62 | 45.6 |
| Komponenti 4. Mbështetja e zbatimit të projektit | 1.24 | 1.03 | 82.3 |
| **Totali** | **22.84** | **20.86** | **91.3** |

Nga sa më sipër grupi i auditimit konstatoi:

- Projekti i është nënshtruar dy ristrukturimeve të cilat sipas Raportit Final të hartuar nga Banka Botërore kanë lindur si kërkesë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dokumentacion që nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, për të analizuar shkaqet dhe arsyet mbi ristrukturimin e tyre.
- Shuma në miratim përfshin 2 milion USD Financim Shtesë nga Qeveria Suedeze e cila i është ndarë Komponentit 2. Kjo është përfshirë në shumën e miratuar sipas Komponentit 2.
- Rreth 650,000 USD u tërhoqën nga SIDA. Megjithatë, drejt fundit të projektit në 2021 rreth 560,000 USD u vunë sërish në dispozicion (TF -18238).
- Rreth 69,000 euro janë kthyer në përfundim të projektit.

| Nr. | Data e disbursimit | Disbursimi (US$M) |
|---|---|---|
| **1** | 06-dhjetor-2014 | 0 |
| **2** | 16-qershor-2015 | .46 |
| **3** | 21-dhjetor-2015 | .90 |
| **4** | 10-Mars-2016 | .90 |
| **5** | 17-gusht-2016 | 2.45 |
| **6** | 14-Jan-2017 | 2.45 |
| **7** | 27-maj-2017 | 2.45 |
| **8** | 25-Jan-2018 | 2.83 |
| **9** | 25-qershor-2018 | 4.19 |
| **10** | 09-Janar-2019 | 6.82 |
| **11** | 30-Korrik-2019 | 7.89 |
| **12** | 24-dhjetor-2019 | 8.92 |
| **13** | 19-qershor-2020 | 12.17 |
| **14** | 15-dhjetor-2020 | 12.73 |
| **15** | 28-maj-2021 | 15.17 |
| **16** | Fund të projektit | 20.78 |
| | Total | |

- Nga tabela e disbursimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit, për disbursimet deri në 28 Maj 2021, vihet re që deri në përfundimin e afatit të parë të përfundimit të projektit shërbimet mjedisore, nuk është disbursuar as gjysma e totalit të financimit të projektit, që do të thotë një nga shkaqet kryesore të ristrukturimeve është mospërdorimi në kohë i burimeve të financimit dhe devijimi nga plani fillestar i realizimit të projektit.
- Gjithashtu nga ristrukturimi i projektit janë rritur dhe kostot operacionale, duke bërë të mundur alokimin e kostove të planifikuara për zhvillimin e komponentëve të projektit për kostot

operacionale të burimeve njerëzore si dhe të shtyrjeve të afateve të realizimit të kontratave të tjera të konsulencës.

- Gjatë viteve 2020 dhe 2021 janë disbursuar 11.86 Milion USD fonde, të cilat përbëjnë 57% të të gjithë fondeve të vënë në dispozicion për 4 vite (2015-2019).

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ish Sekretarët e Përgjithshëm z. A. B., z. P. N. , z. A. K., Ekipi i Menaxhimit të Projektit z. E. I. , znj. B. B., znj. K. Z., znj. H. F., znj. D. Q., z. E. N., znj. V. S. , znj. M. S. . Komiteti Drejtues i Projektit, Drejtuesit e Projektit dhe Komiteti Teknik i Projektit, në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin Shërbimet Mjedisore.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar në institucion me nr. 346/9, datë 01.11.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:*
**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur)**:......... Projekti ka pasur në fokus adresimin e një numri çështjesh në sektorin e pyjeve dhe orientimin drejt financimeve me grante nga BE dhe donatorë të tjerë. Aktivitetet kyç të projektit që kanë qënë të parashikuara që në dokumentin fillestar të projektit (ai i datës 7.11.2013) janë përfshirë më tej në dokumentin bazë të projektit (PAD) dhe nuk ka pasur devijim nga plani fillestar.
• Aktivitete kyç për projektin janë konsideruar: -Ngritja e kapaciteteve të agjencive zbatuese kombëtare për zbatimin e Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave (IKPK) me teknika moderne. Për këtë erdhi në ndihmë projekti i Shërbimeve Mjedisore me anë të konsulencës Suedeze SLU/SFA. Stafi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve sot është i aftë të menaxhojë dhe zbatojë ciklin e ri të IKPK në Shqipëri. -Projektimi dhe krijimi i një Sistemi Kombëtar të Informacionit të Pyjeve në Shqipëri. Krijimi i AlFIS, do të unifikonte standartet kombëtare të ruajtjes së informacionit të fondit pyjor/kullosor dhe për herë të parë në sektorin e pyjeve kemi një sistem të unifikuar kombëtar informacioni gjë që lehtëson menaxhimin, përditësimin dhe monitorim efektiv të fondit pyjor/kullosor kombëtar. Platforma e AlFIS realizoi: (i) grumbullimin, harmonizimin , standardizimin dhe vënien në dispozicion të informacionit për pyjet dhe kullotat publike në Shqipëri; (ii) monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ne pyje/kullota pavarësisht burimit të financimit, organizatës zbatuese dhe vendndodhjes, (iii) informacion të saktë, të përditësuar dhe të bazuar në standarde të përcaktuara për të gjithë punonjësit, (iv) mjetet e nevojshme për menaxhimin e informacionit në të gjitha fazat e mbledhjes, menaxhimit dhe dorëzimit. Sistemi është populluar me informacion hartografik, digjital gjatë kohës së zbatimit të projektit në nivel njësie qeverisjeje vendore dhe të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura. -Ofrimi i granteve IPARD-like për Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe fermerët në pyje. -Hartimi i planeve të menaxhimit për disa bashki duke përfshirë në proces edhe mendimin e komunitetit nëpërmjet pjesëmarrjes në konsultime për të reflektuar mendimet e tyre në menaxhimin e drejtë të sipërfaqeve pyjore. -Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave: Projekti mbështeti regjistrimin fillestar të pasurive të tipit pyje dhe kullota për rreth 1 Milion e 100 mijë hektarë në gjithë territorin e vendit. Regjistrimi i këtyre pronave lehtëson transaksionet që do të kryejnë bashkitë me sipërfaqet pyjore e kullosore tashmë të regjistruara në pronësi të tyre. Kjo do të sjellë si rrjedhojë më shumë të ardhura për buxhetet e bashkive dhe një monitorim më të mirë të pasurive. -Aplikimi i mekanizmit për Pagesat e Shërbimeve ne Ekosistem nuk u arrit të pilotohet sepse UKT nuk mund të angazhohej pas përfundimit të projektit për arsye të kufizimeve ligjore në kryerjen e pagesave të tilla, ndërsa KURUM, kompania që administronte hidrocentralin e Ulzës nuk mendonte se duhet të angazhohej.
Rritja e kostove operacionale ka qënë e pashmangshme në rrethanat e reja që krijoheshin duke nisur që nga reformat institucionale (përmendim këtu reformën administrativo-territoriale me ligjin 115/2014 “Për ndarjen territoriale dhe administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji “Për vetëqeverisjen vendore”, Nr.139/2015). Fokusi i projektit për mbështetje dhe rritje kapacitetesh u zhvendos me shume drejt njësive të qeverisjes vendore (61) kundrejt 12 Drejtorive Rajonale te Shërbimit Pyjor te cilat para reformës ishin përgjegjëse për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore e kullosore në rajon. Kjo solli edhe rritjen e shpenzimeve operacionale në mbështetje të aktiviteteve kryesore të projektit për arritjen e objektivave te tij. Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve gjithashtu kërkonte mbështetjen e projektit me rritje kapacitetesh dhe logjistike, gjë e cila kishte impakt në rritjen e kostove operacionale gjithashtu. Efekti u pasua edhe në vonesa në zbatimin e disa kontratave apo edhe nevojës për shtyrjen e tyre në kohë kryesisht.
Sa i përket shumave të likuiduara më së shumti në vitet e fundit të projektit: kjo shpjegohet me produktin përfundimtar apo punimet të realizuara për komponentët kryesorë të projektit që përbënin edhe volumin kryesor, si: regjistrimi i pyjeve dhe kullotave, hartimi i planeve të menaxhimit, zbatimi i thirrjes II të skemës së granteve IPARD-like, zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Informacionit për Pyjet, etj.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet e dërguara nga ana e MTM në lidhje me rritjen e kostove dhe disbursimet. Pas analizimit me kujdes të argumentimeve, vihet re që konstatimet e grupit të auditimit qëndrojnë por duke sjellë justifikimin e tyre si dhe përdorur ndryshimet legjislative të viteve 2014 dhe 2015, ndërkohë që flitet për vitin 2020 që sjell në një menaxhim jo të duhur të realizimit të projektit.

**Për sa më sipër observacionet nuk merren në konsideratë.**

## 2.4 Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, i ndryshuar *"Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës"*, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Dokumentacioni i vendosur në dispozicion:
1. Ligji nr. 151/2014, ligji nr.152/2014 dhe ligji nr. 64/2015
2. Projekti i Shërbimeve Mjedisore
3. Manuali Operacional i Projektit

Projekti Shërbimet Mjedisore është financuar në bazë të tre marrëveshjeve financiare si mëposhtë:
- Ligji nr. 151/2014 "Marrëveshje Huaje nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)"
- Ligji nr. 152/2014 "Granti nga Fondi Global i Mjedisit"
- Ligj nr. 64/2015 "Granti nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Sida)"

Të gjitha prokurimet e këtij projekti do të kryhen në përputhje me Seksioni III "Prokurimi", të ligjit nr. 151/2014 dhe ligjit nr. 152/2014 dhe udhëzimeve të Bankës Botërore:
- Udhëzimet e Bankës Botërore : "Prokurimi i mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jo-Konsulencë në Huatë e IBRD dhe Kreditë & Grantet e IDAs nga Huamarrësit e Bankës Botërore"
- Udhëzimet: "Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën Huatë e IBRD dhe Kreditë & Grantet e IDAs nga Huamarrësit e Bankës Botërore".

Të gjitha prokurimet në këtë projekt janë trajtuar nga Drejtoria e Projektit në Ministrinë e Mjedisit, përfshirë edhe prokurimet që lidhen me nën komponentin i cili është zbatuar nga AZHBR. Ministria e Mjedisit është agjencia kryesore zbatuese dhe përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të këtij projekti, e cila ka caktuar Drejtorinë e Projektit, roli i të cilit është të mbikëqyrë zbatimin e përgjithshëm të Projektit.
Gjithashtu për zhvillimin e prokurimeve është caktuar edhe specialisti i prokurimeve pranë grupit të menaxhimit të projektit, znj. B. B. me anë të kontratës nr. 10652 prot., datë 05.11.2014.

Funksionet kryesore të Specialistit të Prokurimit përfshijnë:

- *Prokurojnë mallra, punime dhe shërbime të kryera në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve të Bankës Botërore dhe Manualit të Operacioneve të Projekteve;*
- *Koordinohet me stafin e PMT-së dhe IA-ve në mënyrë që specifikimet teknike dhe Kushtet e Referencës të përgatiten për aktivitetet e planifikuara;*

- *Koordinohuni me Ekipin e Prokurimit të MOE-së dhe IA-ve në mënyrë që dokumentet të nënshkruhen në kohën e duhur në përputhje me procedurat e dakordësuara;*
- *Të marrë pjesë në përgatitjen dhe përditësimin periodik të Planeve të Prokurimit të Projektit të Shërbimeve Mjedisore , të kryejë verifikimin e Planit të Prokurimit dhe azhornimin e tij;*
- *Kryeni prokurimet sipas Planeve të Prokurimit të Projektit Shërbimet Mjedisore ;*
- *Mbajtja e sistemit të prokurimit raportues në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;*
- *Mbështesni Koordinatorin e Projektit në përgjegjësinë e tij për të monitoruar ekzekutimet e kontratave.*

Në përgjithësi, detyrat specifike që do të ndërmerren nga specialistja e prokurimeve duhet të mbulojnë ciklin e plotë të prokurimit të zbatueshëm për metodat e prokurimit të specifikuara në Planin e Prokurimit. Kjo do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në ndihmën praktike në:

- *përgatitjen dhe publikimin e njoftimeve të prokurimit sipas metodave të ndryshme të prokurimit;*
- *pjesëmarrjen në Komitetin e Vlerësimit në termat e përshkruara në Dispozitat për Komitetin e Vlerësimit;*
- *përgatitjen e dokumenteve të ofertave, kërkesën për propozime dhe dokumente të tjera bazuar në formularët e miratuara për projektin; dhe në bazë të informacionit teknik të dhënë nga stafi teknik;*
- *kryerjen e procesit të ofertave dhe të përzgjedhjes, duke përfshirë mbledhjet e para-ofertës ose para-propozimit, sqarimet, hapjen e ofertave dhe etj.;*
- *mbështetje administrative dhe procedurale në vlerësimin teknik dhe tregtar të ofertave dhe përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Ofertave në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;*
- *mbështetjen administrative dhe procedurale në vlerësimin e propozimeve teknike dhe financiare të konsulentëve dhe përgatitjen e raporteve teknike dhe përfundimtare të vlerësimit në përputhje me dispozitat e Manualit Operacional të Projektit;*
- *përgatitjen e kontratave në përputhje të plotë me formularët e miratuar për projektin;*
- *negociatat e kontratave dhe nënshkrimin;*
- *administrimin e përgjithshëm të kontratave;*
- *verifikimin e dokumenteve të pagesës sipas kontratave për furnizimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve;*
- *procedurat e mbylljes së kontratës dhe raportimin përfundimtar;*

*******

Gjatë përgatitjes së projektit kjo drejtori duhej të përgatiste një plan prokurimesh për 18 muajt e parë të realizimit të projektit (vënë në dispozicion elektronikisht) dhe më pas duhej të vazhdonte me përgatitjen e planeve të prokurimit për çdo vit të projektit, për të cilën grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion, duke vështirësuar dhe punën audituese në lidhje me verifikimin e kostove dhe të arritjes së objektivave të projektit.
Sa më sipër në mospërputhje me gërmën C të pjesës së dytë të ligjit nr. 151/2014 dhe ligjit nr. 152/2014,

*PJESA 2 EKZEKUTIMI I PROJEKTIT SEKSIONI I. MASAT INSTITUCIONALE DHE ZBATIMI Gërma C. Plani dhe Buxheti Vjetor i Punës 1. Përfituesi përgatit dhe i jep Bankës jo më vonë se data 1 dhjetor e çdo viti fiskal gjatë zbatimit të Projektit një plan pune dhe një buxhet që përmban të gjitha aktivitetet e propozuara për t'u përfshirë në Projekt gjatë vitit fiskal pasardhës dhe një projekt-plan financiar për shpenzimet e kërkuara për këto aktivitete, duke parashikuar shumat e propozuara dhe burimet e financimit.*

Llojet e procedurave të prokurimit për këtë projekt janë :

1.Mallra dhe shërbime jo-konsultuese
Mallrat e prokuruara sipas PSHM do të grupohen, në masën e mundshme, për të inkurajuar ofertat konkurruese. Në varësi të vlerës së vlerësuar të kontratës, prokurimi i mallrave dhe pajisjeve do të kryhet nëpërmjet metodave të mëposhtme:
- Ofertat konkurruese ndërkombëtare
- Oferta kombëtare konkurruese

- Blerje të vogla
- Kontraktimi direkt

Tabela më poshtë jep pragun, sipas metodave të prokurimit, për shqyrtimin e kontratave nga Banka.

| | **Metoda e prokurimit** | **Pragu i metodës së prokurimit** | **Pragu i shqyrtimit paraprak** |
|---|---|---|---|
| 1 | Ofertat konkurruese ndërkombëtare | "> €375,000 – mallra" ">€1,500,000 – punime" | Të gjitha |
| 2 | Oferta kombëtare konkurruese | "= ose < €375,000 – mallra" "= ose <€1,500,000 – punime" | " & >Euro 150,000 – mallra & >Euro 750,000 – punime" |
| 3 | Blerje të vogla | < €75,000 | First 2 |
| 4 | Kontraktimi direkt | Asnjë | Të gjitha |

2.Punët civile
Punimet civile që do të financohen sipas PSHM janë përcaktuar në planin e prokurimit të projektit. Në varësi të vlerës së vlerësuar të kontratës, prokurimi do të kryhet nëpërmjet metodave të mëposhtme:
- Ofertat konkurruese ndërkombëtare
- Oferta kombëtare konkurruese
- Blerje të vogla
- Kontraktimi direkt

3.Shërbimet e konsulencës
Procedurat e mëposhtme të përzgjedhjes do të përdoren për përzgjedhjen e konsulentëve:
- Përzgjedhja e cilësisë dhe kostos;
- Përzgjedhja e bazuar në cilësi;
- Përzgjedhja më pak e kostos;
- Përzgjedhja e buxhetit fiks;
- Përzgjedhja bazuar në kualifikimin e konsulentit;
- Përzgjedhja individuale e konsulentëve;
- Përzgjedhja me burim të vetëm.

Tabela : Shqyrtim paraprak për zgjedhjen e konsulentëve.

| | **Metoda e përzgjedhjes** | **Pragu i shqyrtimit paraprak** |
|---|---|---|
| 1 | Kontrata me firmat | > €75,000 dhe të gjitha kontratat me përzgjedhje me burim të vetëm |
| 2 | Kontrata me konsulentë Individë | > €40,000 dhe të gjitha kontratat me përzgjedhje me burim të vetëm |

Për këtë projekt janë zhvilluar gjithsej 63 procedura të ndara sipas nënkategorive përkatëse.
Nga këto procedura 18 janë për Prokurim të mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jo-Konsulencë, 45 janë për shërbime konsulence, përzgjedhje dhe punësimi i Konsulentëve.

***Përshkrimi i një procedure për Prokurim mallrash***
Specialistja e prokurimit të projektit dërgon email tek Banka Botërore në lidhje me termat dhe kërkesat që ka hartuar për procedurën e prokurimit që të marrë No Objection nga Banka Botërore.

Pas marrjes së No Objection nga Banka Botërore bëhet publikimi i procedurës në ueb dhe gazetat lokale.
Operatorët Ekonomikë pasi njihen me njoftimin e prokurimit dërgojnë email specialistes së prokurimit dhe menaxherit të projektit për tu pajisur me dokumentacionin për aplikim në procedurë.
Specialistja e prokurimit dërgon formularët dhe dokumentet standarde të tenderit drejt O.E. që kanë shprehur interes.
Ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave nga Ministria e Mjedisit.
Bëhet verifikimi i dokumenteve dhe vlerësimi i ofertave.
Kriter është përzgjedhje e ofertës më të ulët ekonomike.
Pas përcaktimit të fituesit bëhet nënshkrimi i kontratës.
Ngrihet grupi që do të marrë në dorëzim produktin nga Ministria.
Bëhet dorëzimi i produktit dhe mbahet proces verbal.

Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Ligjshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Huaja e miratuar me ligjin nr. 151/2014 (Kategori), ndarjen e shumave të Huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Ligjshme në secilën Kategori

| **Kategoria** | **Shuma e Huas (Euro)** | **Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)** |
|---|---|---|
| Mallra dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1(a), 2(c) dhe pjesës 4 (a) të Projektit | 4,679,850 | 100% |
| Nënprodukte sipas pjesës 2(b) të Projektit | 2,601,900 | 100% |
| Tarifat fillestare | 18,250 | Shuma që do të paguhet në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme. |
| **SHUMA TOTALE** | **7,300,000** | |

Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Granti e miratuar me ligjin nr.152/2014 (Kategori), ndarjen e shumave të Grantit për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Pranueshme në secilën Kategori:

| **Kategoria** | **Shuma e Grantit të alokuar (në dollarë amerikanë)** | **Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)** |
|---|---|---|
| Shërbime jo konsulentë, trajnime, shërbime konsulente dhe kosto operative sipas pjesës 1(a), 2(a) dhe pjesës 3 të Projektit | 2,880,000 | 100% |
| **SHUMA TOTALE** | **2,880,000** | |

Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Granti (Kategori), ndarjen e shumave të Grantit për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Pranueshme në secilën Kategori:

| **Kategoria** | **Shuma e pjesës së Grantit (Euro)** | **Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)** |
|---|---|---|
| Mallra, punimet dhe shërbime jo konsulentë pjesës 1/2/a//c dhe pjesës 4 të Projektit | 6,142,470 | 100% |
| Nënprodukte sipas pjesës 2/b të Projektit | 1,817,530 | 100% |

| SHUMA TOTALE | 7,960,000 | |
|---|---|---|

Sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi:

- Në lidhje me kontratën midis Ministrisë së Mjedisit dhe znj. B. B. si specialiste prokurimesh për projektin dhe si person përgjegjës për realizimin e tyre, nuk jepen shpjegimet përkatëse në lidhje me ndryshimet e kushteve të kontratës, kryesisht nga kalimi me kohë të plotë në punësim me kohë të pjesshme. Përpos këtij ndryshimi vlera e pagesave ka ndryshuar, pasi në këtë rast pagesat do të jenë 180euro/ditë pune. Gjithashtu në amendimet e kontratave datat e cituara nuk janë në përputhje me kontratën kryesore dhe me amendimet e tjera. Kalimi i kontratës me kohë të pjesshme bie ndesh dhe me përcaktimet ligjore në fillim të projektit pasi rëndësia e pjesëmarrjes në Grupin e Menaxhimit të Projektit është e lartë.
- Planet e prokurimeve dhe planet e punës nuk i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit. Grupi i auditimit ka në dispozicion planin fillestar të prokurimeve (në formatin elektronik).
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit nuk është kryer sipas planit fillestar të prokurimeve, si dhe për ndryshimet e pësuara më pas nuk ka asnjë dokumentacion në lidhje me arsyetimet përkatëse, duke u bërë dhe faktor kryesor në zgjatjen e realizimit të projektit, mbi të cilin ka pasoja të tjera të sqaruara në akt konstatimet e tjera.
- Në hartimin e kontratave, gjuha e përdorur është anglishtja, nuk përmban të dhënat elementare mbi palët e përfshira në kontratë, si ID, NIPT etj.. duke vështirësuar gjurmën e auditimit të tyre.
- Dorëzimi i dosjeve të procedurave të prokurimit, është kryer pa një numër inventarizimi, pa një kronologji dokumentacioni duke u bërë pengesë mbi zhvillimin e punës audituese.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, z. A. B., z. A. K., Ekipi i Menaxhimit të Projektit z. E. I. , znj. B. B., Komiteti Drejtues i Projektit, Drejtuesit e Projektit dhe Komiteti Teknik i Projektit, në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin Shërbimet Mjedisore.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar në institucion me nr. 346/9, datë 01.11.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:*

**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur)**:...... Në lidhje me planin e prokurimit të Projektit te Shërbimeve Mjedisore, konstatohet se plani fillestar ka qënë për 18 muaj. Gjatë zbatimit të projektit plani i prokurimit është rishikuar periodikisht, gjatë çdo misioni të Bankës Botërore. Gjatë misioneve të Bankës Botërore, plani i prokurimit diskutohej gjerësisht me institucionet përfituese, duke u dakortësuar aktivitetet në vijim dhe kostot e tyre të parashikuara.

**Bank's Approval Date of the Procurement Plan:**

| | |
|---|---|
| Original: | 29-Apr-14 |
| Update 1: | 19-Feb-15 |
| Update 2: | 11-Nov-15 |
| Update 3: | 30-Mar-16 |
| Update 4: | 19-Nov-16 |
| Update 5: | 15-Jun-17 |
| Update 6: | 31-Dec-17 |
| Update 7: | 22-Jun-18 |
| Update 8: | 30-Aug-20 |

- Gjuha e përdorur për hartimin e kontratave ka qënë anglishtja, në përputhje me marrëveshjen e ligjore ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Bankës Botërore për projektin e shërbimeve mjedisore.
- Kontratat e përdoruara janë kontrata standarde të Bankës Botërore për shërbime konsulence apo mallra sipas rastit të kategorisë së prokurimit, në përputhje me Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore dhe Dokumenteve Sandarde të Tenderit të publikuara në faqen e Bankës Botërore.

-Dorëzimi i dosjeve të prokurimit është bërë me inventarizim si të gjitha dosjet e tjera të projektit të shërbimeve mjedisore me përfundimin e afatit të mbylljes së projektit.
**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit analizoi me kujdes observacionin e sjellë nga personat përgjegjës, ku mbi të cilin konkludoi që puna audituese në terren zhvillohet mbi dokumentacionin e kërkuar dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit. Grupit të auditimi iu desh që të kryente inventarizim të dokumentacionit të marrë nga arkiv protokolli, pasi dokumentacione me data të njëjta ishin në dosje të ndryshme. Gjithashtu çdo dosje nuk kishte asnjë përmbledhje të dokumentacionit të shoqëruara me numër në lidhje me atë çfarë përmban brenda saj. Dosjet e prokurimit nuk kishin të ndjekur një hierarki veprimesh që nga data fillestare dhe deri në lidhje të kontratës. Gjithashtu nga grupi i auditimit është kërkuar në mënyrë të njëpasnjëshme të vihet në dispozicion dokumentacioni i nevojshëm ose ai që mendohej të ishte i nevojshëm nga ana e personave përgjegjës, gjë e cila u morr seriozisht vetëm pas dërgimit të akt konstatimeve, duke dërguar dokumentacion shtesë justifikues.
Në lidhje me gjuhën e përdorur sipas "marrëveshjeve ligjore" të qeverisë shqiptare dhe Bankës Botërore, ju bëjmë me dije se gjuha zyrtare e përdorur në Republikën e Shqipërisë është shqipja dhe pastaj sipas rëndësisë të palëve në marrëveshje do jetë një gjuhë e rënë dakord sipas tyre.

**Për sa më sipër observacionet nuk merren në konsideratë.**

### 2.5 Mbi zbatimin e kontratave për punime civile dhe 2.6 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, *"Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe shërbime"* dhe pikës 6 "*Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit"* u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Në përmbushje të qëllimit dhe objektivave të projektit "Shërbimet Mjedisore", janë realizuar dhe procedura prokurimi të cilat janë të ndara në dy kategori "Shërbime konsulence" dhe "Mallra dhe shërbime". Nisur nga projekt dokumenti mbi Shërbimet Mjedisore (P130492) i datës 07.11.2013, drejtuar Ministrisë së Turizmit, pika financimet e projektit, mbi të cilat janë përcaktuar dhe vlerat përkatëse si:
Kostoja totale e projektit është 17,6 milionë euro (22,88 milionë USD).
IBRD kontribuon me 7,693 milionë euro (10 milionë USD) për grante të vogla për të zbatuar aktivitetet e komunës, mallrat, shërbimet e konsulencës dhe kostot shtesë të funksionimit. Kostot shtesë përfshijnë koston e investimit në nën-komponentin B.2 për të krijuar shërbime të ekosistemit që synojnë zonat më të degraduara (ndryshimi i përdorimit të tokës) - kontrolli i grykave dhe të ngjashme. Shuma totale për këtë qëllim është 865 000 euro. Llogaritja bazohet në një supozim se investimi mbulon 15 komuna, 150 ha për komunë dhe 500 USD/ha.
GEF kontribuon me 2,215 milion EUR (2,88 milion USD) drejt kostove operative dhe trajnimit në rritje.
Kontributi i fondit suedez të mirëbesimit (TF) prej 7,692 milionë euro (10 milionë USD) është ndarë për shërbimet e konsulencës dhe për kostot operative në rritje. Qeveria e Shqipërisë financon lidhjet e internetit me brez të gjerë në rrethe dhe mbulon auditimin financiar vjetor. Shuma e emergjencës është 1.38 milionë euro.

E ndarë në kategori si më poshtë:

**Tab. 1** Financimi i projektit sipas kategorive

| Category | Sub-total | MOE | ARDA | From Activities |
|---|---|---|---|---|
| 1. Civil Works | **0** | 0 | 0 | 0 |
| 2. Goods | **1 022 290** | 891 280 | 48 290 | 82 720 |
| 3. Consultant Services | **6 966 950** | 330 000 | | 6 636 950 |
| 4. Grants | **4 000 000** | | | 4 000 000 |
| 5. Incremental Operating Cost | **1 954 926** | 439 700 | 150 360 | 1 364 866 |
| 6. Training & Travelling | **2 270 190** | | | 2 270 190 |
| Sub-Total | **16 214 356** | 1 660 980 | 198 650 | 14 354 726 |
| Contingencies | **1 385 644** | 0 | 0 | 1 385 644 |
| Grand Total | **17 600 000** | **1 660 980** | **198 650** | **15 740 370** |

**Tab. 2** Projektet e financuara nga Agjencia Implementuese

| Category | Sub-total | IBRD | GEF | TF |
|---|---|---|---|---|
| 1. Civil Works | **0** | 0 | 0 | 0 |
| 2. Goods | **1 022 290** | 1 022 290 | 0 | 0 |
| 3. Consultant Services | **6 966 950** | 0 | 0 | 6 966 950 |
| 4. Grants | **4 000 000** | 4 000 000 | 0 | 0 |
| 5. Incremental Operating Cost | **1 954 926** | 1 418 100 | 436 826 | 100 000 |
| 6. Training & Travelling | **2 270 190** | 408 898 | 1 746 492 | 114 800 |
| Sub-Total | **16 214 356** | 6 849 288 | 2 183 318 | 7 181 750 |
| Contingency | **1 385 644** | 843 712 | 31 682 | 510 250 |
| Grand Total | **17 600 000** | **7 693 000** | **2 215 000** | **7 692 000** |

**Tab. 3** Projektet e financuara sipas komponentëve

| omponent | Sub_Total | MOE (items not allocated to activities) | ARDA(items not allocated to activities) | Items Allocated to Activities | IBRD | GEF | TF |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Component A - Improved Land use Management** | **4 878 632** | **0** | **0** | **4 878 632** | **4 099 150** | **349 082** | **430 400** |
| A.1: Provision of competitive grants for rural development measures | 4 376 570 | | | 4 376 570 | 4 016 430 | 338 540 | 21 600 |
| A.2:Implementation Communal Forestry and Pasture Management Plans (CFPMPs) | 191 662 | | | 191 662 | 80 320 | 10 542 | 100 800 |
| A.3:Implementation and preparation of Communal Micro-catchment Plans (CMCPs) | 310 400 | | | 310 400 | 2 400 | 0 | 308 000 |
| **Component B - Introducing Payment for Environmental Services (PES)** | **2 545 150** | **0** | **0** | **2 545 150** | **888 500** | **124 200** | **1 532 450** |
| B.1: Carbon sequestration | 599 600 | | | 599 600 | 8 000 | 16 800 | 574 800 |
| B.2: Development of payment for watershed services schemes | 1 945 550 | | | 1 945 550 | 880 500 | 107 400 | 957 650 |
| **Component C - Institutional and Implementation Support and Monitoring** | **8 790 574** | **1 660 980** | **198 650** | **6 930 944** | **434 068** | **1 607 976** | **4 888 900** |
| C.1: Capacity building to stakeholder institutions | 4 366 354 | 1 660 980 | 198 650 | 2 506 724 | 99 680 | 879 044 | 1 528 000 |
| C.2: Strengthening good governance | 2 731 348 | | | 2 731 348 | 93 498 | 7 750 | 2 630 100 |
| C.3: Empowering beneficiaries | 1 458 990 | | | 1 458 990 | 199 240 | 693 750 | 566 000 |
| C.4: Monitoring and Evaluation | 233 882 | | | 233 882 | 41 650 | 27 432 | 164 800 |
| **Sub-Total** | **16 214 356** | **1 660 980** | **198 650** | **14 354 726** | **5 421 718** | **2 081 258** | **6 851 750** |
| **Contingencies** | **1 385 644** | **0** | **0** | **1 385 644** | **843 712** | **31 682** | **510 250** |
| **Grand Total** | **17 600 000** | **1 660 980** | **198 650** | **15 740 370** | **6 265 430** | **2 112 940** | **7 362 00** |

Komponenti A: Përmirësimi i menaxhimit të tokës *(4.8 milionë USD)*
Komponenti B: Prezantimi i pagesave për Shërbimet Mjedisore *(2.54 milionë USD)*
Komponenti C**:** Mbështetja Institucionale dhe Implementuese dhe Monitorimi *(8.8 milionë USD)*

*Komponentët dhe vlerat e tyre përkatëse kanë ndryshime nga Projekt Dokumenti fillestar në:*
Komponenti 1: Forcimi i Kapacitetit Institucional për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit *(9.8 milionë USD)*
Komponenti 2: Planifikimi dhe Ofrimi i Granteve të ngjashme me IPARD-in për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës *(8.44 milionë USD*)
Komponenti 3: Prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore (PES) *(1.36 milion USD).*
Komponenti 4: Mbështetja e Zbatimit të Projektit *(v1.24 milion USD).*

Sipas komponentëve të mësipërme është kryer dhe Plani i prokurimeve për 18 mujorin e parë të vitit 2015 i ndarë në komponentë:

Plani Komponenti 1 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 1 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-QCBS-1 me objekt "TA for National Forest Inventory Capacity Building", me kosto të përllogaritur në shumën 400,000 euro e cila do të mbulohet nga fondet e GEF në Euro, për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar S. D. F. R.. Kontrata është lidhur me datë 27.06.2016 dhe ka përfunduar me datë 30.09.2020. Data e përfundimit të kontratës që ishte planifikuar 22 Qershor 2018. Ndryshe nga sa është planifikuar kostot janë tejkaluar si dhe janë përdorur burime të tjera financimi si 5,674 Euro nga STF (Euro), 252,272 Euro nga GEF (Euro) dhe 2,843,547 SEK pagesë direkte nga llogaria e Bankës Botërore.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-1.1 me objekt "GIS Analyst Expert in the frame of the Albanian National Forest Inventory", kosto të përllogaritur 10,000 Euro, e cila në planifikimin e 18 mujorit të parë në vitin 2015 nuk është planifikuar. Kontrata është lidhur me datë 06.01.2020 dhe ka përfunduar me 30.09.2020. Për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar konsulenti z. F. P.. Qëllimi i zhvillimit të prokurimit është që të jepet ekspertiza në fushën e përpunimit hartografik të të dhënave satelitore dhe analizave të tjera GIS në kuadër të Inventarit Kombëtarë të Pyjeve Shqiptare.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-2 me objekt "TA for drafting seconday legislation on forests (After the adoption of the neë laë on forests), nuk është zhvilluar dhe nuk janë dhënë arsyet përkatëse se ku është alokuar shumë prej 20,000 Euro që ishte përllogaritur si kosto.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-3 me objekt "NFI Capacity Building - In-depth training" e cila në planifikimin e 18 mujorit të parë në vitin 2015 përfaqësohej me Ref. ESP-CS-IC-2 dhe me objekt "Individual Consultant for registration of communal forest and pasture lands", me kosto të përllogaritur 10,000 Euro, për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar konsulenti z. E. T.. Sipas planifikimit të parë ishte parashikuar që kontrata të përfundonte në datën 21 Qershor 2015, ndërkohë që kjo kontratë ka përfunduar në 10 Shtator 2017, pa dhënë arsyet përkatëse.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-3.1, me objekt "IT Expert for NFI/NEA", nuk është parashikuar në planin e 18 mujor të parë në vitin 2015. Kostot e përllogaritura janë në shumën 25,000 Euro dhe për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar znj. B. K.. Qëllimi i

zhvillimit të këtij shërbimi është ndihma për regjistrimin e inventarizimit të pyjeve për punonjësit e angazhuar për këtë qëllim.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-QCBS-4.1 dhe Ref. ESP-CS-QCBS-4.2 me objekt "Supervision of registration of communal forest", me kosto të përllogaritur në shumën 823,000 Euro, e cila në planifikimin e 18 mujorit të parë të vitit 2015 përfaqësohej nga procedura me Ref. ESP-CS-QCBS-3 me objekt "Supervision of registration of communal forest (QC, etc) me kosto të përllogaritur në shumën 518,000 Euro. Për rritjen e kostove jepen shpjegimet përkatëse. Gjithashtu është planifikuar data e përfundimit të jetë 22.08.2018 por kontrata është amenduar dhe ka përfunduar në 30 Qershor 2020. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar A. S. . Grupi i auditimit konstatoi që dhe likuidimi i operatorit ekonomik është kryer nga burime financimi të ndryshme nga ato që ishin parashikuar si 84,000 Euro nga IBRD (Euro), 335,227 Euro nga STF (Euro), 197,294 Euro nga GEF (Euro) dhe 506,913 Euro pagesë direkte nga llogaria e Bankës Botërore. Në lidhje me pagesat, gjatë analizimi të llogarive bankare, grupi i auditimit konstatoi se pagesat nuk janë kryer sipas pikës 41.2 të kontratës nr. 6300 Prot. datë 05.07.2019 në të cilën cilësohet skedula e pagesave në 7 këste si më poshtë:

*Kësti 1 – 10% në momentin e firmosjes së kontratës*
*Kësti 2 – 10% e çmimit të kontratës në momentin e aprovimit të raportit nga IPRO dhe MTE*
*Kësti 3 – 20 e kontratës së 1th registration për çdo grup*
*Kësti 4 – 20 e kontratës sipas regjistrimit për çdo grup*
*Kësti 5 – 10% e kontratës sipas regjistrimit për grupin tjetër*
*Kësti 6 – 20% e kontratës për fazën e dytë*
*Kësti 7 – 10 % i fundit.*

| SIDA/EURO | Kompania | IBAN | Vlera | Data |
|---|---|---|---|---|
| | A S | | 20,662 | 13.12.2017 |
| | A S | | 36,732 | 07.06.2018 |
| | A S | | 36,732 | 28.06.2018 |
| | A S | | 56,709 | [redacted] |
| | A S | | 22,683 | 18.06.2020 |
| | A S | | 42,000 | [redacted] |
| | A S | | 63,000 | 05.05.2021 |
| | A S | | 56,709 | 28.05.2021 |
| Total | | | **335,227** | |
| IBRD/EURO | A S | | 84,000 | [redacted] |
| Total | | | **84,000** | |
| GEF/EURO | A S | | 145,200 | 27.02.2019 |
| | A S | | 18,605 | 25.01.2021 |
| | A S | | 22,326 | 13.07.2021 |
| | A S | | 11,163 | 13.07.2021 |
| Total | | | **197,294** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| A | | Direct Payment | EUR | 56,709.20 | 06-Aug-2021 |
| A | | Direct Payment | EUR | 154,218.40 | 19-Jul-2021 |
| A | | Direct Payment | EUR | 113,418.40 | 01-Feb-2021 |
| Al | | Direct Payment | EUR | 90,734.72 | 03-Jan-2020 |
| Al | | Direct Payment | EUR | 91,832.40 | 30-Nov-2018 |

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-6 me objekt " Consultant for implementation of Gender Action Plan for one region" me kosto të përllogaritur në shumën 135,000 Euro, e cila në planifikimin e 18 mujorit të parë të vitit 2015 përfaqësohej nga procedura me Ref. ESP-CS-CQ-5.1 me të njëjtin objekt dhe të njëjtën kosto. Zhvillimi i shërbimit të mësipërm ishte planifikuar që të përfundonte në 9 Qershor 2018, por që është përfunduar një vit më përpara, pa dhënë shpjegime mbi realizimin para kohe të kësaj procedure. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është

angazhuar Operatori Q. S. A. . Kontrata është lidhur me 18 Shtator 2015 dhe ka përfunduar me 18 Mars 2017.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-8 me objekt “National LAG Coordinator”, me kosto të përllogaritur prej 12,000 Euro, nuk ishte planifikuar në 18 mujorin e parë të vitit 2015 dhe për realizimin e shërbimit është angazhuar znj. A. B. . Kontrata ishte planifikuar të përfundonte brenda një viti, në datën 16 Dhjetor 2019 por që është amenduar duke kaluar dhe kostot e planifikuara në shumë në 3,597,907 lekë.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-QCBS-9 me objekt “Supporting development of Local Action Groups”, me kosto të përllogaritur në vlerën 300,000 Euro, e cila në planifikimin e 18 mujorit të parë të vitit 2015 përfaqësohej nga procedura me Ref. ESP-CS-QCBS-7 me të njëjtin objekt dhe të njëjtën kosto. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori E. D. . Kontrata ishte parashikuar të realizohej brenda periudhës 10 Maj 2015 dhe 15 Mars 2016, por që është zhvilluar në periudhën 24 Maj 2016 deri në 01 Mars 2019. Për amendimet e kontratave nuk janë dhënë arsyet përkatëse si dhe nuk janë parashikuar mbajtja e penaliteteve në lidhje me mos zbatimin në afat të kontratës. Gjithashtu likuidimi është kryer nga burime të ndryshme financimi nga ato të parashikuarat si 7,991,165 lekë nga llogaria IBRD (Lek) dhe 209,014 Euro nga llogaria STF (EURO). Qëllimi i zhvillimit të prokurimit është suporti i dhënë grupeve të LAG në lidhje me zhvillimin e procedurave për dhënien e granteve LEADER për LAG. Nga analizimi i llogarive bankare në lidhje me pagesat e kryera përkundrejt Operatori E. D. konstatohet që nuk janë kryer sipas pikës 41.2 të kontratës nr. 6405/1 Prot. , datë 24.02.2017 ku citohet:

*Kësti 1- 10 % e kontratës*
*Kësti 2- 20% e kontratës sipas progres raportit të 1*
*Kësti 3- 20% të kontratës sipas progres raportit të 3*
*Kësti 4- 20% e kontratës sipas progres raportit të 6*
*Kësti 5- 10% e çmimit të kontratës të draftit final*
*Kësti 6 – 20% e kontratës sipas raportit final*

| SIDA/Euro | Kompania | IBAN | Vlera | Data |
|---|---|---|---|---|
| | E | | 29,575 | 24.04.2017 |
| | E | | 59,150 | 01.06.2018 |
| | E | | 1,989 | 12.11.2018 |
| | E | | 59,150 | 12.11.2018 |
| | E | | 59,150 | 20.11.2019 |
| Total | | | 209,014 | Euro |
| IBRD/Lek | Kompania | IBAN | Vlera | Data |
| | E | | 7,991,165 | 02.08.2017 |
| Total | | | 7,991,165 | Lek |

Për kontratën janë bërë dhe tre amendime kontratash me nr. Am. nr1 datë 15.05.2017 me nr. Prot. 3952, Am nr.1(përsëri) me nr. Prot., 1907 datë 21.02.2019 dhe Am nr. 2 datë 04.07.2018 me nr. Prot. 6275.

Në procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-12 me objekt “International consultant AlFIS planning, design and quality assurance” më kosto të përllogaritu në vlerën 200,000 Euro, e cila në planifikimin e 18 mujorit të parë të vitit 2015 përfaqësohej nga procedura me Ref. ESP-CS-IC-10 me të njëjtin objekt por me kosto të ndryshme prej 120,000 Euro. Për rritjen e kostove nuk jepen shpjegime të mëtejshme. Shërbimi ishte i planifikuar të përfundonte në vitin 2016 por që është realizuar vite me vonë. Për realizimin e Kontratës është angazhuar konsulenti C. A.. Kontrata është

lidhur me datë 20 Prill 2020 dhe si datë përfundimi ishte data 20 Gusht 2020, por që ka pasur amendime kontratash pa dhënë arsyet përkatëse dhe ka përfunduar me përfundimin e projektit. Në termat e referencës të kontratës nr. 557 Prot., datë 26.01.2016 midis Ministrisë së Mjedisit, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. A. B. dhe Konsultentit z. C. A. (në kontratat e lidhura nuk jepen të dhëna mbi palët ID, NIPT etj...) është përfshirë pagesa ne vlerën 520 Euro/ditë. Konsulentit sipas termave të referencës i kërkohet të hartojë raportet si më poshtë:

*Në fund të muajit të parë – Inception Report*
*Në fund të muajit të dytë – Preliminary Report on the system's modular structure*
*Në fund të muajit të gjashtë – Appraisal Report*
*Në fund të muajit të 12 – Specification for procurement of the neccesary hardware*
*5th day of the following month- monthly report and monthly work plans*
*Minimum 15 days before the assigment completion- Draft final report*
*End of the assignmet – Final Report*

Grupi të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion dokumentacioni i mësipërm. Gjithashtu cilësohet në termat e referencës që Raportet duhet të jenë në dy gjuhë Anglisht dhe Shqip. Nga auditimi i llogarive bankare në lidhje me pagesat e kryera përkundrejt z. C. A. jepen si më poshtë:

*Fat. 08116 dt. 29.04.2016 – 17,219.65 Euro*
*Fat. 17116 dt. 14.09.2016 – 15,509.86 Euro*
*Fat. ......... dt. 16.04.2017 – 18,116 Euro*
*Fat. ...........dt. 28.07.2017 – 21,796.36 Euro*
*Fat. 01/18..dt. 12.01.2018 – 26,119.75 Euro*
*Fat. 10/18 dt. 10.07.2018 – 10,222.48 Euro*
*Fat. 10/18 dt. 10.07.2018 - 10,222,48 Euro (pagesë e dyfishtë me të njëjtën numër fature dhe date)*
*Fat. 01/19 dt. 08.02.2019 - 4,420 Euro*
*Fat. 19 dt. 13.12.2019 - 7,280 Euro*
*Fat. 14/20 dt. 13.09.2020 – 3,380 Euro.*

Grupi i auditimit konstaton që pagesa e faturave nuk është në proporcion me dërgimin e raporteve sipas termave të referencës apo sipas Pikës 3. Payment të kontratës në të cilën klienti do të paguhet në rate për man/month sipas Anex B.
Gjithashtu janë bërë 3 amendime kontrate, amendimi nr.1 dt. 31.01.2019 me nr. Prot. 987 e cila nuk përmban firmën e palës konsulentë z. C. A. , amendimi nr.2 që nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe amendimi nr. 3 dt. 19.06.2020 me nr. Prot. 4289, i cili gjithashtu nuk është firmosur nga pala konsulente z. C. A..

Plani Komponenti 2 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 2 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-13.1, ESP-CS-CQ-13.2, ESP-CS-CQ-13.3, ESP-CS-CQ-13.4 me objekt "Consultant for Creation of FPMP" me kosto të përllogaritur në 2,165,000 Euro, e cila në planifikimin 18 Mujor të vitit 2015 ka objekt dhe kosto të ndryshme. Nuk jepen shpjegime të mëtejshme për ndryshimin e komponentit të mësipërm. Në realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori A. & O. P. . Nga analizimi i pagesave, kostoja e përllogaritur në planifikim është tejkaluar si dhe janë përdorur burime të tjera likuidimi, pagesë në shumën 2,454,874 Euro nga llogaria e Bankës Botërore. Qëllimi i zhvillimit të procedurës së prokurimit është përgatitja e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.

Kontrata nr.1 datë 12.11.2020 me nr. 7540 Prot., midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe BOE A. & O. P. . Kjo kontratë është amenduar në datën 04.03.2021 me nr. Prot. 1648 si dhe në datën 24.05.2021 me nr. Prot. 3407 Amendimi i kontratës gjithashtu konsiston në ndryshimin e kësteve të pagesave.
Grupi të auditimit nuk iu vunë në dispozicion kontratat e tjera sipas numrave të Ref. ESP-CS-CQ-13.2, ESP-CS-CQ-13.3, ESP-CS-CQ-13.4.

| Banka Boterore | Kompania | IBAN | Vlera | Data |
|---|---|---|---|---|
| | A | A | 64,132.00 | 9-Sep-21 |
| | A | A | 290,389.57 | 31-Aug-2021 |
| | A | A | 128,738.39 | 29-Apr-2021 |
| | A | A | 128,738.39 | 29-Dec-2020 |
| | A | A | 128,738.39 | 04-Mar-2020 |
| | A | A | 171,651.18 | 21-Jan-2020 |
| | A | A | 11,002.02 | 11-Sep-2021 |
| | A | A | 55,010.08 | 27-Jul-2021 |
| | A | A | 110,020.40 | 25-Jun-2021 |
| | A | A | 165,030.24 | 16-Mar-2021 |
| | A | A | 165,030.24 | 18-Sep-2020 |
| | A | A | 165,030.24 | 11-Dec-2019 |
| | A | A | 220,040.30 | 06-Nov-2019 |
| | A | A | 31,453.24 | 11-Sep-2021 |
| | A | A | 110,353.95 | 18-Aug-2021 |
| | A | A | 108,220.00 | 02-Aug-2021 |
| | A | A | 220,040.32 | 18-May-2021 |
| | A | A | 49,046.20 | 17-May-2021 |
| | A | A | 46,380.00 | 17-May-2021 |
| | A | A | 85,830.85 | 08-Apr-2021 |
| **Total** | | | 2,454,876.00 | |

Grupi i auditimit nga analizimi i llogarive bankare konstatoi që pagesat e kryera drejt OE nuk janë sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Gjithashtu grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion mbi zbatimin e kontratës duke qenë se termat e referencës mbi produktin janë të pamatshëm, duke qenë se është dhe kontratë shërbimi konsulence. Gjithashtu për të njëjtin objekt është zhvilluar dhe procedura e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-3.1, me objekt “IT Expert for NFI/NEA”, e cila nuk ishte parashikuar në planin e 18 mujor të parë në vitin 2015. Kostot e përllogaritura janë në shumën 25,000 Euro (170 Euro/dita) dhe për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar znj. B. K.. e cila njëkohësisht rezulton e punësuar pranë shoqërisë A.. Kontrata është lidhur me datë 03.04.2018 me nr. 2670 Prot.. Afati i zbatimit të kontratës është 12.03.2018-31.09.2019. Në këtë rast ka një mosrakordim midis datës së lidhjes së kontratës dhe datës së zbatimit të saj. Pagesat në termat e referencës janë si më poshtë:

8 ditë/muaj * 170 Euro/dita*19 muaj= 25,840 Euro

Nga analizimi i llogarive bankare pagesat për kontratën e mësipërme janë si më poshtë:

*31.05.2018 – 16 ditë Mars 2018 – 2,312 Euro – dhe në këtë rast nuk ka një përputhje me kontratën e nënshkruar, pasi kontrata është lidhur në muajin Prill të vitit 2018 si dhe në pagesën e cilësuar në termat e referencës angazhimi do ishte vetëm 8 ditë në muaj.*
*31.05.2018 – 16 ditë Prill 2018 – 2,312 Euro – edhe në këtë rast pagesa nuk është kryer në përputhje me kontratën e shërbimit*
*04.07.2018 – 25 ditë Maj 2018 – 3,613 Euro – edhe në këtë rast pagesa nuk është kryer në përputhje me kontratën e shërbimit*
*08.08.2018 – 12 ditë (nuk specifikohen datat) – 1,7342 Euro*
*04.10.2018 – 4 ditë ( nuk specifikohen datat) – 578 Euro*
*12.11.2018 – 8 ditë Shtator – 1,156 Euro*
*06.12.2018 – 12 ditë Tetor 2018 – 1734 euro - edhe në këtë rast pagesa nuk është kryer në përputhje me kontratën e shërbimit*
*06.12.2018 - 7 ditë (nuk specifikohen datat) – 1,011 Euro*

| |
|---|
| *13.02.2019 – 7 ditë dhjetor – 1,011 Euro*<br>*20.03.2019 – 10 ditë (nuk specifikohen datat) – 1,445 Euro*<br>*Në total-----------------------------------------------16,906 Euro* |

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-14.1 me objekt "Consultant to prepare guidelines for MPs" me kosto të përllogaritur në vlerën 80,800 Euro (750 Euro/ditë), e cila nuk është planifikuar në planin 18 mujor të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. U. B. Kontrata është lidhur me datë 15.05.2017 me nr. 2941/1 Prot. me afat nga data 22.05.2017-22.11.2017. Sipas termave të referencës pagesat do të kryheshin si më poshtë:
10% në momentin e firmosjes së kontratës
20% kur të plotësohet faza e parë
10% në fund të 3 muajve
30% të kontratës pasi është kompletuar drafti final
30% në momentin e raportit final dhe sipas Aneksit B të kontratës, si më poshtë:

| |
|---|
| *Pagesë ditore 750 Euro/ditë * 90 ditë = 67,500 Euro*<br>*Rimbursime 4 fluturime * 450 Euro = 1800 Euro*<br>*Transport Lokal 40 Euro * 35 Ditë qëndrimi në Shqipëri = 1400 Euro*<br>*Akomodim në Tiranë 35 netë * 90 Euro = 3,150 Euro*<br>*Dieta në Tiranë 70 Euro/ dita * 35 = 2,450 Euro*<br>*Përkthimi 4500 Euro*<br>*Kostoja totale e kontratës 80,800 Euro* |

Nga analizimi i llogarive bankare, pagesat për shërbimin e mësipërm janë kryer si më poshtë:

| |
|---|
| *26.07.2017 – 6,868 Euro*<br>*27.03.2018 – 20,604 Euro (pagesë jo sipas kushteve dhe afateve të kontratës)*<br>*28.06.2018 – 6,868 Euro ( pagesë jo sipas kushteve dhe afatave të kontratës, pasi ishte planifikuar që kjo pagesë të kryhej në fund të 3 mujorit të parë pas lidhjes së kontratës)*<br>*24.08.2018 – 20,604 Euro (pagesë jo sipas kushteve dhe afateve të kontratës)* |

Gjithashtu nga llogaria tjetër GEF (Lek)
*13.12.2017 – 1,872,216 Lek (13,736 Euro)* (pagesë jo sipas kushteve dhe afateve të kontratës)
Nga grupi i auditimit nuk u arrit të verifikohej nëse konsulenti z. U. B. ka qenë i pranishëm në Shqipëri 35 ditë sipas kushteve të kontratës.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-SS-14.2 me objekt "Ind. Consultant for Interim F&P Database", me kosto të përllogaritur në vlerën 70,000 Euro, e cila nuk është planifikuar në planin 18 mujor të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. G. F.. Kostoja e planifikuar është tejkaluar duke shkuar në shumën 104,904 Euro. Kontrata është lidhur me datë 12 Maj 2018. z. G. F. rezulton njëkohësisht edhe Administrator i kompanisë A. S. - A. B. me NIPT L........N, kompani e cila gjithashtu është angazhuar në realizimin e procedurave të tjera të prokurimit me Ref. ESP-CS-QCBS-4.1 dhe Ref. ESP-CS-QCBS-4.2 me objekt "Supervision of registration of communal forest", me kosto të përllogaritur në shumën 823,000 Euro. Objekti midis procedurave të prokurimit është i ngjashëm si dhe datat e zhvillimit të tyre janë të njëjta. Pagesat do të kryhen sipas kushteve të kontratës, si më poshtë:

| |
|---|
| *Kësti 1- 10% në firmosjen e kontratës*<br>*Kësti 2 – 10% inception Report*<br>*Kësti 3 – 30% Report 1* |

*Kësti 4 – 40 % Report 2*
*Kësti 5 – 10 % Report Final dhe sipas Aneksit B të kontratës*

*Pagesë ditore 550 Euro/ditë * 90 ditë = 67,500 Euro*
*Rimbursime 5 fluturime * 280 Euro = 1800 Euro*
*Transport Lokal 20 Euro *4 Ditë qëndrimi në Shqipëri = 1400 Euro*
*Akomodim në Tiranë 45 netë * 75 Euro = 3,150 Euro*
*Dieta në Tiranë 60 Euro/ dita * 45 = 2,450 Euro*
*Përkthimi  2500 Euro*

Nga analizimi i llogarive bankare, pagesat e kryera janë si më poshtë:

*10.08.2018- 6,037 Euro*
*06.12.2018 – 24,150 Euro*
*20.03.2019 – 64,227 Euro*
*18.05.2021 – 10,490 Euro*

Të gjitha pagesat e mësipërme nuk janë bërë sipas termave të referencës dhe kushteve të kontratës. Gjithashtu për kontratën e mësipërme janë kryer dhe amendime të kontratave pa dhënë shpjegimet përkatëse. Sipas Kushteve të kontratës së parë, konsulenti z. G. F. duhej të ishte i pranishëm në Shqipëri të paktën gjysmën e periudhës së kontraktuar, e cila nuk u arrit të vërtetohej nga grupi i auditimit.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-17.1 me objekt "Design of measure in Forestry as part of IPARD program", me kosto të përllogaritur në shumën 45,000 Euro, e cila nuk është planifikuar në planin 18 mujor të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. A. K.. Pagesa për shërbimin e mësipërm është kryer nga Banka Botërore dhe jo ashtu siç ishte planifikuar duke marrë 4980 Euro më shume.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-18 me objekt "Development of ARDA MIS for management of grant applications, me kosto të përllogaritur 60,000 Euro, gjithashtu nuk është planifikuar në planin 18 mujor të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori I. I. I. . Pagesat e kryera për shërbimin e mësipërm nuk janë kryer sipas planifikimit, 36,000 Euro nga STF (Euro) dhe 9,022 Euro pagesë nga llogaria e Bankës Botërore. Kontrata është lidhur me datë 28.12.2015 me nr. Prot. 7569. Afati i zbatimit të kontratës është 5.01.2016- 04.01.2019. Pagesat do të kryhen sipas kushteve të kontratës si më poshtë:

*Kësti 1- 10% në firmosjen e kontratës*
*Kësti 2 – 10% inception Report nga AZHBR*
*Kësti 3 – 20% Report 1*
*Kësti 4 – 35 % Report 2*
*Kësti 5 – 10 % në fund të garancisë*
*Kësti 6 – 10% pas vitit të 1 të përfundimit të garancisë*
*Kësti 7 – 5% në fund të mirëmbajtjes periodike*

Gjithashtu kemi një amendim kontrate nr. 4673 Prot., datë 16.05.2019, e cila është kryer 5 muaj pasi ka përfunduar kontrata, datë 04.01.2019.

Sipas analizimit të llogarive bankare, janë kryer pagesat si më poshtë:

| |
|---|
| *29.02.2016 – Kësti 1 dhe 2 Arda Software – 9,940 Euro* |
| *15.03.2016 – 9,940 Euro (pagesa të kryera jo sipas kushteve dhe afateve të kontratës)* |
| *12.07.2016 – Kësti 4 – 17,395 Euro* |
| *16.02.2017 – Kësti 5 4,970 Euro* |
| *27.03.2018 – Kësti 6 – 4,970 Euro* |
| *05.10.2021- Kësti 7 – 9,022 nga llogaria e bankës botërore* |

Nga grupi i auditimit u konstatua që qëllimi i shërbimit të mësipërm është implementimi i sistemit MIS për dhënien e granteve në AZHBR, por ndërkohë që janë marrë pagesat dhe është kryer ky shërbim nuk ka përputhje me kohën e realizimit të granteve pranë AZHBR.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-19 me objekt "Environment and Social Safeguards consultant for reviewing grant applications", me kosto të përllogaritur 36,000 Euro, për periudhën 2015-2020, e planifikuar që në 18 mujorin e parë të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. E. N.. Kostot e përllogaritura në fillim janë tejkaluar si dhe pagesat janë kryer nga burime të ndryshme dhe jo nga ato që ishin planifikuar në fillim, si 7,566,644 Lekë nga STF (Lek) dhe 80,605 Lek nga GEF (Lek).

Plani Komponenti 3 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 3 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-18.1 me objekt "Scoping Study of the potential for Carbon payments", me kosto të përllogaritur në vlerën 25,000 Euro. Zhvillimi i procedurës së mësipërme nuk është planifikuar në planin 18 mujor të parë të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. J. L. Pagesat për shërbimin e kryer janë kryer nga llogaria GEF (Lek) në vlerën 2,986,135 lekë dhe nga llogaria GEF (Euro) në vlerën 2,892 Euro.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-CQBS-22 me objekt "Conducting Hydrological Models &Bathymetric Measurements (Bovilla and Ulza reservoirs)" me kosto të përllogaritur në vlerën 250,000 Euro, e cila në planin 18 mujor të parë të vitit 2015 është pasqyruar me Ref. ESP-CS-CQ-25.1 dhe me objekt "Sediment measurement and monitoring (Ulza)" me kosto të përllogaritur në vlerën 200,000 Euro. Nuk jepen shpjegime mbi rritjen e kostove të përllogaritura. Për realizimin e shërbimit është angazhuar Operatori "J. B. S. & E. sh.p.k". Në lidhje me pagesat e shërbimit janë kryer nga burime të ndryshme financimi si 159,660 Euro nga STF (Euro) 11,420,824 Lekë nga STF (Lek) dhe 53,222 Euro nga llogaria e Bankës Botërore. Gjithashtu afati i përfundimit të kontratës ka qen viti 2017 dhe realizimi i kontratës ka përfunduar në vitin 2019. Kontrata është lidhur me datë 22.05.2017 me nr. Prot. 285/1. Afati i përfundimit të kontratës është 22.05.2019. Në kontratë mungojnë firmat e operatorëve të tjerë pjesëmarrës.
Pagesat do kryhen sipas kushteve të kontratës si më poshtë:

| |
|---|
| *Kësti 1 – 20% e kontratës* |
| *Kësti 2 – 20% e progres raportit të 1* |
| *Kësti 3 – 25% e progres raportit të 2* |
| *Kësti 4 – 15% e draftit final* |
| *Kësti 5 – 20% e raportit final* |

| GEF/Euro | | Kompania | IBAN | Vlera | Data |
|---|---|---|---|---|---|
| | | B | | 42,576 | 11.09.2017 |
| | | B | | 42,576 | 31.05.2018 |
| | | B | | 31,932 | 09.08.2019 |
| | | B | | 42,576 | 16.10.2019 |
| Total | | | | 159,660 | |

+ një pagesë nga Banka Botërore në vlerën 53,222 Euro në datën 20.12.2018

Për kontratën e mësipërme është kryer një amendim nr.1 me nr. 5381 Prot., datë 07.06.2019, 15 ditë pasi ka përfunduar kontrata. Objekti i amendimit është shtyrja e afatit të kontratës me një muaj dhe një javë, deri në 30.06.2019. Ky amendim kontrate është i pa firmosur nga BOE.
Nga analizimi i pagesave në llogarinë bankare vihet re që nuk janë respektuar kushtet dhe afatet e kontratës, pasi kemi fatura të OE të datës 29.05.2019, jashtë afateve të përfundimit të kontratës së parë, paguar me datë 09.08.2019 si dhe fatura e raportit final që është paguar me datë 16.10.2019.

Në zhvillimin e procedurës me Ref. ESP-CS-CQ-23.1 me objekt "Costs and Benefits of Current and Alternative Land Uses in Bovilla and Uleza Watersheds" me kosto të përllogaritur në vlerën 15,000 Euro, e cila nuk është planifikuar 18 mujorin e parë të vitit 2015. Për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar Operatori D. C. . Për përfundimin e kontratës është planifikuar viti 2016 po që ka përfunduar në Mars të vitit 2021.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-26 me objekt "Sediment measurement and monitoring / Uleza" me kosto të përllogaritur në vlerën 150,000 Euro. Në planin 18 mujor të parë të vitit 2015 është pasqyruar me Ref. ESP-CS-CQ-25.1 dhe me objekt "Sediment measurement and monitoring (Ulza)" me kosto të përllogaritur në vlerën 200,000 Euro. Për realizimin e shërbimit është angazhuar Operatori D. C. . Pagesat në lidhje me realizimin e shërbimit janë kryer nga burime të ndryshme financimi si 4,962,737 lekë nga llogaria IBRD (Lek), 143,388 Euro nga GEF (Euro) dhe 3,971,135 lekë nga llogaria GEF (Lekë).

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-27 me objekt "Study on Cost of Land Degradation", me kosto të përllogaritura në vlerën 60,000 Euro. Në planin 18 mujor të vitit 2015 është planifikuar me të njëjtin objekt dhe kosto. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar A. .

Plani Komponenti 4 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 4 (Shërbime Konsulence) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**

Plani Komponenti 1 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 1 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-G-ICB-2 me objekt "Purchase of vehicles" me kosto të përllogaritur në vlerën 300,000 Euro, e parashikuar dhe në planin fillestar të prokurimeve me të njëjtin objekt por me kosto të ndryshme prej 400,000 Euro. Për realizimin e procedurës së mësipërme është angazhuar Operatori C. sh.p.k për Lotin 1 dhe T. A. për Lotin 2. Për pagesat e kontratave të mësipërme janë përdorur burime të ndryshme financimi dhe jo siç ishte planifikuar. Gjithashtu janë tejkaluar dhe kostot e planifikuara, si 44,166 Euro nga llogaria IBRD (Eur), 36,100 Euro nga llogaria STF (Eur), 122,000 Lekë nga llogaria STF (Lek), dhe 173,000 Euro pagesë nga llogaria e Bankës Botërore.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-G-SH-3 me objekt “Equipment for field staff (NFI & FMP)”, me kosto të përllogaritur në vlerën 56,500 Euro. Në planin fillestar të procedurave të prokurimit është parashikuar si zë me Ref. ESP-G-SH-3 me të njëjtin objekt por me kosto të ndryshme, në vlerën 26,500 Euro. Nuk jepen shpjegime në lidhje me fryrjen e kostove. Gjithashtu me të njëjtin objekt është zhvilluar dhe një procedurë tjetër prokurimi me Ref. ESP-G-SH-3.1 me kosto të përllogaritur 70,000 Euro. Për realizmin e procedurës me Ref. ESP-G-SH-3 është angazhuar Operatori K. sh.p.k me pagesa nga burim të ndryshme financimi që tejkalojnë dhe kostot e parashikuara si, 184,267 Euro nga llogaria IBRD (Eur), 14,375 Euro nga llogaria STF (Eur), 49,950 Lekë nga llogaria STF (Lek). Për realizimin e procedurës me Ref. ESP-G-SH-3.1 është angazhuar operatori Office Solution, me pagesa nga burime të ndryshme financimi që tejkalojnë kostot e parashikuara, si 445,943 Lekë nga llogaria IBRD (Lek) dhe 9,610,816 Lek nga llogaria STF (Lek).

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-G-NCB-4 me objekt “Procurement of IT equipment for AlFIS/municipalities, SIEF” me kosto të përllogaritur në vlerën 244,000 Euro. Në planin fillestar të procedurave të prokurimit është parashikuar si zë me të njëjtin objekt dhe Referenc. Për realizimin e procedurës është angazhuar Operatori F. sh.p.k si dhe pagesat janë kryer nga burime të njëjta si ato të planifikuarat.

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-TS-ICB-7 me objekt “AlFIS Software development and implementation and associated hardware”, me kosto të përllogaritura në vlerën 520,000 Euro. Në planin fillestar të procedurave të prokurimit është parashikuar me të njëjtin objekt me Ref. ESP-TS-ICB-6 por me kosto të ndryshme prej 240,000 Euro. Nuk jepen shpjegimet mbi fryrjen e kostove për të njëjtën procedurë prokurimi me të njëjtin objekt. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori JV: A. & F..

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-TS-ICB-8.1 dhe ESP-TS-ICB-8.2 me objekt “Registration of communal forest and pasture” me kosto të përllogaritur në vlerën 3,830,000 Euro. Në planin fillestar të procedurave të prokurimit është parashikuar me të njëjtin objekt me Ref. ESP-TS-ICB-7 por me kosto më të ulët në vlerën prej 3,450,000 Euro. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori C. P. & D..

Grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion 5 dosje me kontrata. Këto dosje kanë qenë të gjitha të pa inventarizuara dhe dokumentacioni ka qenë i shpërndarë në data dhe në dosje të ndryshme, pa një rrjedhë kronologjike veprimi. Nga analizimi i dokumentacionit në këto dosje për grupi i auditimit konstatoi:

Mungon kontrata e lidhur me midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe B.O.E. C. P. & D. T. , me Ref. ESP-TS-ICB-8, me objekt “Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave 1”.

Për kontratën e mësipërme ka pasur dhe amendime kontrate ndër të cilat mungon Amendimi nr.2 i kontratës.

Amendimi nr.5 i lidhur në datën 07.06.2019 me nr. 5380 prot., me qëllim shtyrjen e afatit të kontratës kryesore mungon firma nga përfaqësuesit e B.O.E. Objekti i Amendimit të kontratës nr.5 është shtyrja e afatit të zbatimit të kontratës deri ne 30 shtator 2019.

Amendimi nr.6 i lidhur në datën 27.04.2020 me nr. 3030 prot., me objekt shtyrjen e afatit të kontratës nga 20.04.2020 në 30.09.2020 ( periudha 30 shtator 2019-20 prill 2020 nuk mbulohet me asnjë amendim).

Gjithashtu Amendimi nr. 6, 7 dhe 8 është i pa firmosur nga përfaqësuesit e B.O.E.
Kontrata e lidhur midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisi dhe B.O.E. C. P. & D. T. me nr ESP-TS-ICB-8.2 me objekt "Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave 2" i lidhur në datën 28.01.2019 me nr. 773/1 prot., ka mangësi si mëposhtë:
Amendimi nr. 2,3 ,4 i lidhur në datën 01.06.2020 me nr. 3650 prot., me objekt shtyrje afati nuk është i firmosur nga O.E.
Amendimi nr.4 ka për objekt shtyrjen e afatit të kontratës nga 10.04.2020 në 31.05.2020 ( ndërkohe ky amendament është bere ne 9 prill 2021).

**BILL OF QUANTITIES**

**ADDITIONAL TECHNICAL SERVICES**
**FOR**
**1ST REGISTRATION OF FORESTS AND PASTURES IN ALBANIA**

| Description | Unit | QTY | Price for Unit | Amount |
|---|---|---|---|---|
| **1.2 Changes to be effective to kartelas with Restricted Order due to: Fact□Document Differences:** | | | | **45,000 €** |
| a. comparison and verification of the record between CoMD 433 and CoMD 398, if the change in the area of the parcel or in the respective list is reflected in the CoMD 398/2020 | property | 5,000 | 5.00 € | 25,000 € |
| c. preparation of the draft order to repeal the existing Restriction Order, based on CoMD 398/2020 | property | 5,000 | 4.00 € | 20,000 € |
| **1.3 Changes to be effective to kartela with Restricted Order due to Geographical location of the parcel, different from the definition in CoMD 433/2016:** | property | | | **10,000 €** |
| a. comparison and verification of the record between CoMD 433 and CoMD 398, if it is reflected the change in the respective list in the CoMD 398/2020; | property | 1,000 | 5.00 € | 5,000 € |
| d. preparation of the draft order to repeal the existing Restriction Order, based on CoMD 398/2020 | property | 1,000 | 5.00 € | 5,000 € |
| **1.4 Changes to be effective to kartelas with Restricted Order due to overlapping with protected areas:** | property | | | **10,000 €** |
| a. comparison and verification of the record between CoMD 433 and CoMD 398, if the change is reflected in the respective list in the CoMD 398/2020; | property | 1,000 | 5.00 € | 5,000 € |
| f. preparation of the draft order to repeal the existing Restriction Order, based on CoMD 398/2020. | property | 1,000 | 5.00 € | 5,000 € |
| **2. Preparation and printing of Draft Orders for removal of restrictions and submission to the relevant SCALD to be signed** | property | 6,000 | 2.50 € | 15,000 € |
| **3. Detailed approach for printing merged parcels presenting in the maps the list of properties to be merged** | property | 4,000 | 10.00 € | 40,000 € |
| **Total** | | | | **120,000 €** |
| **VAT (20%)** | | | | **24,000 €** |
| **Total including VAT** | | | | **144,000 €** |

The parties agree the payment will be done based on the number of units produced for each of the activities described in the Bill of Quantities table, but in any case, the total will not exceed the total amount of Euro 120,000.

Në lidhje me pagesat e kryera nuk janë përdorur burimet e financimit të planifikuara por burimet e tjera si 1,091,852 Euro nga llogaria IBRD (Eur) dhe 3,112,633 Euro nga llogaria e Bankës Botërore.

| IBRD/EURO | Kompania | IBAN | Vlera | Data |
|---|---|---|---|---|
| | C | | 129,382 | 26.07.2017 |
| | C | | 390,723 | 01.06.2018 |
| | C | | 151,320 | 08.02.2019 |
| | C | | 52,224 | 25.03.2021 |
| | C | | 34,891 | 24.06.2021 |
| | C | | 87,107 | 10.08.2021 |
| | C | | 15,329 | 10.08.2021 |
| | C | | 132,485 | 07.09.2021 |
| | C | | 81,000 | 20.09.2021 |
| | C | | 17,391 | 27.09.2021 |
| | | TOTALI | 1,091,852 | |

| | | | | Paid | Date Received | Value Date | Date Closed |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Beneficiary Account | Ccy | Appl Pymt Amt | Appl Doc Amt | Ccy | | | |
| AL | EUR | 119,474.68 | 119,474.68 | EUR | 21-Sep-20 | 29-Sep-20 | 29-Sep-2021 |
| AL | EUR | 84,622.49 | 84,622.49 | EUR | 11-Sep-20 | 16-Sep-20 | 16-Sep-2021 |
| AL | EUR | 387,542.83 | 387,542.83 | EUR | 10-Sep-20 | 22-Sep-20 | 22-Sep-2021 |
| AL | EUR | 86,959.00 | 86,959.00 | EUR | 18-Aug-20 | 26-Aug-20 | 26-Aug-2021 |
| AL | EUR | 615,569.58 | 615,569.58 | EUR | 29-Dec-20 | 05-Jan-20 | 05-Jan-2021 |
| AL | EUR | 1,410,121.70 | 1,410,121.70 | EUR | 13-Dec-20 | 03-Jan-20 | 03-Jan-2020 |
| AL | EUR | 178,727.17 | 178,727.17 | EUR | 08-Oct-20 | 30-Oct-20 | 30-Oct-2018 |
| AL | EUR | 229,615.67 | 229,615.67 | EUR | 04-Sep-20 | 10-Sep-20 | 10-Sep-2018 |

*Total* *3,112,633 Euro*

Grupi i auditimit konstatoi që në pagesat e kryera nëpërmjet llogarive bankare, janë kryer pagesa brenda një afati kohor të shkurtët duke përdorur burime të ndryshme financimi.
Gjithashtu janë në Qershor të vitit 2021 janë lëshuar 5 Fatura nga të cilat 3 fatura me datë 25.06.2021, 1 faturë me datë 11.06.2021 dhe një faturë tjetër me datë 21.06.2021. Në total vlera e faturave është 333,312 Euro.
Gjithashtu janë lëshuar dhe fatura ditët e fundit të përfundimit të përfundimit të projektit Shërbimet Mjedisore datë 30.09.2021. Faturat janë lëshuar sipas datave 10,11,21.09.2021, me vlerë totale prej 591,640 Euro.
Pagesat direkte nga llogaria e Bankës Botërore, arrijnë në vlerën 3,112,633 Euro.

Plani Komponenti 2 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 2 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**

Në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimi me Ref. ESP-G-SH-10 me objekt "IT equipment (ARDA, MoE, Inspectorate & PMT)" me kosto të përllogaritur në vlerën 75,000 Euro, e cila nuk është parashikuar në planin fillestar të prokurimeve.

Plani Komponenti 3 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 3 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Plani Komponenti 4 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Realizimi Komponenti 4 (Mallra dhe Shërbime) **(bashkëlidhur në ANEKSE)**
Për sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi (konkluzion):

- Planet Vjetor të Punës (prokurimeve) dhe të Buxhetit për këtë projekt nuk janë vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, dhe gjithë analiza është bërë në dokumentet elektronike të sjella nga menaxheri i projektit. Gjithashtu ndryshimet që janë bërë nga planifikimi kryesor që është vendosur në dispozicion nuk kanë miratimin paraprak me shkrim nga Banka Botërore sipas pikës 3 Seksioni C Plani Vjetor i Punës dhe Buxhetit ligji nr.151 dhe 152 viti 2014.
- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion Komiteti Teknik i projektit ka qenë inekzistent edhe pse ky Komitet Teknik ka pasur një rol kyç në miratimin e Planit dhe Buxhetit Vjetor të Punës dhe në monitorimin e zbatimin e Projektit.
- Kostot e projektit janë përcaktuar në dokumentin fillestar të cilësuar si Projekt Dokument, e ndarë në komponentë. Këto komponentë kanë ndryshuar ku dhe gjithashtu janë ndryshuar dhe kostot përkatëse.
- Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të komponentëve janë zhvilluar procedura prokurimi të ndara në dy kategori (shërbime konsulence dhe mallra/shërbime).

- Procedurat e prokurimit janë planifikuar në Shkurt të vitit 2015 (në fillim të nisjes së realizimit të projektit) për 18 muaj e parë, në të cilën janë të detajuara duke përfshirë Referencën, objektin, kostot e përllogaritura, burimi i financimit, prioriteti, data e zhvillimit, kohëzgjatja e zbatimit.
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit nuk është kryer sipas planit të parë 18 mujor, duke mos respektuar hierarkinë e përzgjedhjes së tyre sipas prioritarizimit, sipas datës së planifikuar dhe sipas kostos së përllogaritur.
- Në disa prej kontratave të analizuara më sipër ka tejkalim të afateve të përcaktuar në planifikimin e procedurave të prokurimit, për të cilët duke qenë se janë dhe kontrata konsulence, nga grupi i auditimit nuk mund të përcaktohet shkaku apo dhe efekti që kanë shkaktuar këto vonesa në zbatimin e kontratave. Gjithashtu në kontratat e audituara nga grup i auditimit nuk cilësohen penalitetet në lidhje me moszbatimin në kohë të kontratave.
- Për disa nga procedurat e prokurimit të planifikuara nuk janë zhvilluar dhe nuk jepen shpjegime në lidhje alokimin e kostove të caktuara për këto procedura.
- Shtyrja në kohë e zhvillimit të procedurave të prokurimit, të realizimit të projektit ka rritur kostot operacionale
- Duke qenë se kontratat e mësipërme janë të formës shërbime konsulence, grupi i auditimit nuk mund të arrijë një konkluzion mbi zbatimin e tyre duke qenë se dhe në kontratat e tyre janë përfshirë terma reference të cilat janë të pamatshme (suport) por edhe në rastin kur janë të përfshira terma reference të matshme (trajnime capacity building) rezultati mbetet i pamatshëm.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ish Sekretarët e Përgjithshëm z. A. B., z. P. N. , z. A. K., Ekipi i Menaxhimit të Projektit z. E. I., znj. B. B., znj. K. Z., znj. H. F., znj. D. Q., z. E. N., znj. V. S. , znj. M. S. Komiteti Drejtuesit e Projektit dhe Komiteti Teknik i Projektit, në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin Shërbimet Mjedisore.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar në institucion me nr. 346/9, datë 01.11.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:*

**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur)**:.......... Ne lidhje me konstantimet e observuara ne Akt Konstatimin numër 4, ju bëjmë me dije se Dokumenti fillestar i projektit i datës 7.11.2013 është pika zero e tij, një dokument i përgatitur nga një konsulencë e huaj ku janë hedhur bazat për aktivitetet kryesore të projektit. Më pas projekt dokumenti është përpunuar dhe strukturuar më mirë nga Ministria e Mjedisit së bashku me Bankën
Botërore sipas aktiviteteve dhe komponentëve për një adresim më të plotë të çështjeve të sektorit
por dhe shpërndarje me e sakte e fondeve ne zbatim te projektit sipas aktiviteteve/komponentëve. Ministria e Mjedisit ne diskutim me Bankën Botërore ne rolin e donatorit dhe administratorit te fondeve te saj por dhe atyre grant te SIDA dhe GEF, ka negociuar dhe dakortësuar dokumentin zyrtar të projektit (Dok.nr.1 - Project Appraisal Document - PAD). Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se plani i prokurimit fillestar është përditësuar në mënyrë periodike në dakortësi me Ministrinë dhe me Bankën Botërore.

Ndryshimet në aktivitete apo në buxhetet përkatëse të tyre janë diskutuar me stafin e Ministrisë dhe të Bankës Botërore gjatë misioneve periodike (një ose dy here ne vit), si dhe ecuria e tyre është reflektuar në Progres raportet periodike të përcjella në Bankën Botërore.

1. Në lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-QCBS-1 me objekt 'TA për National Forest Inventory Capacity Building'**: informojmë se kontrata e NFICB është amenduar për shtyrje të afatit kohor dhe në vlerë monetare (reference Dok.nr.3 Amendimet e ESP-CS-QCBS-1 me objekt 'TA për National Forest Inventory Capacity Building') sepse është vlerësuar e rëndësishme dhe e domosdoshme përveç mbështetjes teknike në zbatimin e inventarit, të kërkohej krijimi dhe mirëmbajtja e një aplikacioni si OpenForis për grumbullimin e të dhënave të sipërfaqeve prove. Një element shtesë i cili kërkonte shtyrjen në kohë dhe kosto të konsulencës ishte dhe përgatitja e ekuacioneve alometrike (reference Dok. nr.5. raporti i Bankës Botërore bashkëlidhur AM_ISR December 2-7 2019, paragrafi 6) për llojet kryesore pyjore të vendit tonë, e thënë ndryshe ekuacionet volumetrike që shërbejnë përllogaritjen e volumit të lëndës drusore duke përdorur parametrat e matshëm të tilla si diametri dhe lartësia e drurit. Sa i përket burimeve të

ndryshëm të financimit, duhet të shpreh se burimet e financimit janë në përputhje me marrëveshjet e projektit të nënshkruara mes Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore.
2. Për procedurën e prokurimit **ESP-CS-IC.1.1 me objekt 'GIS Analyst Expert in the frame of the Albanian National Forest Inventory'**, sqarojmë se: Duke qënë se agjencia e sapo krijuar nuk kishte në organikë ekspert GIS u vlerësua e domosdoshme nga projekti/ministria por dhe Banka Botërore të merrej një konsulent i jashtëm me eksperiencë për përgatitjen e hartave të IKPK.
3. Për procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-CQ-2 me objekt 'TA for drafting secondary legislation on forests** (after the adoption of the neë laë on forests): Ligji i ri i pyjeve u miratua në Prill 2020 ndërkohë që mendohej se do miratohej në një moment më të hershëm gjatë kohës së zbatimit të projektit. Për këtë arsye fondet e kësaj konsulence u rialokuan për aktivitete te tjera.
4. Në lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-IC-3 me objekt 'NFI Capacity Building In-depth training'**: Kontrata për NFI-in depth capacity building nuk ka qënë e planifikuar në fillim të projektit. Ky lloj trajnimi specifik ka dalë si domosdoshmëri në funksion të zbatimit të aktiviteteve të IKPK pasi strukturat teknike kishin nevojë për një përgatitje më të mirë dhe zgjerim njohurish në lidhje me praktikat më të mira dhe inovative në zbatimin e IKPK në përputhje me teknikat moderne.
5. Për procedurën e prokurimit me Ref. **ESP-CS-IC-3.1 me objekt 'IT Expert for NFI/NEA**: Pas diskutimeve teknike me ekspertë të kompanisë konsulente por edhe me ekspertët e Bankës Botërore u vlerësua e domosdoshme konsulenca e një eksperti të jashtëm lokal me profil IT&GIS për ngritjen e një aplikacioni i quajtur 'OpenForis' i cili do të shërbente për grumbullimin digjital të të dhënave nga sipërfaqet provë në terren, ruajtjen dhe me tej përpunimin e tyre. Kjo për faktin sepse ekspertja IT e AKM në përbërje të ekipit kyç te IKPK nuk mund te angazhohej me tej ne këtë proces për shkak të lejes së shtatzanisë.
6. Për procedurat e prokurimit me Ref. **ESP-CS-QCBS-4.1 dhe ESP-CS-QCBS-4.2 me objekt 'Supervision of registration of communal forests'**: Procesi i Supervizimit te Regjistrimit Fillestar te Pyjeve dhe Kullotave ka qene mjaft kompleks duke qënë se përfshiheshin disa aktore (përmendim këtu Ministrinë e Mjedisit në atë kohë, më vonë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ZRPP/ASHK, ZVRPP-te, AKZM si dhe bashkitë të cilët ishin administratoret e rinj të të gjithë sipërfaqes pyjore & kullosore, përveç atyre ne administrim nga AKZM). Në këtë kuptim, procesi ka qënë gjithëpërfshirës edhe në terma të konsultimit publik me palët e interesuara dhe grupet e interesit kanë marrë më shume kohe seç ka qënë parashikuar për këtë proces. Kjo ka sjelle vonesa te detyrueshme për vetë kompleksitetin që paraqiste i gjithë procesi si dhe identifikimi nga ana e Kontraktorit të regjistrimit fillestar të pasurive pyje dhe kullota (C. P.&D.) të sipërfaqeve pyje dhe kullota të patransferuara në pronësi të bashkive. Amendimet kane qene te nevojshme sepse përveç nevojës për te ngritur një sistem kontrolli gjysëm-automatik të produktit të regjistrimit i cili do t'u vinte në ndihme eksperteve të drejtorive rajonale të ZRPP/ASHK për kontrollin e produktit, kërkonte gjithashtu edhe rishikimin e listave te inventarit për pronat e transferuara. Pas punës paraprake te bere nga kontraktori i regjistrimit të pasurive pyje e kullota në pronësi të bashkive, u identifikuan sipërfaqe shtesë pyjore nga kryqëzimi
i të dhënave të hartave pyjore me të dhënat e fotografive ajrore 2015. Këto sipërfaqe shtesë duhej të përshiheshin në të dhënat e kadastrës pyjore kombëtare dhe të hartohej një liste e re inventari që do të përfshinte këto pasuri për transferim tek NJQV-te.
7. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me Ref. **ESP-CS-CQ-6 me objekt 'Consultant for Implementation of Gender Action Plan for one region'**: Planifikimi i konsulences për Planin Gjinor te Veprimit (Kontrata I) për një rajon është e lidhur ngushtësisht me ngritjen e kapaciteteve të Shoqatave të Perdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave kryesisht dhe fermerëve të cilët kishin interes për të aplikuar në skemën e granteve konkurruese IPARD-like. Për ketë arsye termat e referencës dhe kohëzgjatja e kësaj kontrate u përgatit në mënyrë qe te korrespondonte me fazën paraprake të përgatitjes së aplikimeve për thirrjen e pare të skemës konkurruese te granteve IPARD-like.\
8. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC- 8 me objekt 'National LAG Coordinator' nevoja për të kontraktuar National LAG Coordinator është evidentuar gjatë takimeve të stafit te ministrisë/projektit dhe të Bankës Botërore. Zbatimi i Strategjive Lokale te Zhvillimit të zhvilluara për Grupet Lokale Vendore, kërkonte impenjim të veçantë dhe si i tille u mundësua sigurimi i një konsulenti të tillë. Amendimi i kontratës me konsulentin është pare i
arsyeshëm, pasi është bërë edhe amendimi i termave të referencës për shërbimet e konsulencës. Shtesa e kontratës është realizuar për një afat 7 mujor me vlerën shtese prej 7,000 euro. Emërtimi i kontratës ka qene **Stakeholder Coordination, Monitoring and Support.**
9. Ne procedurën e prokurimit me Ref. **ESP-CS-QCBS-9 me objekt 'Supporting Development of Local Action Groups'**, kontrata nuk mund te zbatohej për një periudhe një-vjecare sepse përfshinte përveç gjithë punës përgatitore për ngritjen e Grupeve Lokale te Veprimit ne tre bashki, edhe përgatitjen e Strategjive Lokale te Zhvillimit për secilin. Vlen për t'u theksuar se lëvizje të tilla mes llogarive të projektit kanë qënë të lejuara për sa kohe balancimi i llogarive bëhej brenda periudhës 3 mujore të raportimit.

10. Në lidhje me procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-12 me objekt 'AlFIS planning, design and quality assurance", planifikimi fillestar i kostos për ndërtimin e sistemit ne Shumen 120,000 Euro ka qënë i përafërt dhe në kohën e fillimit të zbatimit të projektit janë diskutuar më në detaj termat e referencës së konsulencës, gjë që solli edhe rritjen e kostos. Kontrata ka pasur një amendament me qellim monitorimin e zhvillimit të sistemit nga konsorciumi i kontraktorëve te 'AlFIS Development'. Kjo është dakordësuar edhe me ekipin teknik të Bankës Botërore dhe është reflektuar në Dok.nr.12 -Raportin me reference AM_ISR_November 12-23, 2018, bashkëlidhur, paragrafi 6. Përsa i përket gjetjes për "pagese te dyfishte", konfirmojmë që nuk ka një të tillë sepse pagesa e kryer me date 10.08.2018 në vlerën 10,222.48 Euro, është kthyer mbrapsht nga banka me datë 22.08.2018. Me pas pagesa është ekzekutuar serish me datë 04.10.2018.

11. Në lidhje me procedurën e prokurimit të 'Consultant for creation of FPMP', ne fazën përgatitore te projektit ishte menduar te përgatiteshin plane menaxhimi për pyjet dhe kullotat komunale te cilat ishin pyje te ulet te transferuara kryesisht gjate vitit 2008 ne pronësi te ish komunave/bashkive. Me reformën institucionale te vitit 2016 ku pyjet dhe kullotat ne administrim nga Ministria e Mjedisit deri ne atë kohe i transferoheshin njësive te qeverisjes vendore, beri qe vendimi për plane te reja menaxhimi te shtrihej edhe ne sipërfaqet e reja pyjore (qe ishin kryesisht pyje te larte) te transferuara se fundmi tek bashkitë. Përfshirja e pyjeve te larte ne ketë proces do te ndryshonte disi objektin dhe rriste koston e parashikuar me herët për ketë konsulence ne planifikimin 18 mujor te realizuar ne vitin 2015. Shtimi i kostos konsiston ne shtimin e sipërfaqes qe do te mbulohej me planet e reja te menaxhimit për pyjet dhe kullotat ku ka ndikuar edhe shtimi i fondit grant te qeverise suedeze për ketë qellim. Amendimi i kontratës ne muajin Mars 2021 konsiston kryesisht ne ndryshimin e përqindjeve te pagesës me kërkesë te kontraktorit (bashkëlidhur) meqënëse puna e terrenit e përfunduar konsumoi burime te shumta financiare dhe miratimin e produktit përfundimtar nga grupi i punës ne ministri dhe drejtoria teknike ne bashkinë respektive.

12. Sa i përket procedurës se prokurimit me Ref. **ESP-CS-IC-3.1 me objekt 'IT expert for NFI/NEA'**, lidhet me angazhimin e projektit për sigurimin e kapaciteteve IT nëpërmjet ekspertit te jashtëm ne mënyre qe te kryhej konfigurimi i aplikacionit Open Foris për mbledhjen e te dhënave te terrenit gjate zbatimit te IKPK. Kjo do te lejonte interpretimin, analizën dhe raportimin. Për ketë arsye është kontraktuar eksperti B. K. dhe kjo konsulence nuk ishte planifikuar ne planin fillestar te prokurimit nen ketë aktivitet. Kontrata e punës se konsulentit ishte time-based me mesatarisht 8 dite pune ne muaj ngarkese e cila shpërndahej me shume ne disa muaj, sidomos ne muajt e pare te kontratës dhe me pak ne disa muaj te tjerë ne varësi kjo te nevojës për te ngritur dhe testuar aplikacionin Open Foris dhe për mbështetje me trajnim për stafin teknik te IKPK. Sa i përket kësteve te pagesës, duke qene kontrate time-based, janë kryer pas dorëzimit dhe verifikimit te timesheet-eve/raporteve te punës dhe faturave përkatëse nga konsulenti.

13. Sa i përket procedurës me **Ref. ESP-CS-IC-14.1 me objekt 'Consultant to prepare guidelines for MPs'**: Kontrata për udhëzuesin e planeve te reja te menaxhimit është planifikuar me vone ne kohe se 18 mujori I pare i zbatimit te projektit, dhe kjo kontrate është pjese e planit te prokurimit te hartuar ne vitin 2014 si dhe ne vijim. prokurimit te hartuar ne vitin 2014 si dhe ne vijim (Dok. nr.27 planet e prokurimit bashkëlidhur).

Pagesat e konsulentit janë bere me vonese ne afate ndryshe nga sa parashikonte kontrata fillestare duke qene se aktoret e interesuar ne ketë proces kane qene te shumte. Një arsye tjetër për vonesa ne pagese ka qene edhe ndërrimi i Sekretareve te Përgjithshëm ne Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Bazuar ne nenin 3 pika B te kontratës pagesat e konsulentit lidheshin me dorëzimin e raporteve/produkteve sipas fazave te zbatimit te kontratës. Raportet e konsulentit janë dorëzuar ne rregull dhe produkti final i tij qe është hartimi i manualit është pranuar, miratuar dhe zbatuar ne vijim nga agjencitë dhe institucionet përfituese te projektit.

14. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-SS-14.2 me objekt 'Individual Consultant for Interim F&P Database': Kontrata fillestare me konsulentin është nënshkruar me qëllimin qe t'i jepej support procesit te regjistrimit te pyjeve për njësite e qeverisjes vendore dhe te ngrihej një database e përkohshme për te trajnuar bashkitë ne procesin e digjitalizimit te ngastrave pyje e kullota ne administrim te tyre te cilat do te shërbenin si input për procesin e regjistrimit te pyjeve e kullotave bashkiake. Amendimi i kontratës është bere me qëllimin qe konsulenti te krijonte edhe aplikacionin për grumbullimin e te dhënave te terrenit për hartimin e planeve te reja te menaxhimit te pyjeve dhe kullotave. Ne lidhje me pagesat, ne vonese nga parashikimet e kontratës me konsulentin është ndikuar nga vonesat e krijuar ne ecurinë e punës se tyre nga stafi i bashkive por edhe atyre te AKZM ne popullimin e gjeodatabazes me informacionin digjital te kërkuar.

15. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-IC-17.1 me objekt 'Design of Forestry Measure as part of IPARD program'**: Nuk ka qene parashikuar fillimisht ne planin fillestar te projektit por u mendua qe kjo mbështetje t'i jepej qeverise pas pilotimit nëpërmjet projektit te dy thirrjeve te skemës se granteve konkurruese IPARD-like, duke e pare si mundësi përfitimi nga grantet e BE-se. Konsulenti është kontraktuar edhe për procedurën e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC 17 me objekt 'Upgrading IPARD structures and Albania Rural Development Agency's System for Accreditation of Measure in Forestry'. Konsulenca ne fjale ka një kontrate te nënshkruar ne

vlerën 37,200 EUR për te cilën janë paguar vetëm 27,900 EUR (përfshire Tatimin ne Burim) – 24,990 paguar konsulentit, pasi konsulenti arriti qe te dorëzonte produktin ne një kohe me te shkurtër dhe pa pasur nevoje te vije ne Shqipëri. Po i njëjti konsulent ka kryer dhe “Accreditation of Measure in Forestry” me vlere kontrate 37,200 EUR dhe paguar 27,900 EUR (përfshire Tatimin ne Burim) – 24,990 paguar konsulentit. Pra ne ketë rast nuk ka një overpayment.

16. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-CQ-18 me objekt ‘Development of ARDA MIS for management of grant applications’**: Ky aktivitet është përfshire ne planin e prokurimit menjëherë pas fillimit te projektit dhe diskutimit me stafin teknik te AZHBR për nevojat e përshtatjes se sistemit te tyre për te regjistruar dhe proceduar aplikimet ne funksion te skemës se granteve konkurruese IPARD-like. Pagesat e konsulentit janë kryer pas koordinimit me AZHBR për dorëzimin e produktit sipas kësteve te parashikuara ne kontrate. Kontrata është lidhur para se te hapej thirrja e granteve sepse kërkohej sistemi i përmirësuar ne kohen qe hapej thirrja dhe fillonte procesi i vlerësimit te aplikimeve. Sistemi me pas kishte edhe kohen e mirëmbajtjes qe zgjaste edhe gjate aplikimit te thirrjes se dyte për grante. Pagesa e fundit është vonuar ne kohe sepse ka qene një pagese e harruar nga konsulenti. Ne lidhje me konstatimin për lidhjen e amendamentit te kontratës me 5 muaj vonese sqarojmë se kontrata fillestare është lidhur me një afat 3 vjeçar për vlerën 49,700 Euro pa TVSH. Amendamenti mbulon një periudhe kohe 9 mujore, pas përfundimit te afatit te kontratës fillestare, me një kosto shtese prej 5,000 Euro pa TVSH. Ne amendamentin e kontratës, ne pjesën hyrëse te saj është përcaktuar se amendamenti lidhet ne datën 3 janar 2019, pra brenda fatit kohor te kontratës fillestare. Efektet e kontratës kane filluar ne datën 3 janar. Kontrata është protokolluar ne datën 16.05.2019. Protokollimi i kontratës ka qene me vonese, pasi eksperti megjithëse ishte dakortësuar për amendimin e kontratës nuk ndodhej ne Shqipëri ne atë periudhe dhe menjëherë sapo u paraqit u realizuar nënshkrimi nga ana e tij dhe protokollimi i saj.

17. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-IC-19 me objekt Environmental and Social safeguard consultant for revieëing grant applications**. Kostot e planifikuara ne fillim janë tejkaluar me amendimin e kontratës se konsulentit por edhe për arsyen e zgjatjes se periudhës se zbatimit te projektit.

18. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CQ-IC-18.1 me objekt ‘Scoping study for carbon payments’**: Kjo konsulence nuk ka qene planifikuar ne planin 18 mujor te prokurimit i përgatitur para fillimit te projektit. Qëllimi ka qene te zhvillohej ne një moment pas vitit te dyte te zbatimit te projektit. Kjo konsulence synonte studimin e tregut vullnetar te karbonit për te vlerësuar mundësinë e zhvillimit te një projekti te ri për sekuestrimin e karbonit.

19. Sa i përket procedurës se prokurimit me **Ref. ESP-CS-CQBS-22 me objekt ‘Conducting Hydrological Models & Bathymetric Measurements Ulza and Bovilla reservoirs’**: Kontrata është lidhur ne vitin 2017 për një periudhe 2 vjecare dhe pagesat e kësteve te kontratës kane qene me vone ne kohe se parashikimi sepse grupi i punës për monitorimin e kontratës kërkonte me shume kohe ne vlerësimin e produktit te konsulences. Konstatimi se ky aktivitet nuk është përfshire ne planin fillestar 18 mujor te prokurimit është i drejte. Ky aktivitet është përfshire ne planin e rishikuar te prokurimit qe i përket rishikimit te 3 ne Mars te 2016.

20. Procedura e prokurimit me **Ref. ESP-CS-CQ-23.1 me objekt ‘Costs and Benefits of current and alternative land uses for Ulza and Bovilla watersheds**’ ka pasur për qellim studimin e raportit kosto-përfitim për lloje te ndryshme te përdorimit te tokës ne sipërfaqet e synuara te projektit ne basenet e Ulzës dhe Botiles. Kontrata është lidhur me konsulentin me 01.04.2017 dhe ishte planifikuar te përfundonte ne 31.08.2017. Realisht ka përfunduar ne fillim te vitit 2018. Kontrata fillestare kishte kohëzgjatje 5 mujore dhe amendamenti pa kosto shtese ishte deri ne fillim te vitit 2018.

21. Për procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-CS-CQ-26 me objekt ‘Sediment Measurement and Monitoring Ulza’**. Burimi i e financimit, për ketë kontrate ka qene GEF dhe pagesa e kryer fillimisht nga IBRD është kthyer ne një moment te dyte.

22. Për procedurën me **Ref. ESP-G-ICB-2 me objekt ‘Purchase of vehicles’**: Ky aktivitet është parashikuar 400,000 Euro, por vlera e përftuar nga tenderimi rezultoi 300,000 euro, duke krijuar kursime ne fondet e projektit.

23. Për procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-G-SH-3 me objekt ‘Equipment for field staff NFI dhe FMP’**. Nga diskutimet teknike me konsulentët dhe stafin teknik te agjencive zbatuese kane dale nevoja shtese për plotësimin me pajisje kompjuterike dhe inovative për t’u përdorur gjate procesit.

24. Për procedurën me **Ref. ESP-TS-ICB-7 me objekt ‘AlFIS Software development and implementation and associated hardware** -Ky aktivitet është bashkimi i dy aktiviteteve ne planin fillestar te prokurimit: **Aktiviteti ESP-G-NCB-6**, qe i përkiste blerjes se hardware dhe aktiviteti **ESP-TS-G-7** qe i përkiste zhvillimit te Software. Pas diskutimeve me grupit e interesit dhe miratimin e Bankës u vendos qe te dyja aktivitet te prokuroheshin se bashku nen paketën **ESPTS-ICB-7** me procedure tender te hapur ndërkombëtar.

25. Për procedurat e prokurimit me **Ref. ESP-TS-ICB-8.1 dhe ESP-TS-ICB-8.2 me objekt ‘Registration of communal forest and pasture”** Procesi i regjistrimit te pyjeve dhe kullotave komunale ka qene shume kompleks

duke qe se përfshinte shume aktore. Kontrata e pare e regjistrimit kushtëzonte pagesat e kontraktorit me dorëzimin e produktit përfundimtar dhe miratimit te tij. Për ketë arsye pjesa me e madhe e pagesave te kontraktorit është kryer ne përfundim te projektit me miratimin e produktit te dorëzuar nga grupet e punës.

26. Ne lidhje me procedurën e prokurimit me **Ref. ESP-G-SH-10 me objekt 'IT equipment (ARDA, MoE, Inspectorate dhe PMT)**: Konstatimi se ky aktivitet nuk është përfshire ne planin fillestar 18 mujor te prokurimit është i drejte. Ky aktivitet është përfshire ne planin e rishikuar te prokurimit qe i përket rishikimit te 3 ne Mars te 2016.

- Ne lidhje me planet buxhetore vjetore iu bëjmë me dije se këto plane janë miratuar nga Banka Botërore dhe grupi drejtues/teknik i Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit ne përfundim te çdo misioni te Bankës ne Shqipëri ne lidhje me projektin. Këto plane mund t'i gjeni ne raportet e Bankës Botërore, bashkëlidhur. Pjese e takimeve gjate misioneve te Bankës dhe gjithashtu te vendimeve te marra kane qene edhe Grupi Drejtues/Teknik i Ministrisë (reference raportet AM bashkëlidhur, aneksi 'List of people met').

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet e dërguara nga ana e MTM në lidhje me procedurat e prokurimit dhe pas analizimit me kujdes të tyre konkludoi që, grupi i auditimit bën një përshkrim të të gjithë situatës dhe në këtë rast të procedurave të prokurimit dhe jo çdo gjë që shkruhet përbën shkelje (pasi bën dhe përshkrim të situatës). Në observacionin e dërguar keni bërë një përshkrim të procedurave të prokurimit ndërkohë që gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit kanë të bëjnë me menaxhimin jo të duhur të fondeve, ku mos realizimi në kohë i procedurave sipas planit fillestar, apo devijimi i lartë i tyre nga plani fillestar ka sjellë pasoja të tjera në shtyrjen në kohë të projektit, përballjen me faktorë të tjerë të jashtëm të paparashikuar dhe rritjen e kostove operacionale (ku për mbulimin e tyre janë alokuar nga fonde të zhvillimit të ndonjë komponenti tjetër apo procedure),

**Për sa më sipër observacioni i sjellë nuk merret në konsideratë.**

## 2.7 Çështje të tjera që mund të dalin gjatë procesit të auditimit.

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit nr. 346/1 Prot., datë 28.03.2024, *"Çështje të tjera që mund të dalin gjatë procesit të auditimit"* u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Projekti Shërbimet Mjedisore është një projekt i cili ka filluar pas miratimit të Ligjit nr. 151/2014 datë 6.11.2014 "*Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e shërbimeve mjedisore*" , Ligj nr. 152/2014 datë 6.11.2014 "*Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si agjenci zbatuese për Fondin Global të mjedisit, për projektin e shërbimeve mjedisore*" dhe Ligj nr. 64/2015 datë 11.6.2015 "*Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin suedez të besimit, për Fondin e Besimit nr. Tf072239, për projektin e shërbimeve mjedisore me Shqipërinë*".
Ky projekt ishte planifikuar të shtrihej në harkun kohor 30 Shtator 2014 - 30 Shtator 2019 por është shtyrë deri ne 30 Shtator 2021.
**Pjesa 2**, **Seksioni 1** i ligjit nr.151/2014 dhe ligjit nr.152/2014 tregon mënyrën e ekzekutimit dhe zbatimit të këtij projekti.

### A. Masat institucionale

Bazuar në ligjin e sipërcituar zbatimi i projektit duhej të bëhej mbështetur në këtë seksion dhe duke ngritur institucionet e mëposhtme:
1.Ekipi i Menaxhimit
2. Komiteti Drejtues i Projektit

3. Komiteti Teknik i Projektit

Përfituesi e zbaton projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit duke krijuar brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip Menaxhimi për Projektin brenda datës 30 Shtator 2014, ekip i cili nuk është funksional gjatë gjithë periudhës së zbatimit te projektit.

Ky ekip përbehej nga:

**-Menaxheri i Projektit** z. E. I., i cili ka lidhur kontratën me nr. 946 prot., datë 06.02.2015 dhe kontratë amendimi nr.1 me nr. 925 prot., datë 03.01.2019, kontratë amendimi nr.2 me nr.8749 prot., datë 16.10.2019, kontratë amendimi nr.3 me nr.6977 port., datë 30.09.2020 dhe kontratë amendimi nr.4 me nr . 3675 prot., datë 07.06.2021. Kjo kontratë është lidhur 5 muaj me vonesë nga sa parashikojnë ligjet nr. 151/2014 datë 6.11.2014 dhe 152/2014 datë 6.11.2014,

*Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*
*A. Masat institucionale.*
*Ekipi i Menaxhimit të Projektit Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka*

Gjithashtu kontrata që z. I. ka lidhur me Ministrinë e Mjedisit është lidhur në datën 06.02.2015 dhe përfundonte në datën 30.09.2019 por në datën 01.02.2019 është bërë amendim kontratë nr.1 dhe pagesa është rritur për 8 muajt e mbetur nga 168,000 lekë në 220,000 lekë. Ky amendim kontrate është bërë duke mos dhënë asnjë informacion apo arsye për rritjen e pagesës dhe pa përfunduar kontrata që është lidhur midis ministrisë dhe z. I.

**-Specialistja e prokurimeve** znj. B. B. ka lidhur kontratën me nr.10652 prot., në datën 05.11.2014 dhe kontratë amendimi nr.1 me nr. 946/1 prot., datë 06.02.2015, kontratë amendimi nr.2 me nr.6388 prot., datë 26.07.2018, kontratë amendimi nr.3 me nr.4217 port., datë 02.05.2019, kontratë amendimi nr.4 me nr . 8753 prot., datë 16.10.2019, kontratë amendimi nr.5 me nr . 6418 prot., datë 30.09.2020 dhe kontratë amendimi nr6. me nr . 3673 prot., datë 01.06.2021. Kjo kontratë është lidhur 1 muaj e 5 ditë me vonesë nga sa parashikojnë ligjet nr. 151/2014 datë 6.11.2014 dhe 152/2014 datë 6.11.2014.

*Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*
*A. Masat institucionale.*
*Ekipi i Menaxhimit të Projektit Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka…*

Gjithashtu amendim kontrata nr.1 që znj. B. ka lidhur me Ministrinë e Mjedisit në datën 06.02.2015 dhe përfundonte në datën 30.09.2019 është bërë një amendim nr.2 në datën 01.08.2018 deri në 30.04.2019 ku pagesa nga rrogë bazë fikse në lek ka kaluar në pagesë bazuar në ditë pune dhe një ditë punë është paguar me vlerën 180 euro. Amendimet e tjera të kontratës pas këtij amendimi kanë vazhduar me pagesë ditore 180 euro deri në amendim kontratën nr.6 që është lidhur për periudhën 01.06.2021 deri ne 30.09.2021 që është paguar me pagë fikse për këto 4 muaj. ( kalimi i pagesës për ditë pune dhe koha që znj. B. ka shpenzuar për këtë projekt nuk ka qenë e plotë si e ka kërkuar dhe *Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*)

**-Specialistja e financës** znj. D. Q. ka lidhur kontratën me nr.10651 prot., në datën 05.11.2014 dhe kontratë amendimi nr.1 me nr. 946/2 prot., datë 06.02.2015 deri në 30.09.2019.Kjo kontratë nuk ka përfunduar.

Kjo kontratë është lidhur 1 muaj e 5 ditë me vonesë nga sa parashikojnë ligjet nr. 151/2014 datë 6.11.2014 dhe 152/2014 datë 6.11.2014.

| |
|---|
| *Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*<br>*A. Masat institucionale.*<br>*Ekipi i Menaxhimit të Projektit Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka…* |

Në datën 26.01.2017 është lidhur kontrata nr. 589 prot., midis znj. H. F.i (Taga) dhe Ministrisë së Mjedisit deri në 30.09.2019. Kjo kontratë ka përfunduar përpara përfundimit të afatit.

Në datën 21.02.2019 është lidhur kontrata nr. 1939 prot., midis znj. K. Z. dhe Ministrisë së Mjedisit. Për këtë kontratë është bërë amendim kontrate nr.1 me nr. 8751 prot., në datën 16.10.2019, amendim kontrate nr.2 me nr. 6481 prot., datë 30.09.2020 dhe amendim kontrata nr.3 me nr. 3672 prot., datë 01.06.2021.

**-Eksperti i politikave mjedisore** z. E. N. ka lidhur kontratën me nr. 5017 prot., datë 14.08.2015 dhe kontratë amendimi nr.1 me nr. 923 prot., datë 31.01.2019, kontratë amendimi nr.2 me nr.8752 prot., datë 16.10.2019, kontratë amendimi nr.3 me nr.6482 port., datë 30.09.2020 dhe kontratë amendimi nr.4 me nr . 3671 prot., datë 01.06.2021.

Kjo kontratë është lidhur 11 muaj me vonesë nga sa parashikojnë ligjet nr. 151/2014 datë 6.11.2014 dhe 152/2014 datë 6.11.2014,

| |
|---|
| *Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*<br>*A. Masat institucionale.*<br>*Ekipi i Menaxhimit të Projektit Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka* |

Gjithashtu kontrata që z. N. ka lidhur me Ministrinë e Mjedisit është lidhur në datën 14.08.2015 dhe përfundonte në datën 30.09.2019 por në datën 31.01.2019 është bërë amendim kontratë nr.1 dhe pagesa është rritur për 8 muajt e mbetur nga 101,498.18 lekë në 180,000 lekë.

**-Specialist IT** znj. M. S. ka lidhur kontratën me nr. 8779 prot., datë 30.10.2018 dhe kontratë amendimi nr.1 me nr. 8754 prot., datë 16.10.2019, kontratë amendimi nr.2 me nr.6475 prot., datë 30.09.2020, kontratë amendimi nr.3 me nr.3668 port., datë 01.06.2021.

Kjo kontratë është lidhur 4 vjet e 1 muaj me vonesë nga sa parashikojnë ligjet nr. 151/2014 datë 6.11.2014 dhe 152/2014 datë 6.11.2014,

| |
|---|
| *Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*<br>*A. Masat institucionale.*<br>*Ekipi i Menaxhimit të Projektit Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka* |

**-Specialiste GIS/Pylltari** znj. V. S. ka lidhur kontratën me nr. 2697 prot., datë 22.04.2015 dhe kontratë amendimi nr.1 me nr. 924 prot., datë 31.01.2019, kontratë amendimi nr.2 me nr.8750 prot., datë 16.10.2019, kontratë amendimi nr.3 me nr.6479 port., datë 30.09.2020 dhe kontratë amendimi nr.4 me nr.3674 port., datë 01.06.2021.

Kjo kontratë është lidhur 7 muaj me vonesë nga sa parashikojnë ligjet nr. 151/2014 datë 6.11.2014 dhe 152/2014 datë 6.11.2014,

| |
|---|
| *Pjesa 2, Seksioni I. Masat Institucionale dhe të Zbatimit*<br>*A. Masat institucionale.* |

*Ekipi i Menaxhimit të Projektit Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, dhe jo më vonë se data 30 shtator 2014 krijon brenda Ministrisë së Mjedisit një Ekip për Menaxhimin e Projektit, i cili funksion dhe ruhet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë një Koordinator Projekti, me të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e pranueshme nga Banka*

Gjithashtu kontrata që znj. S. ka lidhur me Ministrinë e Mjedisit është lidhur në datën 22.04.2015 dhe përfundonte në datën 30.09.2019 por në datën 31.01.2019 është bërë amendim kontratë nr.1 dhe pagesa është rritur për 8 muajt e mbetur nga 140,000 lekë në 180,000 lekë.

**-Specialisti për Pagesa për Shërbimet Mjedisore** që është përcaktuar në projekt nuk është kontraktuar fare nga ana e përfituesit të projektit.

**-Komiteti Drejtues i Projektit**

Ministri i Mjedisit ka nxjerrë urdhrin nr. 1912 datë 19.09.2014 me anë të shkresës nr. 9386 prot., në datën 19.09.2014 për ngritjen e Komitetit Drejtues të Projektit.

Sipas këtij urdhri Komiteti Drejtues i Projektit përbëhej si mëposhtë:

| | |
|---|---|
| Ministri i Mjedisit | Kryetar |
| Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit | Anëtar |
| Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve | Anëtar |
| Drejtori i Projektit të Shërbimeve Mjedisore | Anëtar |
| Drejtori i Mbrojtjes dhe trajtimit të Pyjeve | Anëtar |
| Drejtori i Financës | Anëtar |
| Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit | Anëtar |
| Përfaqësues nga Departamenti i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj, Kryeministri | Anëtar |
| Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | Anëtar |
| Përfaqësues nga Ministria e Financave | Anëtar |
| Përfaqësues nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural | Anëtar |
| Përfaqësues nga Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme | Anëtar |
| Përfaqësues nga Komuna Maqellarë | Anëtar |
| Përfaqësues nga Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Bashkiakë | Anëtar |

Në datën 15.05.2018 me shkresën nr.4183 prot., ministri i Turizmit dhe Mjedisit z. B. K. ka nxjerrë urdhërin nr.179, datë 17.05.2018 për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues të Projektit Shërbimet Mjedisore. Sipas këtij urdhëri Komiteti Drejtues i Projektit të Shërbimeve Mjedisore përbëhej si mëposhtë:

1.Komiteti Drejtues i Projektit të Shërbimeve Mjedisore, kryesohej nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe përbëhej nga:

| | |
|---|---|
| Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit | Anëtar |
| Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Zhvillimit të Mjedisit | Anëtar |
| Drejtori i Projektit të Shërbimeve Mjedisore | Anëtar |
| Përgjegjësi i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave | Anëtar |
| Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar | Anëtar |
| Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit | Anëtar |
| Përfaqësues nga Departamenti i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj, Kryeministri | Anëtar |
| Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | Anëtar |
| Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Anëtar |
| Përfaqësues nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural | Anëtar |
| Përfaqësues nga Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme | Anëtar |

| | |
|---|---|
| Përfaqësues nga Bashkia Bulqizë | Anëtar |
| Përfaqësues nga Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Bashkiakë | Anëtar |

2.Komiteti Drejtues i Projektit është përgjegjës për:

a) sigurimin e koordinimit ndër-institucional;
b) sigurimin e mbikëqyrjes së përgjithshme të projektit, për politikat dhe drejtimin strategjik të tij;
c) aprovimin e planeve vjetore të zbatimit të buxheteve;
d) rishikimin e ecurisë së zbatimit të këtyre planeve dhe zgjidhjen e problemeve eventuale.

3.Komiteti Drejtues mblidhet të paktën një herë në vit në periudhën vijuese të zbatimit të projektit.

4.Urdhri nr.1912 port., datë 19.09.2014 "Për ngritjen dhe Funksionimin e Komitetit Drejtues të Projektit Shërbimet Mjedisore"

Urdhri nr.179 i nxjerrë në datën 17.05.2018 bie në kundërshtim me ligjin nr. 151/2014 dhe ligjin nr. 152/2014 konkretisht me pikën 2, gërma C, pjesa II, Ekzekutimi i Projektit, Seksioni I, Masat Institucionale dhe Zbatimit.

*Përfituesi merr masa që KDP-ja të takohet të paktën dy herë në vit dhe është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të Projektit, duke përfshirë, ndër të tjera: i) ofrimin e udhëzimeve strategjike dhe të politikave; ii) lehtësimin e koordinimit të aktiviteteve të Projektit dhe kryerjen e rekomandimeve për eliminimin e pengesave për zbatimin e Projektit; dhe iii) rishikimin e progresit të bërë për arritjen e objektivit të Projektit.*

Gjithashtu ky urdhër bie në kundërshtim me ligjin nr.151/2014 dhe ligjin nr.152/2014 ku i jep kompetencë Komitetit Drejtues të Projektit për aprovimin e planeve vjetore të zbatimit të buxheteve. Kjo kompetencë është e Komitetit Teknik të Projektit e përcaktuar në pikën 3, gërma A (ii), pjesa II, Ekzekutimi i Projektit, Seksioni I, Masat Institucionale dhe Zbatimit.

*ii) miratimin e Planit dhe Buxhetit Vjetor të Punës për transmetim të mëtejshëm te Banka;*

Gjithashtu grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokument që tregon kush janë pjesëtaret e Komitetit Drejtues të Projektit, procesverbalet e mbledhjeve që ky grup ka zhvilluar dhe vendimet që ka marrë për zbatimin e Projektit Shërbimet Mjedisore.

**-Komiteti Teknik i Projektit**

Përfituesi i projektit duhet të krijonte brenda datës 30 Shtator 2014 dhe të mbante në funksionim gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, Komitetin Teknik të Projektit të drejtuar nga Drejtuesi i Projektit dhe që përfshin një Koordinator Projekti, koordinatorë sipas komponentëve dhe staf teknik nga MM-ja dhe agjenci të tjera të përfshira në zbatimin e Projektit, me funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, duke përfshirë:

i) ofrimin e sigurimit të cilësisë për aspektet teknike të Projektit;
ii) miratimin e Planit dhe Buxhetit Vjetor të Punës për transmetim të mëtejshëm tek Banka;
iii) monitorimin e zbatimit të Projektit

Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion urdhëri për ngritjen e Komitetit Teknik të Projektit, anëtarët e Komitetit Teknik bashkë me ndryshimet që mund të kenë ndodhur gjatë implementimit të projektit ,mbledhjet që ky Komitet Teknik ka zhvilluar, vendimet e mara dhe raportet e monitorimit për zbatimin e Projektit.

Komiteti Teknik nuk është ngritur në bazë të dy ligjeve (ligjit nr. 151/2014 dhe ligjit nr.152/2014) që ky projekt ka funksionuar.

## B. Masat për Zbatimin

Për zbatimin e këtij projekti Përfituesi Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (Ekipi i Menaxhimit të Projektit) ka marrë masat duke përgatitur Manualet Operacionale të Projektit si mëposhtë:

Manuali Operacional i Granteve “Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve” miratuar në Prill 2016.
Manuali i Regjistrimit Fillestar të Pyjeve dhe Kullotave miratuar në datën 11.07.2017.
Manuali Operacional i Granteve “Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve” miratuar në Mars 2018.
Manuali Operacional për grantet LEADER (nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit)
Manuali i Regjistrimit Fillestar të Pyjeve dhe Kullotave në qarqet Kukës, Lezhë, Shkodër, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier , Tiranë dhe Vlorë miratuar në datën 12.05.2020.

**C. Plani dhe Buxheti Vjetor i Punës.**
Përfituesi i projektit në zbatim të këtij projekti me Ekipin e Menaxhimit dhe strukturat e tjera duhet të përgatiste planet dhe buxhetet vjetore të punës, konkretisht:
Specialistja e financës për PSHM duhet të përgatiste çdo vit një plan pune dhe një buxhet që përmbante të gjitha aktivitetet e propozuara për tu përfshirë në projekt dhe një projekt-plan financiar për shpenzimet e kërkuara për këto aktivitete, duke parashikuar shumat e propozuara dhe burimet e financimit. Ky plan pune duhet të kalohej për miratim tek Komiteti Teknik i Projektit dhe më pas tek Banka.
Grupi të auditimit nuk i është vendosur ne dispozicion asnjë plan pune apo miratim nga Komiteti Teknik.
Gjithashtu dhe specialistja e prokurimeve të PSHM duhet të përgatiste çdo vit një plan pune( prokurimesh) dhe buxhetet për çdo procedurë prokurimi të propozuar për tu përfshirë në projekt. Ky plan pune duhet të merrte miratimin nga Komiteti Teknik i Projektit.
Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion planet e prokurimit dhe miratimi nga Komiteti Teknik i Projektit për çdo vit që ka zgjatur projekti përveç planit 18 mujor që duhet të përgatitej në fillim të projektit.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ish Sekretarët e Përgjithshëm z. A. B., z. P. N. , z. A. K., Ekipi i Menaxhimit të Projektit z. E. I. , znj. B. B., znj. K. Z., znj. H. F., znj. D. Q., z. E. N., znj. V. S. , znj. M. S. .  Komiteti Drejtues i Projektit, Drejtuesit e Projektit dhe Komiteti Teknik i Projektit, në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin Shërbimet Mjedisore.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar në institucion me nr. 346/9, datë 01.11.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:*
**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur)**:.............. Projekti i Shërbimeve Mjedisore është bere efektiv dhe ka filluar zbatimin e tij ne date 29.01.2015. Dy specialistet e projektit qe ishin kusht për efektivitetin e projektit janë kontraktuar ne Nëntor 2014, ndërkohe qe ne lidhje me pjesën tjetër te stafit te menaxhimit te projektit, janë kontraktuar kur është vlerësuar e domosdoshme kjo e dakortësuar edhe gjate takimeve te shpeshta qe janë zhvilluar edhe me donatorin për zbatimin e aktiviteteve te projektit. Termat e referencës dhe periudha e kontraktimit te eksperteve te Ekipit te Menaxhimit te Projektit te Shërbimeve Mjedisore janë dakortësuar mes palëve dhe shtuar ne planin respektiv te përditësuar te prokurimit. Ne lidhje me amendimin e kontratave për tre pjesëtare te stafit te Projektit te Shërbimeve Mjedisore, respektivisht E. I. , V. S.  dhe E. N.: Shtesa e kontratave ne kosto është diskutuar dhe dakortësuar me donatorin. Nder arsyet kryesore përmendim: -Ngarkesa e shtuar dhe kompleksitetit i projektit duke qene se edhe reformat e kryera kishin impakt ne zbatimin e projektit;-Stafi ishte i ngarkuar edhe me monitorimin e zbatimit te projektit ‘Assisted Natural regeneration of degraded lands in Albania’;
Ne lidhje me amendimin e kontratës për Specialisten e Prokurimit B. B. me amendimin e kontratës nga kohe e plote ne kohe te pjesshme, është bere bazuar ne faktin qe specialistja e prokurimit ka dhëne dorëheqjen nga punësimi me kohe te plote, për arsye familjare. Duke pare dinamiken e projektit u pa e arsyeshme qe prokurueses B. B. ti ofrohej mundësia e punësimit me kohe te pjesshme, ne mënyre qe te mos vonoheshin procedurat e prokurimit ne proces.

Kontratat e stafit te PMT janë kontrata konsulente standarde te Bankës Botërore dhe realizojnë mundësinë e kontraktimit me kohe te pjesshme(me dite pune) ose me kohe te plote. Për sa me sipër është marre miratimi i Bankës Botërore.
Ne lidhje me specialistin për pagesa për shërbimet mjedisore: Ky specialist nuk u rekrutua sepse pagesat e shërbimeve ne mjedis nuk u aplikuan me projektin për arsye te mos angazhimit te UKT për ujëmbledhësin e Botiles apo edhe KURUM për ujëmbledhësin e Ulzës.
Komiteti Drejtues i projektit i ngritur fillimisht me urdhër te Ministrit te Mjedisit 1912 Prot. Date 19.09.2014 dhe me pas me Urdhër te Ministrit te Turizmit dhe Mjedisit 179 Prot. Date 17.05.2018 ka bere disa takime (ftesat dhe minutat e takimit te mbledhjeve te Komitetit Drejtues janë bashkëlidhur nen emërtimin ftesa dhe minutat e takimit te KD). Për arsye se projekti ka qene kompleks ne përbërje me aktivitete te ndryshme qe nuk kishin lidhje me njeri-tjetrin, takimet teknike janë organizuar me grupe/eksperte teknike ne përbërje te Komitetit Teknik te Projektit sipas fushës se ekspertizës. Gjithashtu periodikisht janë organizuar takime te përbashkëta te zgjeruara ne nivel teknik me ekspertet e fushës/anëtare te Komitetit Teknik te Projektit me ekspertet e Bankës Botërore.
Planet dhe buxhetet vjetore përgatiteshin nga PMT ne bashkëpunim me eksperte teknike sipas fushës dhe diskutoheshin për miratim ne takimet e përbashkëta me Bankën Botërore. Planet e punës reflektoheshin ne planin e përditësuar te prokurimit dhe gjithashtu ishin pjese e raporteve periodike te Bankës Botërore.
**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet e dërguara nga ana e MTM dhe pasi analizoi me kujdes argumentimin e gjetjeve të kryera nga grupi i auditimit, konkludoi që nuk janë sjellë fakte apo prova të tjera shtesë por vetëm arsyetim i tyre të cilat nuk përbëjnë ndryshim në gjetjet e kryera nga grupi i auditimit.

**Për sa mësipër observacioni nuk merret në konsideratë.**

***

Në zbatim të komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" të projektit "Shërbimet Mjedisore" u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Dokumentacioni i vendosur në dispozicion:
1. Projekti i Shërbimeve Mjedisore
2. Manuali Operacional i Granteve (MOG) "Masat për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve, kullotave dhe zonave rurale" Prill 2016
3. Manuali Operacional i Granteve (MOG) "Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve" Mars 2018.
4. Lista e aplikantëve fitues të granteve
5. Dosjet e aplikantëve sipas përzgjedhjes nga grupi i auditimit.

Projekti i Shërbimeve Mjedisore është zbatuar nga Ministria e Mjedisit (MM), dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) e Ministrisë së Bujqësisë.
MM ka qenë agjencia kryesore zbatuese dhe përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të Projektit.
Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është përgjegjëse për zbatimin e Komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural".

Roli kryesor i AZHBR është menaxhimi i buxhetit të caktuar për Komponentin "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" për këtë pjesë të financimit. Për zbatimin e komponentit të mësipërm, AZHBR duhet të caktonte një Koordinator Projekti të dedikuar për skemën e granteve të PSHM i cili duhet të përgatiste planet e punës, buxhetet dhe raportimet për të gjitha fazat e këtij komponenti bazuar në udhëzimet e nxjerra nga MM dhe dy manualet operacionale të granteve.

Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion urdhri i emërimit të Koordinatorit të Projektit pranë AZHBR dhe planet e punës, buxhetet dhe raportimet për dy fazat e zhvillimit të komponentit.
Për zbatimin e këtij komponenti AZHBR ka funksionuar në bazë të dy Manualeve Operacionale Grantesh përkatësisht , MOG "Masat për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve, kullotave dhe zonave rurale" Prill 2016 dhe MOG "Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve" Mars 2018, në të cilën janë të përcaktuara kushtet e përgjithshme dhe të veçanta që aplikantët pjesëmarrës duhet të plotësonin për të fituar të drejtën mbi marrjen e granteve, monitorimi dhe kontrollit i tyre deri në arritjen e objektivave dhe qëllimit të komponentit në fjalë.

**Thirrja e parë** e granteve është bërë në datën 01.06.2016 dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 01.08.2016. Kjo thirrje është bërë bazuar në MOG “Masat për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve, kullotave dhe zonave rurale”. Në këtë thirrje janë përzgjedhur 62 shoqata dhe individ fitues nga AZHBR nga të cilët 3 janë individ dhe 59 janë shoqata. Në thirrjen e parë janë zhvilluar 5 projekte pyllëzimi me një sipërfaqe totale 35.2 ha dhe 70,600 fidanë.

**Thirrja e dytë** është bërë në datën 20.06.2018 dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 10.09.2018. Kjo thirrje është bërë bazuar në MOG “Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve". Në këtë thirrje janë përzgjedhur 64 shoqata dhe individë fitues nga AZHBR nga të cilët 1 është individ dhe 63 janë shoqata. Në thirrjen e dytë janë zhvilluar 60 projekte pyllëzimi me sipërfaqe totale 395.9 ha dhe 602.172 fidanë.

Për analizimin dhe verifikimin mbi saktësinë dhe veprimet në përputhje me manualin, qëllimin dhe objektivat e projektit “Shërbimet Mjedisore”, grupi i auditimit bëri përzgjedhjen në bazë të riskut të dosjeve të aplikantëve, duke nxjerrë në pah problematikat, të përmbledhura dhe të listuara si më poshtë:

- Përzgjedhja e aplikantëve, në përmbushje të komponentit “Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural”, nga analizimi i dokumentacionit sjellë nga aplikantët, vihet re që në këtë komponent është vepruar si e ndarë nga projekti “Shërbimet Mjedisore”, pasi nuk ka një korrelacion midis zonave që kërkojnë ndërhyrje të caktuara nga komponentët e tjerë si dhe nuk ka një orientim për aplikantët mbi mbulimin e këtyre zonave të caktuara ashtu siç shprehet dhe në Projektin “Shërbimet Mjedisore” *(Investimet do të zbatohen nëpërmjet granteve konkurruese të cilat, nëpërmjet procesit të aplikimit dhe këshillimeve të ekstensionit, do të mbështesin kapacitetet e përmirësuara financiare dhe të planifikimit të biznesit. Në të njëjtën kohë zbatimi i PMPKK-ve dhe PMMK-ve do të ndihmojë trajtimin e çështjeve të rezistencës ndaj klimës nëpërmjet rritjes së aftësisë absorbuese të peizazhit, duke reduktuar erozionin dhe menaxhimit më të mirë të burimeve ujit, pyjeve dhe kullotave. Nëpërmjet pakësimit të erozionit dhe degradimit të tokës, produktiviteti i tokës do të përmirësohet dhe jetëgjatësia e infrastrukturës së ujit në drejtim të rrjedhës do të rritet dhe kostot e mirëmbajtjes së vazhdueshme do të reduktohen. Do të ngrihet kapaciteti institucional për të mbështetur komunat lokale, shoqatat e përdoruesve, AZHBR dhe për të ndërmarrë monitorim dhe raportim.)*
- Në dokumentacionin e sjellë nga aplikantët, në korrespondencën me Drejtoritë pyjore të zonave respektive dhe strukturave përkatëse në MM, nuk jepen të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të zonave në të cilën do kryhet ndërhyrja, duke caktuar dhe impaktin që ka ajo zonë, por fokusohet vetëm në miratimin që shoqata mbulon atë zonë.

- Gjatë analizimit të dosjeve të aplikantëve vihet re përzgjedhja e aplikantëve të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, krijimi i shoqatave është në një kohë të afërt me aplikimin për thirrjen e parë ose të dytë të projektit, veprime në kundërshtim me kërkesën MOG pasi këto shoqata janë krijuar rishtas dhe nuk kanë asnjë aktivitet të ngjashëm më parë duke mos plotësuar pikën 2.5 të MOG *Kriteret specifike të pranueshmërisë*.

*Shoqata vërteton me dokumentacion që ajo ka kryer aktivitete të ngjashme më parë.*

  - A. D. – Sh. P. dhe K. "Q." P.
  - E. M. – Sh. e P. dhe K. "A. "
  - A. B. – Sh. A.
  - I. H. – Sh. P. P. K. "Gj." M. - K.
  - B. T. – Sh. P. P. dhe K. K.
  - A. S. – Sh. P. P. dhe K. K. V.
- Në dokumentacionin e sjellë nga aplikantët, në projektin e dërguar, nuk jepen informacione të detajuara në lidhje me vlerën e projektit dhe se si është arritur në atë vlerë. Gjithashtu nuk tregohet roli që do kenë anëtarët e shoqatës, angazhimi i tyre dhe se si do mbulohet pjesa prej 15% e financimit të projektit nga shoqatat dhe 40% për individët, pjesë të cilën nuk e mbulon granti. (nga vjen burimi i financimit të 15% apo 40% të vlerës së projektit, si përkthehet në zë apo natyrë).
- Në dokumentacionin e dërguar nga aplikantët pjesëmarrës dhe fitues, nuk jepen detaje se si do arrihet finalizimi i projektit. Sa do të jetë fuqia punëtore e angazhuar për kryerjen e projektit, cila do të jetë infrastruktura e nevojshme, pagesat për kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Kjo pjesë gjithashtu nuk dokumentohet as në momentin e kërkesës për financim, në të cilën nuk ka asnjë dokumentacion mbështetës (faturë shoqëruese, listë pagesa), por vetëm fatura për blerjen e fidanëve ose mjeteve bujqësore të cilat nuk përbëjnë as 10% të financimit të kërkuar. Edhe në rastet kur është deklaruar lista e anëtarëve të angazhuar, nuk janë shoqëruar me listë pagesa, si dhe nuk është kryer asnjë verifikim nga AZHBR dhe MM, që këto persona të deklaruar si anëtarë të shoqatës për përfitimin e këtij granti janë angazhuar për realizimin e tij, gjë që e bën të vështirë verifikimin e personave që janë angazhuar në këtë projekt në qoftë se janë apo jo anëtarë pasi është kusht në MOG pika 2.4

*Shoqata përfituese nuk mund të nënkontraktojë asnjë pjesë të punimeve pyjore/kullosore për të cilat ka përfituar grant, tek ndonjë kompani apo individë të tjerë që nuk janë anëtarë të shoqatës.*

Kjo situatë është konstatuar dhe në zërat e dërguara për mbulimin me financim ku ka një mospërputhje midis numrit të punonjësve dhe ditëve të angazhuara, si më poshtë:

**Kontrata e Grantit me nr. ID: 01/1/07/0049** PSHM1 e përzgjedhur nga fituesit e thirrjes së parë është lidhur në datën 21.11.2017 me nr. 3015/1 prot., midis Sh. P. B. N. K. P. P. me Nipt K........P dhe AZHBR. Kjo kontratë është në vlerën e 5,578,120.83 lekë nga të cilat 85% e vlerës do të financohet nga granti. Afati i përfundimit të punimeve është 9 muaj duke filluar nga dita e parë pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga të gjithë palët.

Në datën 15.01.2018 kryetari i shoqatës i është drejtuar me shkresën nr.1 prot., AZHBR me kërkesën për pagesë duke përfunduar punimet 5 muaj e 7 ditë përpara afatit përfundimtar që është në kontratë. Nga shuma e kërkuar për rimbursim në vlerën 5,578,120 lekë AZHBR ka miratuar shpenzime të pranueshme vlerën 5,372,574 lekë. Kërkesa dhe pagesa për këtë subjekt është bërë në kundërshtim me MOG pika 2.10 Kushtet e pagesës ku për shoqatat përfituese procedura e pagesës do të jetë në dy këste.

Nga faturat e dorëzuara për rimbursimin e vlerës 5,578,120.83 lekë në masën e 85% grupi i auditimit konstatoi se të 4 preventivët dhe faturat e dorëzuara nga përfituesi për parcelat që do të kryente punime nuk janë sqaruar me detaje punimet që Sh. P. B. N. K. P. P. do të kryente. Në

preventive nuk janë vendosur numri i punonjësve që kanë marrë pjesë dhe ditët e punës për secilin punëtor. Ditët e punës të vendosura në 4 preventivët janë si mëposhtë:

| Parcela | Përshkrimi i punës | Volumi i punimeve në m2 | Norma ditore m2 | Ditët e punës |
|---|---|---|---|---|
| 1d /231/5b | Rrallim pyje në dushk duke hequr 15-25% të numrit të drurëve. | 377,000 | 300 | 1256.67 |
| 2c /231/5b | | 219,000 | 250 | 876 |
| 6e /231/5b | | 150,000 | 280 | 535 |
| 46a/ 231/5b | | 131,000 | 250 | 524 |
| **TOTALI** | | | | **3191.67** |

Ky projekt është zhvilluar nga data 22.11.2017 deri ne 15.01.2018 dhe kryetari i shoqatës për këtë projekt ka nxjerrë ne preventiv 3191.67 ditë pune. Në listën e personave që kanë marrë pjesë janë 70 persona por ajo listë nuk jep detaje se sa ditë ka punuar secili prej tyre dhe mënyrën si është bërë pagesa për këta persona.
Nga llogaritja e anëtarëve që Sh. P. B. N. K. P. P. ka deklaruar për periudhën që janë bërë punimet ditët e punës nuk përkojnë me faturat e dorëzuar dhe preventivin. Në përllogaritjen e ditëve të punës për muaj janë vendosur 26 ditë duke llogaritur pushim vetëm ditën e dielë.

| Nr punonjësve | Ditët e punës për muaj | Totali i ditëve në muaj | Muaji |
|---|---|---|---|
| 70 | 7 | 490 | Nëntor 2017 |
| 70 | 26 | 1820 | Dhjetor 2017 |
| 70 | 12 | 840 | Janar 2018 |
| **TOTALI** | | **3150 ditë pune** | |

Diferenca midis faturave të dorëzuar dhe ditëve të punëve të përllogaritur në bazë të anëtarëve që kjo shoqëri ka deklaruar është 3191.67-3150=41 ditë pune. Kjo përllogaritje është bërë duke vendosur të gjithë personat që kjo shoqatë ka dorëzuar si persona që janë marrë me këtë projekt për të gjithë kohën që ky projekt ka zgjatur. Diferenca prej 41(ditë pune)x1700 leke (për ditë pune)= 69,700 lekë është e pa justifikuar.
Gjithashtu kjo shoqatë nuk ka dorëzuar një listë të anëtarëve të saj pasi e ka detyrim që punimet do të kryhen nga anëtarët e shoqatës pasi kryerja e punimeve nga persona që nuk janë pjesë e shoqatës është ne kundërshtim me pikën 2.4 Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë për investimet të MOG.
----
**Kontrata e Grantit me nr. ID: 01/2/07/0109** e përzgjedhur nga fituesit e thirrjes së parë "Zhvillimi dhe mbrojtja e pyjeve, kullotave dhe zonave të larta rurale" është lidhur në datën 06.11.2017 me nr. 2857/1 prot., midis AZHBR dhe përfituesit të grantit me vlerë 6,627,284 lekë individit z. Dh. T. . Kjo kontratë ka pas një afat 9 mujor për kryerjen e këtyre shërbimeve. Në datën 12.01.2018 me nr. 118/1 prot., është bërë amendimi i kontratës duke përfshire në kontratë TVSH në masën e vlerës së preventivave në shumën prej 1,095,480 lekë. Totali i shpenzimeve të pranueshme të investimit është përllogaritur në vlerën 6,920,880 lekë.
Lloji i investimit për këtë kontratë është përmirësim i pyjeve duke përfshirë: Pasurimin e të mbjellave pyllëzimin, pastrimin, rrallim, rincugim, krasitje, ndërhyrje sanitare.
Për zbatimin e kësaj kontrate individi përfitues z. Dh. T. ka nënkontraktuar shoqërinë 6 Korriku në datën 01.11.2017.
Në datën 12.04.2018 individi përfitues ka bërë kërkesë për pagesë.

Nga faturat e dorëzuara për rimbursimin e vlerës 6,920,880 lekë në masën e 60% grupi i auditimit konstatoi se të tre preventivët dhe faturat e dorëzuara nga përfituesi për parcelat që do të kryente punime nuk janë sqaruar me detaje punimet që shoqëria 6 Korriku do të kryente.
Nga shuma e kërkuar për rimbursim në vlerën 6,920,880 lekë AZHBR ka miratuar shpenzime të pranueshme vlerën 6,487,040 lekë. Në preventive nuk janë vendosur numri i punonjësve që kanë marrë pjesë. Kjo shoqëri nga vërtetmi për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesit lëshuar në datën 23.04.2018 figuron me punonjës si mëposhtë:
Në muajin Nëntor 2017, Dhjetor 2017 dhe Janar 2018 kjo shoqëri ka vetëm 2 punonjës. Në muajin Shkurt 2018 kjo shoqëri ka 7 punonjës dhe ne muajin Mars 2018 kjo shoqëri ka 6 punonjës.
Nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në kërkesën për pagesë kanë kaluar 5 muaj e 6 ditë. Ditët e punës të vendosura në preventive dhe ne faturat e dorëzuara janë si mëposhtë:

| **Parcela** | **Përshkrimi i punës** | **Volumi i punimeve në m2** | **Norma ditore m2** | **Ditët e punës.** |
|---|---|---|---|---|
| Nr.35/231/5b | Rrallim pyje në dushk duke hequr 15-25% të numrit të drurëve. | 500.000 | 300 | 1666 |
| Nr.36/231/5b | | 367.000 | 300 | 1223 |
| Nr.37/231/5b | | 100.000 | 300 | 333 |
| **TOTALI** | | | | **3222** |

Nga llogaritja e punonjësve që shoqëria 6 Korriku ka deklaruar për periudhën që janë bërë punimet ditët e punës nuk përkojnë me faturat e dorëzuar dhe preventivin. Në përllogaritjen e ditëve të punës për muaj janë vendosur 26 ditë duke llogaritur pushim vetëm ditën e dielë.

| Nr punonjësve | Ditët e punës për muaj | Totali i ditëve në muaj | Muaji |
|---|---|---|---|
| 2 | 21 | 42 | Nëntor 2017 |
| 2 | 26 | 52 | Dhjetor 2017 |
| 2 | 26 | 52 | Janar 2018 |
| 7 | 20 | 140 | Shkurt 2018 |
| 6 | 26 | 156 | Mars 2018 |
| 6 | 10 | 60 | Prill 2018 |
| **TOTALI** | | **502 ditë pune** | |

Në preventive dhe në faturë pagesa për ditë pune është 1700 lekë. Nga përllogaritja del se periudhën Nëntor 2017- Prill 2018 kanë punuar vetëm 502 ditë pune dhe vlera për këto ditë pune është 502x1700 lekë = 853,400 lekë. Ndërkohe janë dorëzuar fatura për 3222 ditë pune me vlerë 3222x1700 lekë = 5,477,400 lekë. Diferenca midis faturave të dorëzuar dhe ditëve të punëve të përllogaritur në bazë të punonjësve që shoqëria 6 Korriku ka deklaruar është 5,477,400-853,400= 4,624,000 lekë.
----
**Kontrata e Grantit me nr. ID: 02/1/02/0018 PSHM2** e përzgjedhur nga fituesit e thirrjes së dytë është lidhur në datën 24.11.2020 me nr. 3526/1 prot., midis Shoqatës "E. L. " me Nipt L........Q dhe AZHBR. Kjo kontratë është në vlerën e 6,976,692 lekë nga të cilat 85% e vlerës do të financohet nga granti. Afati i përfundimit të punimeve është data 01.03.2021. Shoqata "E. L. " është regjistruar në datën 18.05.2018.
Në datën 24.02.2021 kryetari i shoqatës i është drejtuar me shkresën nr.3 prot., AZHBR me kërkesën për pagesë. Kërkesa dhe pagesa për këtë subjekt është bërë në kundërshtim me MOG pika 2.10 Kushtet e pagesës ku për shoqatat përfituese procedura e pagesës do të jetë në dy këste.
Nga faturat e dorëzuara për rimbursimin e vlerës 6,976,692 lekë në masën e 85% grupi i auditimit konstatoi se të 3 preventivët dhe faturat e dorëzuara nga përfituesi për parcelat që do të kryente punime nuk janë sqaruar me detaje punimet që Shoqata "E. L. " do të kryente. Në preventive nuk

janë vendosur numri i punonjësve që kanë marrë pjesë dhe ditët e punës për secilin punëtor. Ditët e punës të vendosura në 3 preventivët janë si mëposhtë:

| Parcela | Përshkrimi i punës | Volumi i punimeve | Norma ditore | Ditët e punës. |
|---|---|---|---|---|
| 1246/232-11 | Krasitje pishash me moshë mbi 10-vjecare dhe grumbullim mbetjesh në breza e togje | 70936 | 50 | 1418,7 |
| 2533/232-11 | | 91706 | 50 | 1834.1 |
| 1246/232-11 | | 609.96 | 50 | 609.96 |
| **TOTALI** | | | | **3862.76** |

Nga llogaritja e anëtarëve që shoqëria “E. L. ” ka deklaruar për periudhën që janë bërë punimet ditët e punës nuk përkojnë me faturat e dorëzuar dhe preventivin. Në përllogaritjen e ditëve të punës për muaj janë vendosur 26 ditë duke llogaritur pushim vetëm ditën e dielë.

| Nr punonjësve | Ditët e punës për muaj | Totali i ditëve në muaj | Muaji |
|---|---|---|---|
| 39 | 7 | 273 | Nëntor 2020 |
| 39 | 26 | 1014 | Dhjetor 2020 |
| 39 | 26 | 1014 | Janar 2021 |
| 39 | 21 | 819 | Shkurt 2021 |
| **TOTALI** | | **3120 ditë pune** | |

Ky projekt është zhvilluar nga data 24.11.2020 deri ne 23.02.2021 dhe kryetari i shoqatës për këtë projekt ka nxjerrë ne preventiv 3862.76 ditë pune. Nga dokumentacioni i aplikimit kjo shoqatë ka 39 anëtare, por nuk është vendosur në dispozicion numri i personave që kanë marrë pjesë dhe as ditët që secili prej tyre ka punuar.
Në preventive dhe në faturë pagesa për ditë pune është 1700 lekë. Nga përllogaritja del se periudhën Nëntor 2020- Shkurt 2021 kanë punuar vetëm 3120 ditë pune duke llogaritur të gjithë anëtarët që kjo shoqëri ka dorëzuar në listën e aplikimit dhe ditët e punës për muaj janë vendosur 26 ditë duke llogaritur pushim vetëm ditën e dielë. Vlera për këto ditë pune është 3120x1700 lekë = 5,304,000 lekë. Ndërkohe janë dorëzuar fatura për 3862.76 ditë pune me vlerë 3862.76x1700 lekë = 6,566,692 lekë. Diferenca midis faturave të dorëzuar dhe ditëve të punëve të përllogaritur në bazë të anëtarëve që kjo shoqëri ka deklaruar kur ka bërë aplikimin dhe jo në fatura apo preventiv është 6,566,692-5,304,000= 1,262,692 lekë. Kjo vlerë është e pa justifikuar.
----
**Kontrata e Grantit me nr. ID: 02/1/07/0042 PSHM2** e përzgjedhur nga fituesit e thirrjes së dytë është lidhur në datën 30.08.2019 me nr. 623/5 prot., midis Sh. A. me Nipt L........L përfaqësuar nga kryetari z. A. B. dhe AZHBR. Kjo kontratë është në vlerën e 5,387,185 lekë nga të cilat 85% e vlerës do të financohet nga granti. Afati i përfundimit të punimeve është data 07.05.2020. Sh. A. është regjistruar në datën 04.07.2018 dhe aplikimi për grant është bërë në datën 07.09.2018 vetëm 2 muaj pasi kjo shoqatë është regjistruar dhe nuk ka pasur asnjë aktivitet të ngjashëm më parë duke mos plotësuar pikën 2.5 të MOG *Kriteret specifike të pranueshmërisë.*
Në datën 21.01.2020 kryetari i shoqatës i është drejtuar me shkresën nr.1 prot., AZHBR me kërkesën për pagesë duke përfunduar punimet 3 muaj përpara afatit përfundimtar që është në kontratë. Kërkesa dhe pagesa për këtë subjekt është bërë në kundërshtim me MOG pika 2.10 Kushtet e pagesës ku për shoqatat përfituese procedura e pagesës do të jetë deri në dy këste.
Nga faturat e dorëzuara për rimbursimin e vlerës 5,387,185 lekë në masën e 85% grupi i auditimit konstatoi se në preventivin dhe 3 faturat e dorëzuara nga përfituesi për parcelën që do të kryente punime nuk janë sqaruar me detaje punimet që Sh. A. do të kryente. Në preventive nuk janë

vendosur numri i punonjësve që kanë marrë pjesë dhe ditët e punës për secilin punëtor. Ditët e punës të vendosura në preventivë janë si mëposhtë:

| **Shenja e manualit** | **Përshkrimi i punës** | **Volumi i punimeve** | **Norma ditore** | **Ditët e punës.** | **Pagesa për ditë pune** |
|---|---|---|---|---|---|
| 253/1 | Prerje shkuresh etj 11-30% | 10 ha | 0.15 ha | 66.6 | 1600 |
| 222/1 | Përgatitje piketash | 6250 copë | 1000 | 6.25 | 1300 |
| 222/3 | Piketim gropash (2 punëtorë) | 6250 copë | 500 | 12.5 | 1500 |
| 222/4 | Hapje gropa 80x80x80 cm | 6250 copë | 4 | 1562.5 | 1700 |
| 228/12 | Transport fid.plepi 2 vjeçar pa toke | 6250 copë | 1000 | 6.25 | 1600 |
| 223/11 | Mbjellje plepi në gropa 80x80x80 com | 6250 copë | 25 | 250 | 1700 |
| **TOTALI** | | | | **1904.1** | |

**Për sa më sipër** nga shkeljet e gjetura grupi i auditimit konstaton se përzgjedhja e këtij projekti fitues është bërë në kundërshtim me MOG pasi kjo shoqatë është krijuar rishtas dhe nuk ka asnjë aktivitet të ngjashëm më parë duke mos plotësuar pikën 2.5 të MOG *Kriteret specifike të pranueshmërisë.*

*Shoqata vërteton me dokumentacion që ajo ka kryer aktivitete të ngjashme më parë.*

Në lidhje me shpenzimet për zërin hapje gropa 80x80x80 cm në shtrat lumi është zëri që zë vlerën më të lartë në preventive dhe faturë. Për këtë zë janë paguar 1562.5 ditë pune me 1700 lekë në total 2,656,250 lekë. Gjithashtu vendosja e normës ditore 4 gropa në ditë është shumë i ulët dhe numri i ditëve të punëve është shumë i lartë duke sjellë fryrje të zërit dhe përdorimin e fondit. Ditët e punës gjithashtu nuk përkojnë me afatin e realizimit të këtij projekti nga shoqëria A. .

Nëse bëhet një përllogaritje që për hapjen e gropave kjo shoqëri të ketë caktuar të 10 anëtaret meshkuj që kjo shoqëri ka për të gjithë ditët që ky projekt ka zgjatur. Në përllogaritjen e ditëve të punës për muaj janë vendosur 26 ditë duke llogaritur pushim vetëm ditën e dielë.

| Nr punonjësve | Ditët e punës për muaj | Totali i ditëve në muaj | Muaji |
|---|---|---|---|
| 10 | 26 | 260 | Shtator 2019 |
| 10 | 26 | 260 | Tetor 2019 |
| 10 | 26 | 260 | Nëntor 2019 |
| 10 | 26 | 260 | Dhjetor 2019 |
| 10 | 18 | 180 | Janar 2020 |
| **TOTALI** | | **1220 ditë pune** | |

Totali i ditëve të punës të përllogaritur është 1220 ditë pune.

Ndërkohe ky projekt nga kjo shoqëri ka zgjatur nga data 1 Shtator 2019 deri në 21 Janar 2020 ose (140 ditë pune) dhe Sh. A. ka deklaruar 1562.5 ditë pune.

Diferenca midis ditëve të punës që kjo shoqatë ka sjellë në faturë dhe preventiv është 1562.5-1220= 342.5 ditë.

Vlera në lekë e pa justifikuar për këto ditë është 342.5 ditë x1700 lekë=582,250 lekë. E theksojmë që kjo përllogaritje është bërë (pa llogaritur zërat e tjerë si pastrimi, përgatitja e piketave dhe piketimi) faza të cilat janë kryesorë të ndodhin përpara hapjes së gropave dhe që ju duhen disa ditë punë.

----

**A. D. – Sh. P. dhe K. "Q." P.**

Aplikanti i ka paraqitur dosjen me dokumentacionin mbështetës të aplikimit me nr. 1742, datë 01.08.2016.
Projekt për përmirësimin e pyjeve.
Referuar kontratës financimi mbulon 85% të vlerës së saj ose një vlerë maksimale prej 3,951,990 lekë. Afati për zbatimin e projektit është 3 muaj. Pagesa për shoqatat do të bëhen me dy këste 30-40% e shumës do të kryhet pas kryerjes së punimeve përgatitore.

| Përshkrimi | Njësia matëse | Volumi | Norma ditore | Ditë pune | Paga p/ditë | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Laku i halës (12) 14.7 ha | M2 | 147,000 | 250 | 588 | 1700 | 999,600 |
| Laku i halës (13a) 15 ha | M2 | 150,000 | 250 | 600 | 1700 | 1,020.000 |
| Lgata e mizës (14a) 21 ha | M2 | 210,000 | 250 | 600 | 1700 | 1,426,000 |
| Qafa e Ligatës | M2 | 116,000 | 250 | 464 | 1700 | 788,800 |
| Motosharrë e lehtë | copë | 1 | | | | 50,000 |
| Sopata | copë | 6 | | | | 3,000 |
| Këmesa | copë | 20 | | | | 10,000 |
| Kosto projektuesi | | | | | | 140,000 |
| Kosto e drejtuesit Teknik | | | | | | 210,000 |
| **Shuma** | | | | | | **4,649,400** |

Objektivi i projektit të propozuar: "Nisur nga nevoja e ndërhyrjes ne këtë grumbull pyjor gjendja fitosanitare, lidhja social ekonomike që kanë përdoruesit e pyjeve me këto pyje dhe prodhimet që rrjedhin prej tyre. Ky aplikim ka si objektiv të përgjithshëm, që nëpërmjet ndërhyrjeve përmirësuese të tipit rrallime në dushqe të bëhet e mundur shëndetësimi i grumbullit pyjor dhe përfitimi i një sasie të konsiderueshme dru zjarri për furnizimin e popullsisë. Filizëria qe do të mbetet pas rrallimeve të ketë hapësire drite të bollshme me qëllim që të rritet aftësia vegjetuese dhe për pasojë dhe kapaciteti prodhues në korrelacion me kapacitetin prodhues potencial që ka lloji dhe mjedisi ekologjik ku vegjeton.
Ana e dytë e këtij objektivi është krijimi i koncepteve të reja tek komuniteti për domosdoshmërinë e rritjes së përgjegjësisë për ti shërbyer këtyre pyjeve, duke qenë se këto të fundit të ofrojnë të gjitha të mirat material e shpirtërore"
Pas përfundimit të projektit me kërkesën nr. 4, datë 11.12.2017 drejtuesi i projektit ka paraqitur kërkesën bashkëlidhur dokumentacioni.
Pas verifikimit në terren dhe raportit të përgatitur shuma e pranuar si shpenzime projekti është 4,022,000 leke dhe është mbuluar 3,418,700 lekë.
Nga verifikimi i listë pagesave rezulton se:
Tetor 2017 të punësuar 9 punonjës me 4 ditë punë secili në total pagesa bruto 33,536 lekë
Nëntor 2017 të punësuar 9 punonjës me 26 ditë punë secili total pagesa bruto 218,000 lekë
Dhjetor 2017 të punësuar 9 punonjës me 18 dite pune por projekti ka vetëm 6 ditë pune ne dhjetor, pagesa e kryer 158,613 lekë.
Bashkëlidhur është edhe një listë e shkruar me dorë nga drejtuesi i shoqatës por nuk faktohet pagesa ndaj tyre.
Nga auditimi konstatohet se bashkëlidhur dokumentacionit nuk gjendet faturë e kryerjes së shërbimit të projektimit dhe drejtimit teknik sipas kontratave të lidhura në dokumentacionin e aplikimit.
Nuk ka dokumentacion në lidhje me pagesat e kryerja ndaj punonjësve të angazhuar, listë pagesë.
· **Kontrata e Grantit me nr. ID: 02/1/09/0038 PSHM2** e përzgjedhur nga fituesit e thirrjes së dytë është lidhur në datën 19.09.2019 me nr. 206/5 prot., midis Shoqatës "Gj. " M. me Nipt L........H dhe AZHBR. Kjo kontratë është në vlerën e 2,610,540 lekë nga të cilat 85% e vlerës do të financohet nga granti. Afati i përfundimit të punimeve është data 07.05.2020. Sh. P. P. K. "Gj." M. - K. është krijuar në datën 08.03.2018 dhe regjistruar në datën 18.04.2018. Grupi i auditimit

konstatoi se aplikimi është bërë vetëm 4 muaj e 20 ditë pasi kjo shoqatë është regjistruar dhe nuk ka pasur asnjë aktivitet të ngjashëm më parë duke mos plotësuar pikën 2.5 të MOG *Kriteret specifike të pranueshmërisë.*

Nga auditimi i dokumentacionit të aplikimit të dorëzuar nga Sh. P. P. K. “Gj.” M. - K. AZHBR ka bërë shkresën nr. 3707/1 prot., datë 20.11.2018 ku ka kërkuar dokumentacion shtesë në lidhje me vendimin e Bordit të Shoqatës për personat e përzgjedhur që janë firmat kundërfirmosëse tek vendimi i bankës. Në datën 24.11.2018 kryetari i shoqatës z. I. H. i ka dërguar AZHBR dokumentacionin shtesë duke vendosur në dispozicion vendimin nr.3 prot,., datë 16.12.2018 të Bordit të Shoqatës. Sipas këtij vendimi anëtarët e bordit kanë vendosur të zgjedhin firmë të parë Kryetarin e Shoqatës z. I. H. dhe firmë e dytë znj. M. N. (sekretare shoqatës) Ky vendim është marrë nga z. I. H. znj. M. N., z. H. T., z. L. N. dhe znj. Sh. M. . Grupi i auditimit konstatoi se në mbledhjen e bordit të kësaj shoqatë anëtarët e bordit përveç kryetarit të shoqatës nuk janë anëtarë të Sh. P. P. K. “Gj.” M. - K. kjo bazuar në listën e anëtarëve të dorëzuar nga kjo shoqatë në dosjen e aplikimit. Në listën e anëtarëve të dorëzuar janë 32 anëtarë nga të cilët 47% janë femra dhe 53% janë meshkuj. Në këtë listë asnjë nga emrat e mësipërm nuk është anëtar i Sh. P. P. K. “Gj.” M. - K..

Në datën 06.02.2020 kryetari i shoqatës i është drejtuar me shkresën nr.1 prot., AZHBR me kërkesën për pagesë duke përfunduar punimet 3 muaj përpara afatit përfundimtar që është në kontratë.

Nga faturat e dorëzuara për rimbursimin e vlerës 2,610,540 lekë në masën e 85% grupi i auditimit konstatoi se të dy preventivët dhe fatura e dorëzuara nga përfituesi për parcelat që do të kryente punime nuk janë sqaruar me detaje punimet që Sh. P. P. K. “Gj.” M. - K. do të kryente. Në preventive nuk janë vendosur numri i punonjësve që kanë marrë pjesë. Ditët e punës të vendosura në dy preventivët janë si mëposhtë:

| **Parcela** | **Përshkrimi i punës** | **Volumi i punimeve në m2** | **Norma ditore m2** | **Ditët e punës.** |
|---|---|---|---|---|
| 254/5 | Korrje ose prerje bimësh të dëmshme ose helmuse | 110,700 | 1500 | 73.8 |
| | | 30,900 | 1500 | 20.6 |
| 255/3 | Grubullim gurrësh të vegjël me grabashke | 369,000 | 300 | 1230 |
| | | 103,000 | 300 | 343 |
| **TOTALI** | | | | **1667.4** |

Në dokumentacionin e dorëzuar për kërkesën e pagesës Shoqata “Gj. ” ka dorëzuar edhe listën e personave që kanë marrë pjesë për zërin e punimeve përmirësim kullote. Në këtë listë janë 21 persona nga të cilët 20 nuk janë anëtarë të kësaj shoqate bazuar në listën e anëtarëve të shoqatës që është dorëzuar në dosjen e aplikimit. Gjithashtu në faturën që është dorëzuar nuk jepen detaje se sa persona janë përfshirë dhe sa ditë pune për secilin punonjës as mënyra e pagesës së këtyre personave. Kryerja e punimeve nga persona që nuk janë pjesë e shoqatës është ne kundërshtim me pikën 2.4 Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë.

Gjithashtu grupit të auditimit i lind dyshimi i arsyeshëm se fatura dhe preventive janë fiktiv pasi vendosja e një numri kaq të madh ditësh në preventivë, personat e përfshirë nuk vërtetohen që janë anëtare të shoqatës dhe përfundimi i projektit 3 muaj përpara afatit të kontratës kur kjo shoqatë është krijuar rishtas dhe nuk ka asnjë aktivitet të ngjashëm apo eksperiencë.

Kryerja e punimeve nga persona që nuk janë pjesë e shoqatës është ne kundërshtim me pikën 2.4 Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë për investimet të MOG “Masa për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve” Mars 2018

*Shoqata përfituese nuk mund të nënkontraktojë asnjë pjesë të punimeve pyjore/kullosore për të cilat ka përfituar grant, tek ndonjë kompani apo individë të tjerë që nuk janë anëtarë të shoqatës.*

- Nga analizimi i dosjeve të përzgjedhura nga grupi i auditimit, u konstatua përzgjedhja e një shoqate fituese të Grantit, ku Kryetari i shoqatës rezultonte debitorë pranë AZHBR, në kundërshtim me Kriterin 3.2 “Koherenca dhe Përshtatshmëria” dhe 3.11 “Lista e Debitorëve” (në rast se aplikanti ekziston në këtë listë të debitorit, kërkesa deklarohet e papranueshme për financim) MOG 2016.
  Sh. B. N. Xh. me përfaqësues ligjor z. Xh. D., me adresë Njësia Administrative Lis- Bashkia Mat, Fshati Gjalish, Mallunxë. Nr. Nipt i shoqatës K.......G, data e themelimit 10/05/2000 dhe me datë regjistrimit 14.10.2004.
  Me anë të Vendimit Nr. 74/1 datë 25.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, u ndryshua emërtimi i shoqatës në “Sh. B. N. “Xh”” Qendra Administrative Lis-Mat. Me datë 11.12.2017 me shkresën nr. 3204, me lëndë Njoftim për miratimin e aplikimit, njoftohet që aplikimi me ID 01/1/02/0039 me nr. 1746 Prot. është vlerësuar i pranueshëm për tu mbështetur. Total i shumës së aprovuar përmes kontributit publik është 4,957,800 lekë, nga të cilat 4,214,130 lekë përfaqësojnë 85% të kontributit nga Projekti i Bankës Botërore, ndërsa 743,670 lekë përfaqësojnë 15% të bashkëfinancimit nga kontributi privat i përfituesit të grantit.
  Me datë 18.01.2018 me shkresën nr. 169 Prot., Drejtori i DAP kërkon informacion në lidhje me debitorët pranë drejtorisë së Financës, ku z. Xh. D. rezulton debitor ndaj AZHBR-së me një shumë prej 2,943,370 lekë.
  Bazuar në manual, aplikimi i mësipërm duhej të deklarohej i papranueshëm për financim, por AZHBR ka vijuar me përzgjedhjen për financim të kësaj shoqate dhe ka lejuar që të kryhet ndryshimi i Kryetarit të Shoqatës dhe që të vijojë me financimin e kësaj shoqate.
- Në dosjet e audituara për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve, u analizua dokumentacioni i dërguar nga aplikantët fitues si dhe u verifikuan parcelat ku do të implementohej projekti në bazë të koordinatave të dhëna në projekt. Verifikimi u krye nga imazhe satelitore të marra nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ASIG, ku në bazë të kërkimit nga koordinatat e dhëna, rezultuan këto parcela të papyllëzuara, si më poshtë:
  - E. M. – Sh. P. dhe K. “A.”
  - Xh. D. – Sh. B. N. Xh.
  - B. T. – Sh. P. P. K. K.
  - E. V. – Sh. P. P. K. S.
  - L. M. – Sh. Sh. P. K. U. K. Gj.
  - Xh. H. – Sh. P. P. K. H.

  Gjithashtu në fund të projekteve të pyllëzimit nuk është marrë asnjë hap mbi regjistrimin e këtyre zonave pyjore (sipas projektit), si një ndër qëllimet kryesore të zhvillimit të projektit “Shërbimet Mjedisore”.
- AZHBR për zbatimin e Komponentit “Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural” duhet të kryente dhe raportim, analizë risku dhe monitorim pas përfundimit të granteve të shpërndara për projektet fituese nga individët dhe shoqata.
  Përfituesit e projektit në kontratat e nënshkruara me AZHBR ne nenin 8 dhe në MOG pika 3.19 e kanë të përcaktuar që përfituesit janë të detyruar për të menaxhuar investimet për 3 vjet pas marrjes së pagesave. Në rast gjatë verifikimit në terren konstatohet se përfituesit nuk janë duke kryer mirëmbajtjen e kërkuar (prashitjen, krasitjen, heqjen e barërave të këqija, mbrojtjen nga kullotja, etj.), përfituesi do të duhet të kthejë fondet e marra. Përfituesit e ndëshkuar do të regjistrohen në listën e debitorit të AZHBR-së..
  Gjithashtu pika 3.9 e MOG parashikon që pas vitit të tretë të përfundimit të investimit për të dy thirrjet e këtij projektit, duke filluar nga momenti i kërkesës për pagesë, një numër i investimeve (të paktën 10%) duhet të monitorohej nga AZHBR me një ekip kontrollorësh të përbërë nga

specialistë të dyja institucioneve (MM dhe AZHBR) në mënyrë që të verifikohet gjendja e investimit. Përzgjedhja e investimeve objekt monitorimi, do të bëhet bazuar në procedurën e analizës së riskut. Gjetjet e këtij monitorimi do ti raportohen AZHBR dhe MM me shkresë zyrtare nga zyrtari i raportimeve në AZHBR.
Bazuar në përshkrimin e detyrave të punës si dhe bazuar në strukturën organizative të AZHBR, Drejtoria e Kontrollit (DK) merr kërkesën për përgatitjen e planit të kontrolleve ex-post nga Drejtoria e Autorizimit të Pagesave brenda datës 10 Janar të çdo viti. DK duhet të caktonte stafin që do të angazhohej për analizën e riskut dhe pas nënshkrimit prej specialistëve, dërgohet për miratim dhe brenda datës 10 Shkurt i përcillet DAP.
**Për sa më sipër** grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë plan pune, analizë risku, auditim apo raport monitorimi të zhvilluara për subjektet fituese, veprime të cilat janë shkak pasoje e gjetjeve të mësipërme.
Mos realizmi i planeve të punës, analizës së riskut , auditimeve dhe raporteve të monitorimit ka sjellë shkelje të MOG dhe nenit 8 të kontratave që AZHBR ka lidhur me përfituesit e granteve. Gjithashtu mos raportimit pranë Ministrisë së Mjedisit nga Zyrtari Raportues pranë AZHBR është në shkelje me pikën 3.9 të MOG dhe çon në mos realizmin me sukses të komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" që i është besuar kësaj Agjencie nga Ministria e Mjedisit për projektin Shërbimet Mjedisore.

· Grupi i auditimit konstaton se të gjitha pagesat për shoqatat janë bërë me një këst në mospërputhje me MOG konkretisht pika 2.10 Kushtet e pagesës ku sipas manualit proçedura e pagesës do të jetë deri në dy këste, e konkretisht:

*30% - 40% e shumës së rimbursueshme do të paguhet pas kryerjes së punimeve përgatitore.*
*Pjesa e mbetur prej 60%-70% do të paguhet pas përfundimit të investimit, dorëzimit të faturave, verifikimit në terren dhe certifikimit të gjitha punimeve.*

si dhe në kundërshtim me Pikën 3.3 Neni 3 të Kontratave të lidhura midis palëve.
Pagesa me dy këste do të rriste shkallën e monitorim dhe kontrollit si dhe shmangien e abuzimeve që në fazën e parë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme Ekipi i Menaxhimit të Projektit z. E. I., z. E. N., Komiteti Drejtues i Projektit, Drejtuesit e Projektit, Komiteti Teknik i Projektit, në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin Shërbimet Mjedisore dhe Manualet MOG 2016 dhe 2018.
Gjithashtu ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përzgjedhjes dhe e Miratimit të Projekteve E. D. , M. D. , Drejtoria e Kontrollit dhe sektorët përkatës I. P., Drejtoria e Autorizimit të Pagesave D. H., E. S., Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave E. Sh., J. Sh. sipas periudhës të implementimit të këtij komponenti (2016 deri më sot), në mospërputhje me Ligjin 151,152/2014 për projektin "Shërbimet Mjedisore", Manualet MOG 2016 dhe 2018 dhe Ligjin Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural".
AZHBR ka përgjegjësinë e vendosjes në dispozicion të këtij akti, të gjithë personave të përfshirë në strukturat e mësipërme si dhe në zbatimin e këtij komponenti të projektit.

*Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, protokolluar në institucion me nr. 346/10, datë 26.11.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:*
**Pretendimi i subjektit (i përmbledhur)**: *Referuar gjetjes 1/6*: Përzgjedhja sipas funksioneve të ndara, përcaktuar edhe në Manualin operacional, fq 24 rrjedhja e procedurave të aplikimit është në funksion dhe përgjegjësi vetëm e DPAP-së. Vepruar si i ndarë-Komponenti 2 në Manualin dhe Marrëveshjen e Kredisë është përcaktuar për tu zbatuar nga AZHBR, sipas rregullave të skenave të IPARD, ku funksionet dhe përgjegjësitë e çdo drejtorie në AZHBR janë

të ndara. AZHBR ka marrë nga MM dhe Projekti 2 inspektorë teknik (Ministria) dhe një ekspert mjedisor ( Projekti). Kjo përcaktohet në Manualin Operacional, paragrafi fundit i faqes 25. Në çdo dosje fituesit të shpalluar nga DPAP gjeni firmat dhe raportet teknike të 3 ekspertëve (Y., A., E.)
Gjendja ekzistuese e zonave ku do të ndërhyhet, parashikohet në planin e menaxhimit 10 vjeçar te miratuar nga Bashkia dhe Ministria e Mjedisit.
*Referuar gjetjes 2/7*: Eksperienca e mëparshme e shoqatave, është kriter pikëzimi por jo përjashtimi. Manuali operacional përcakton që merr më shumë pikë për eksperienca të mëparëshme por jo s'kualifikohet. Shik faq 16 të Manualit pika 2,11 Kriteret e pikëzimit dhe të renditjes për shoqata përfituese ku për plotësimin e kriterit "A ka zbatuar shoqata aktivitete të ngashme" aplikanti merr 15 pikë pra është e qartë që plotësimi i këtij kriteri përcakton renditjen e aplikantit në bazë të pikëzimit por jo skualifikimin e aplikantit.
*Referuar gjetjes 3/8*: Informacionet lidhur me vlerën e projektit jepen në planin e menaxhimit të miratuar si dhe në preventivat zërat e të cilave janë të parashikuar në Manualin e pyjeve miratuar në vitin 1985. Shoqatat janë jo fitim prurëse dhe kontributi i tyre 15% është kontribut në natyrë si psh: ruajtje, gardhime me elemente natyral etj. Referuar Manualit operacional Aneksi 3 Burimet e parashikuara të financimit dhe përmbledhja e totalit të përllogaritur të shpenzimeve për shoqatat ku vetëm përcaktohet vlera 15% kontribut privat. Fuqia punëtore e angazhuar, deklarimi nuk është kërkesë ligjore kur dorëzon kërkesën për pagesë. Referuar Manualit operacional Aneksi 34 Kërkesa për Pagesë ( Lista e dokumentave që kërkohet). Nuk janë shoqëruar me listë pagesën si dhe nuk është kryer asnjë verifikim nga AZHBR dhe MM, nuk janë detyrim ligjor. Marrja e punëtorëve në mungesë të anëtarësisë së shoqatës nuk përbën shkelje konkrete.
*Referuar gjetjes 4/1*: Sa i përket përdorimit të imazheve satelitore, vlerësohet se janë gjerësisht të përdorura dhe shumë të vlefshme në menaxhimin e pyjeve por kanë edhe kufizime në përdorim: duke mos pasur rezolucion të lartë, ka raste që e bëjnë të vështirë identifikimin e sipërfaqeve të reja të mbjella me fidanë pyjor sidomos për ato lloje të cilat kanë rritje të ngadaltë (psh. pisha). Kufizimi tjetër i përdorimit të imazheve janë edhe kushtet atmosferike (p.sh. në mot me re të dhënat e përftuara janë të limituara).
Projektet e pyllëzimit janë zbatuar në zona pyjore të degraduara ku rigjenerimi natyror nuk mund të ndodhte për shkak të nivelit të lartë të degradimit/erozionit në këto sipërfaqe pyjore. Regjistrimi i pronave të tipit pyje e kullota bashkiake është kryer nëpërmjet një aktiviteti tjetër po më mbështetjen e projektit të Shërbimeve Mjedisore.
*Referuar gjetjes 5/5*: Ka lejuar që të kryhet ndryshimi i Kryetarit të Shoqatës. Komuniteti, njësia administrative Lis nuk ka asnjë arsye ligjore të penalizohet sepse kryetari i zgjedhur është debitor në vitet 1998. DPAP ka lidhur kontratën vetëm pas miratimit nga Banka Botërore me email dhe Bashkia/ njësia administrative, ku anëtarët e shoqatës ri zgjodhën kryetarin e ri.
*Referuar Gjetjes 6/6:* Bazuar në "Manualin e Procedurës së Sektorit të Monitorimit të Skemave", rregullave të përcaktuara për funksionin e Sektorit si njësia brenda Drejtorisë së Kontrollit në AZHBR, vihet në lëvizje pasi Drejtori i Kontrollit merr kërkesën nga Drejtoria e Autorizimit të Pagesave për përgatitjen e planit të kontrolleve ex-post brenda datës 10 Janar të çdo vitit. DAP është përgjegjës për sigurimin e çdo informacioni tjetër të nevojshëm për përgatitjen e planit. Drejtori i Kontrollit cakton stafin që do të angazhohet me analizën e riskut dhe ky dokument i nënshkruar prej personave të caktuar prej tij, dërgohet për miratim brenda 10 Shkurt në DAP.
Referuar Manualit Operacional të Grantit, pika 3.9.1. "Mënyra e operimit gjatë përgatitjes së analizës së risqeve", sikundër cituar nga ju, lista duhet të përgatitet nga Drejtoria e Autorizimit të Pagesave.
Sipas dokumentacionit që administron Sektori i Monitorimit të Skemave nuk rezulton asnjë shkresë e përcjellë, me listën e përfituesve për të dy thirrjet, mbi Projektin "Shërbimet Mjedisore", nga Drejtoria e Autorizimit të Pagesa dhe/apo Drejtori tjetër brenda AZHBR, në mënyrë që të lindë detyrimi për kryerjen e kontrolleve ex-post nga Sektori i Monitorimit të Skemave, sipas Manualit të Procedurës.
Sikundër citohet në gjetjen e tuaj, ekipi i kontrollorëve për të verifikuar gjendjen e investimit duhet të jetë i përbërë nga AZHBR dhe MM. Caktimi i përbërjes së grupit, nga ana e AZHBR, nuk është detyrë funksionale e Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të Skemave por sikundër ju e keni konstatuar.
*Referuar Gjetjes 7/7*: Kushtet e pagesës ku sipas manualit procedura e pagesës do të jenë deri në dy këste. Pagesa me dy këste është si një mundësi që i është dhënë shoqatave por jo detyrim. Në këstin e parë do të përfshiheshin rimbursim i faturave të blerjeve ndërsa investimi parashikohet një i plotë. Kjo pikë është e zbatueshme vetëm nëse shoqata paraqit kërkesën për pagesë.
**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit mori në shqyrtim observacionet e dërguara nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural vendosi:
Për observacionet e gjetjes 1/6 pas shqyrtimit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi Komponenti "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" nuk është një komponent i ndarë nga Projekti Shërbimet Mjedisore por një komponent i cili ishte në ndihmë të projektit dhe do të menaxhohej nga AZHBR për dhënien e grandeve IPARD.

Për observacionet e gjetjes 2/7 pas shqyrtimit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi nga dosjet e përzgjedhura për auditim një numër i konsiderueshëm shoqatash përfituese janë krijuar rishtas dhe nuk kanë asnjë aktivitet të ngjashëm më parë ky është një fakt dhe kjo ka sjellë që këto shoqata nga auditimi i dosjeve të kenë problematika në preventive, listën e anëtarëve të punimeve, mbarimin e punëve shume muaj përpara afatit etj.
Për observacionet e gjetjes 3/8 pas shqyrtimit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi preventivat e dorëzuar në dosjet e aplikuesve fitues nuk janë të sakta ka mos përputhje të numrit të ditëve të vendosura në preventiv dhe numrit të ditëve që këta përfitues kanë realizuar projektet kjo duke sjellë edhe vlera të konsiderueshme të pa justifikuara. Gjithashtu dorëzimi i listës së anëtarëve është kusht pasi duhet të plotësohen disa nga kriteret që janë vendosur në MOG dhe kryerja e punimeve nga shoqëri/individë që nuk janë anëtarë të shoqatave është në mospërputhje me MOG pasi punimet duhet të kryen nga anëtarët e shoqatave kjo është e shënuar qartë dhe është si kush vetëm për përfituesit që janë shoqata dhe jo për përfituesit individë.
Për observacionet e gjetjes 4/1 pas shqyrtimit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi auditimi është zhvilluar në muajt Qershor-Gusht 2024 kohe që ka kaluar 5 vite nga mbyllja e thirrjes numër 2 ku është bërë dhe pyllëzimi dhe fidanët e bimëve të mbjella nuk janë më fidanë por janë rritur. Gjithashtu nga marrja e imazheve satelitore në muajt e mësipërm që është zhvilluar auditimi nuk ka pasur probleme atmosferike si ju i keni përmendur ( mot me re dhe që të dhënat e përfituara të jenë të limituara).
Për observacionet e gjetjes 5/5 pas shqyrtimit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi përzgjedhja e shoqatës "Sh. B. N. Xh." shoqatë që mban edhe emrin dhe mbiemrin e kryetarit të saj z. Xh. D. është përzgjedhur në kundërshtim me manualin pasi ky individ rezulton debitor.
Për observacionet e gjetjes 6/6 pas shqyrtimit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi nga auditimi rezultoi se nuk është bërë asnjë monitorim pas kryerjes së investimit nga shoqatat dhe individët fitues. Kjo në mospërputhje me kontratat që AZHBR ka firmosur me përfituesit dhe MOG që ky komponent ka funksionuar.
Për observacionet e gjetjes 7/7 pas shqyrtimit të observacionit u vendos që observacioni nuk merret në konsideratë pasi të gjitha pagesave janë kryer me një këst duke sjellë që nuk është ndjekur MOG konkretisht pika 2.10 Kushtet e pagesës *30% - 40% e shumës së rimbursueshme do të paguhet pas kryerjes së punimeve përgatitore. Pjesa e mbetur prej 60%-70% do të paguhet pas përfundimit të investimit, dorëzimit të faturave, verifikimit në terren dhe certifikimit të gjitha punimeve* si dhe në kundërshtim me Pikën 3.3 Neni 3 të Kontratave të lidhura midis palëve. Kontrata midis AZHBR dhe përfituesve të granteve e ka të mirë paracaktuar në nenin 3 pikën 3.3. që pagesa duhet të bëhet ne dy këste duke mos lënë hapësirë për kryerjen e pagesës në 1 këst. Pagesa me dy këste do të rriste shkallën e monitorim dhe kontrollit si dhe shmangien e abuzimeve që në fazën e parë.

## IV. REKOMANDIME

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetja nga auditimi**: Nga tabela e disbursimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit, për disbursimet deri në 28 Maj 2021, vihet re që deri në përfundimin e afatit të përfundimit të projektit të shërbimeve mjedisore 30 Shtator 2019, nuk është disbursuar as gjysma e totalit të financimit të projektit, që do të thotë një nga shkaqet kryesore të ristrukturimeve është mospërdorimi në kohë i burimeve të financimit dhe devijimi nga plani fillestar i realizimit të projektit.
Projekti i është nënshtruar dy ristrukturimeve të cilat sipas Raportit Final të hartuar nga Banka Botërore kanë lindur si kërkesë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dokumentacion që nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, për të analizuar shkaqet dhe arsyet mbi ristrukturimin e tyre.
Gjithashtu, nga ristrukturimi i projektit janë rritur dhe kostot operacionale, duke bërë të mundur alokimin e kostove të planifikuara për zhvillimin e komponentëve të projektit për kostot operacionale të burimeve njerëzore, si dhe të shtyrjeve të afateve të realizimit të kontratave të tjera të konsulencës.
Gjatë viteve 2020 dhe 2021, pra pas afatit ligjor të përfundimit të projektit janë disbursuar 11.86 milion USD fonde, të cilat përbëjnë 57% të të gjithë fondeve të vënë në dispozicion për 4 vitet e jetës së tij (2015-2019).

Për sa më sipër, nuk është vepruar në përputhje me nenin 3 “Projekti” Ligji nr. 151/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore”, si dhe nenin 2 “Projekti” të Ligjit nr. 152/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin Shërbimet Mjedisore”, pasi huamarrësi ka deklaruar angazhimin e tij për përmbushjen e objektivave të Projektit dhe ka garantuar realizimin e projektit në përputhje me dispozitat e parashikuara në Marrëveshje.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 24-31 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë shkaqet e shtyrjes në kohë të zbatimit të Projektit duke evidentuar problematikat e lindura gjatë ristrukturimeve të projektit, si dhe si ka ndikuar në arritjen e objektivave të tij, duke bërë që në të ardhmen të mos përsëriten fenomene të tilla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetja nga auditimi**: Në lidhje me kontratën midis Ministrisë së Mjedisit dhe znj. B. B., në cilësinë e specialistes së prokurimeve për projektin dhe si person përgjegjës për realizimin e tyre, nuk jepen shpjegimet përkatëse në lidhje me ndryshimet e kushteve të kontratës, kryesisht nga kalimi me kohë të plotë në punësim me kohë të pjesshme. Përpos këtij ndryshimi vlera e pagesave ka ndryshuar, pasi në këtë rast pagesat kanë qenë 180 euro/ditë pune, pagesa të cilat për disa ditë pune mbulojnë pagesën e një muaji të plotë sipas kontratës me kohë të plotë. Gjithashtu, në amendimet e kontratave të saj, datat e cituara nuk janë në përputhje me kontratën kryesore dhe me amendimet e tjera. Kalimi i kontratës me kohë të pjesshme bie ndesh dhe me përcaktimet ligjore në fillim të projektit pasi rëndësia e pjesëmarrjes në Grupin e Menaxhimit të Projektit është e lartë. Për sa më sipër, është në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 10652 prot., datë 05.11.2014.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë në shqyrtim rastin e mësipërm duke nxjerrë të gjitha përgjegjësit, rolin dhe angazhimet e znj. B. B., si dhe në të ardhmen të marrë në konsideratë që të mos kryejë praktika apo ndryshime të kushteve të kontratës në mënyrë të njëanshme me efekte negative në zbatimin e projekteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetja nga auditimi**: Procedurat e prokurimit janë planifikuar në Shkurt të vitit 2015 (në fillim të nisjes së realizimit të projektit) për 18 muajt e parë, në të cilën janë të detajuara duke përfshirë Referencën, objektin, kostot e përllogaritura, burimin e financimit, prioritetin, datën e zhvillimit, kohëzgjatjen e zbatimit.
Planet vjetore të prokurimeve dhe planet e punës të pas kësaj periudhe nuk i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të grupit të auditimit.
Zhvillimi i procedurave të prokurimit nuk është kryer sipas planit të parë 18 mujor, duke mos respektuar hierarkinë e përzgjedhjes së tyre sipas prioritarizimit, sipas datës së planifikuar dhe sipas kostos së përllogaritur, si dhe për ndryshimet e pësuara më pas nuk ka dokumentacion në lidhje me arsyetimet përkatëse, duke u bërë dhe faktor kryesor në zgjatjen e realizimit të projektit dhe shtyrjen ne kohë të përfitimeve nga projekti, pra duke ulur efektivitetin e tij.
Për sa më sipër, nuk është në përputhje me nenin 5 “Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat”, Pjesa 2, Pika C Ligji nr. 151/2014 , si dhe nenin 6 “Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat”, Pjesa 2, Pika C Ligji nr. 152/2014. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 36-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë shkaqet e devijimit nga plani fillestar 18 mujor i procedurave të prokurimit, duke evidentuar dhe problematikat e lindura gjatë këtyre devijimeve dhe si ka ndikuar në arritjen e objektivave të tij, duke bërë që në të ardhmen të mos përsëriten fenomene të tilla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetja nga auditimi**: Në disa prej procedurave të prokurimit të realizuara ka tejkalim të afateve të përcaktuara në planifikimin e procedurave të prokurimit, për të cilët duke qenë se janë dhe kontrata konsulence, nga grupi i auditimit nuk mund të përcaktohet shkaku apo dhe efekti që kanë shkaktuar këto vonesa në zbatimin e kontratave. Gjithashtu në kontratat e audituara nga grupi i auditimit nuk cilësohen penalitetet në lidhje me moszbatimin në kohë të kontratave.
Për disa nga procedurat e prokurimit të planifikuara nuk janë zhvilluar dhe nuk jepen shpjegime në lidhje alokimin e kostove të caktuara për këto procedura në zhvillimin e procedurave të tjera.
Për sa më sipër, është në kundërshtim me nenin 5 "Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat", Pjesa 2 "Ekzekutimi i Projektit Seksioni 1, Masat Institucionale dhe Zbatimi" të ligjit nr. 151/2014 ,si dhe nenin 6 "Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat", Pjesa 2 "Ekzekutimi i Projektit Seksioni 1, Masat Institucionale dhe Zbatimi, të ligjit nr. 152/2014".
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 36-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**4.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë me kujdes situatat e krijuara në lidhje me vonesat mbi zbatimin e kontratave, se si kanë ndikuar ato në arritjen e objektivave të projektit, si dhe në të ardhmen të parashikohen dhe penalitete në lidhje me mos realizimin në kohë të tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetja nga auditimi**: Në hartimin e kontratave është konstatuar se, gjuha e përdorur është anglishtja; nuk përmbajnë të dhënat mbi palët e përfshira në kontratë si: ID, NIPT etj., duke vështirësuar gjurmën e auditimit të tyre.
Nga shqyrtimi i dosjeve të procedurave të prokurimit, ka rezultuar se nuk kanë numër inventarizimi, pa një kronologji dokumentacioni duke u bërë pengesë mbi zhvillimin e veprimtarisë audituese, si dhe vete subjektin për përdorimin e rezultateve të projektit.
Për sa më sipër në kundërshtim me Nenin 24, germa "a" të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat". *(Më hollësisht trajtuar në faqen 31-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**5.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me hartimin, mbajtjen dhe inventarizimin e dokumentacionit, korrespondencave, të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësinë, si dhe të marrë masa që t'i kryhen konform dispozitave ligjore, duke bërë të mundur lehtësimin e përdorimit arkivor dhe qasjen me to sipas kërkesave të ndryshme.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetja nga auditimi**: Përzgjedhja e aplikantëve, në përmbushje të komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural", nga analizimi i dokumentacionit të dosjeve të aplikantëve, vihet re që në këtë komponent është vepruar si e ndarë nga projekti "Shërbimet Mjedisore", pasi nuk ka një korrelacion midis zonave që kërkojnë ndërhyrje të caktuara nga komponentët e tjerë si dhe nuk ka një orientim për aplikantët mbi mbulimin e këtyre zonave të caktuara.

Në korrespondencën me Drejtoritë pyjore të zonave respektive dhe strukturave përkatëse në MM, nuk jepen të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të zonave në të cilën duhet të kryhet ndërhyrja, referuar dhe impaktit që ka ajo zonë, por fokusohet vetëm në miratimin që shoqata mbulon atë zonë.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 55-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**6.1 Rekomandimi:** Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të kenë si qëllim primar arritjen e objektivave të caktuara në projekte të ndryshme, duke i parë komponentët përbërës të projektit si një e tërë dhe jo të ndara nga njëra tjetra, për të bërë të mundur një alokim të fondeve sa më efektiv.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetja nga auditimi**: Gjatë shqyrtimit dhe analizës të dosjeve të aplikantëve është konstatuar përzgjedhja e aplikantëve të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, krijimi i shoqatave është në një kohë të afërt me aplikimin për thirrjen e parë ose të dytë të projektit, veprime në kundërshtim me kërkesën MOG, pasi këto shoqata janë krijuar rishtas dhe nuk kanë asnjë aktivitet të ngjashëm më parë, duke mos plotësuar kriteret e përcaktuara në pikën 2.5 të MOG Kriteret specifike të pranueshmërisë.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 55-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**7.1 Rekomandimi:** Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, të analizojnë me kujdes situatën e mësipërme, duke ngritur një grup pune për verifikimin në terren të realizimit të projekteve, për të parë nëse përzgjedhja e aplikantëve pa eksperienca të mëparshme ka rezultuar efektiv në realizimin e projekteve të fituara sipas kushteve të caktuara, si dhe në të ardhmen në përzgjedhjen e aplikantëve të bazohen në kriteret e pranueshmërisë të caktuara në manuale, rregullore, ligje etj.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetja nga auditimi**: Në dokumentacionin e sjellë nga aplikantët, në projektin e dërguar, nuk jepen informacione të detajuara në lidhje me vlerën e projektit dhe se si është arritur në atë vlerë. Gjithashtu nuk tregohet roli që do kenë anëtarët e shoqatës, angazhimi i tyre dhe se si do mbulohet pjesa prej 15% e financimit të projektit nga shoqatat dhe 40% për individët, pjesë të cilën nuk e mbulon granti.
Në dokumentacionin e dërguar nga aplikantët pjesëmarrës dhe fitues, nuk jepen detaje se si do arrihet finalizimi i projektit; sa do të jetë fuqia punëtore e angazhuar për kryerjen e projektit, cila do të jetë infrastruktura e nevojshme, pagesat për kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Kjo pjesë gjithashtu nuk argumentohet e dokumentuar as në momentin e kërkesës për financim, (faturë shoqëruese, listë pagesa), por vetëm fatura për blerjen e fidanëve ose mjeteve bujqësore të cilat nuk përbëjnë mesatarisht as 10% të financimit të kërkuar. Edhe në rastet kur është deklaruar lista e anëtarëve të angazhuar, nuk janë shoqëruar me listë pagesa, si dhe nuk është kryer asnjë verifikim nga AZHBR dhe MTM, që këto persona të deklaruar si anëtarë të shoqatës për përfitimin e këtij granti janë angazhuar për realizimin e tij, gjë që e bën të vështirë verifikimin e personave që janë angazhuar në këtë projekt në qoftë se janë apo jo anëtarë. Për sa më sipër në mospërputhje me MOG pika 2.4 *(Më hollësisht trajtuar në faqen 55-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**8.1 Rekomandimi:** Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të analizojnë me kujdes situatën e mësipërme, të ngrejë një grup pune për verifikimin mbi vërtetësinë e dokumentacionit të sjellë nga aplikantët si dhe të anëtarëve të angazhuar, duke evidentuar rolin që kanë pasur secili nga këto persona, si është bërë alokimi i

fondeve të marra nga shoqata tek anëtarët si dhe në të ardhmen të ndërpresë çdo lloj praktike të dhënies së fondeve pa dokumentacionin e duhur shoqërues dhe justifikues.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetja nga auditimi**: Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-CQ-13.1, ESP-CS-CQ-13.2, ESP-CS-CQ-13.3, ESP-CS-CQ-13.4 me objekt *"Consultant for Creation of FPMP"* me kosto të përllogaritur në 2,165,000 Euro, në planifikimin 18 mujor të vitit 2015 ka objekt dhe kosto të ndryshme. Qëllimi i zhvillimit të procedurës së prokurimit është përgatitja e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Nuk jepen shpjegime të mëtejshme për ndryshimin e komponentit të mësipërm. Në realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar Operatori A. & O. P. . Nga analizimi i pagesave, kostoja e përllogaritur në planifikim është tejkaluar si dhe janë përdorur burime të tjera likuidimi, pagesë në shumën 2,454,874 Euro nga llogaria e Bankës Botërore.
Nga analizimi i llogarive bankare u konstatua që pagesat e kryera OE nuk janë sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion mbi zbatimin e kontratës duke qenë se termat e referencës mbi produktin janë të pamatshëm, duke qenë se është dhe kontratë shërbimi konsulence. Gjithashtu për të njëjtin objekt është zhvilluar dhe procedura e prokurimit me Ref. ESP-CS-IC-3.1, me objekt "IT Expert for NFI/NEA", e cila nuk ishte parashikuar në planin e 18 mujor të parë në vitin 2015. Kostot e përllogaritura janë në shumën 25,000 Euro (170 Euro/dita) dhe për realizimin e procedurës së prokurimit është angazhuar znj. B. K.. e cila njëkohësisht rezulton e punësuar pranë shoqërisë A. . Kontrata është lidhur me datë 03.04.2018 me nr. 2670 Prot. Afati i zbatimit të kontratës është 12.03.2018-31.09.2019. Në këtë rast ka një mosrakordim midis datës së lidhjes së kontratës dhe datës së zbatimit të saj.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 36-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**9.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë situatën e mësipërme, duke ngritur një grup ekspertësh për të kryer verifikimin, nëse regjistrimi i pyjeve është kryer i plotë dhe pa gabime pasi nuk është kryer në përputhje me Projektin e Shërbimeve Mjedisore, ku në planin fillestar të prokurimeve është planifikuar që regjistrimi i pyjeve do kryhej duke marrë imazhe satelitore në kohe reale, gjë e cila është devijuar duke përdorur burime të tjera informacioni. Gjithashtu të analizohet situata në lidhje me angazhimet e znj. B. K. dhe cili ka qenë roli dhe kontributi i saj njëkohësisht si e punësuar pranë shoqërisë A. dhe si IT Expert for NFI/NEA.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetja nga auditimi**: Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me Ref. ESP-CS-SS-14.2 me objekt "Ind. Consultant for Interim F&P Database", me kosto të përllogaritur në vlerën 70,000 Euro, nuk është planifikuar në planin 18 mujor të vitit 2015. Për realizimin e shërbimit të mësipërm është angazhuar z. G. F.. Kostoja e planifikuar është tejkaluar duke shkuar në shumën 104,904 Euro. Kontrata është lidhur me datë 12 Maj 2018, z. G. F. rezulton njëkohësisht edhe Administrator i kompanisë A. S. - A. B. me NIPT L........N, kompani e cila gjithashtu është angazhuar në realizimin e procedurave të tjera të prokurimit me Ref. ESP-CS-QCBS-4.1 dhe Ref. ESP-CS-QCBS-4.2 me objekt "Supervision of registration of communal forest", me kosto të përllogaritur në shumën 823,000 Euro. Objekti midis procedurave të prokurimit është i ngjashëm si dhe datat e zhvillimit të tyre janë të njëjta. Pagesat do të kryhen sipas kushteve të kontratës ku u konstatua që nuk janë bërë sipas termave të referencës dhe kushteve të kontratës. Gjithashtu për kontratën e mësipërme janë kryer dhe amendime të kontratave pa dhënë shpjegimet përkatëse. Sipas Kushteve

të kontratës së parë, konsulenti z. G. F. duhej të ishte i pranishëm në Shqipëri të paktën gjysmën e periudhës së kontraktuar, e cila nuk u arrit të vërtetohej nga grupi i auditimit.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 36-55 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**10.1 Rekomandimi:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të analizojë me kujdes situatën e mësipërme, për të evidentuar, angazhimet dhe kontributin e z. G. F. paralelisht në realizimin e dy kontratave, arsyet mbi amendimet e kontratës si dhe vërtetësitë mbi plotësimin e kushteve të kontratës për praninë fizike pranë Republikës së Shqipërisë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetja nga auditimi**: AZHBR për zbatimin e Komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" duhet të kryente dhe raportim, analizë risku dhe monitorim pas përfundimit të granteve të shpërndara për projektet fituese nga individët dhe shoqata.
Përfituesit e projektit në kontratat e nënshkruara me AZHBR ne nenin 8 dhe në MOG pika 3.19 e kanë të përcaktuar që përfituesit janë të detyruar për të menaxhuar investimet për 3 vjet pas marrjes së pagesave.
Gjithashtu pika 3.9 e MOG parashikon që pas vitit të tretë të përfundimit të investimit për të dy thirrjet e këtij projektit, duke filluar nga momenti i kërkesës për pagesë, një numër i investimeve (të paktën 10%) duhet të monitorohej nga AZHBR me një ekip kontrollorësh të përbërë nga specialistë të dyja institucioneve (MM dhe AZHBR) në mënyrë që të verifikohet gjendja e investimit. Përzgjedhja e investimeve objekt monitorimi, do të bëhet bazuar në procedurën e analizës së riskut. Gjetjet e këtij monitorimi do ti raportohen AZHBR dhe MM me shkresë zyrtare nga zyrtari i raportimeve në AZHBR.
Për sa më sipër grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë plan pune, analizë risku, auditim apo raport monitorimi të zhvilluara për subjektet fituese, veprime të cilat janë shkak pasoje e gjetjeve të mësipërme.
Mos realizmi i planeve të punës, analizës së riskut , auditimeve dhe raporteve të monitorimit ka sjellë shkelje të MOG dhe nenit 8 të kontratave që AZHBR ka lidhur me përfituesit e granteve. Gjithashtu mos raportimit pranë Ministrisë së Mjedisit nga Zyrtari Raportues pranë AZHBR është në shkelje me pikën 3.9 të MOG dhe çon në mos realizmin me sukses të komponentit "Dhënia e granteve konkurruese për masat e zhvillimit rural" që i është besuar kësaj Agjencie nga Ministria e Mjedisit për projektin Shërbimet Mjedisore.
*(Më hollësisht trajtuar në faqen 55-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**11.1 Rekomandimi:** Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të analizojë situatën e mësipërme si dhe të ngrejë një grup pune për verifikimin në terren të realizimit të projekteve, sipas afateve ligjore të mbetura të cituara në MOG, si dhe në të ardhmen të veprojë në përputhje me manualet, rregulloret, ligjet e miratuara. Duke qenë se nuk është kryer asnjë monitorim, verifikim i realizimit të projekteve, sjell që i gjithë granti i dhënë aplikantëve të cilësohet fond i përdorur pa Efektivitet dhe Eficencë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetja nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua që të gjitha pagesat për shoqatat janë bërë me një këst në mospërputhje me MOG konkretisht pika 2.10 Kushtet e pagesës ku sipas manualit proçedura e pagesës do të jetë deri në dy këste, e konkretisht:
30% - 40% e shumës së rimbursueshme do të paguhet pas kryerjes së punimeve përgatitore.
Pjesa e mbetur prej 60%-70% do të paguhet pas përfundimit të investimit, dorëzimit të faturave, verifikimit në terren dhe certifikimit të gjitha punimeve, në kundërshtim me Pikën 3.3 Neni 3 të

Kontratave të lidhura midis palëve. *(Më hollësisht trajtuar në faqen 55-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësorë, të analizojë situatën e mësipërme, duke ndërprerë çdo rast të dhënies së fondeve jo konform manualeve, rregullave si dhe pa dokumentacionin e nevojshëm justifikues si dhe të ketë në konsideratë që pagesa me dy apo më shumë këste do të rriste shkallën e monitorim dhe kontrollit si dhe shmangien e abuzimeve që në faza të ndryshme.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## B. MASA SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetja nga auditimi**: Në dosjet e audituara për krijimin dhe mbrojtjen e pyjeve, u analizua dokumentacioni i dërguar nga aplikantët fitues si dhe u verifikuan parcelat ku do të implementohej projekti në bazë të koordinatave të dhëna në projekt. Verifikimi u krye nga imazhe satelitore të marra nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ASIG, ku në bazë të kërkimit nga koordinatat e dhëna, rezultuan këto parcela të papyllëzuara, si më poshtë:

- E. M. – Sh. P. dhe K. “A.” fitues i thirjes së parë dhe është disbursuar me vlerën 4,937,071 lekë.
- Xh. D. – Sh. B. N. Xh. fitues i thirjes së parë dhe është disbursuar me vlerën 4,214,130 lekë.
- B. T. – Sh. P. te P. dhe K. fitues i thirjes së dytë dhe është disbursuar me vlerën 4,899,035 lekë.
- E. V. – Sh. P. P. K. S. fitues i thirjes së parë dhe është disbursuar me vlerën 4,920,435 lekë.
- L. M. – Sh. Sh. P. K. U. K. Gj. fitues i thirjes së dytë dhe është disbursuar me vlerën 4,386,316 lekë.
- Xh. H. – Sh. P. P. K. H. fitues i thirjes së dytë dhe është disbursuar me vlerën 4,082,658 lekë.

Në total vlera e shoqatave përfituese të mësipërme që është disbursuar nga AZHBR është **27,439,647 lekë**.

Gjithashtu në fund të projekteve të pyllëzimit nuk është marrë asnjë hap mbi regjistrimin e këtyre zonave pyjore (sipas projektit), si një ndër qëllimet kryesore të zhvillimit të projektit “Shërbimet Mjedisore”.

*(Më hollësisht trajtuar në faqen 55-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, të analizojnë me kujdes situatën e mësipërme, duke ngritur një grup pune për verifikimin në terren të gjithë projekteve fituese nëse janë kryer në përputhje me projektet e dorëzuara, si dhe në rast të verifikimit të mosrealizimit të tyre të fillojnë procedurat përkatëse **për kthimin e fondeve të marra dhe penaliteteve të mundshme për mosrealizimin e tyre të evidentuar nga auditimi në shumën 27,439,647 lekë**

**Menjëherë**

## C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

